



Universiteti
Europian i
Tiranës



Po vjen një epokë e re. Bëhu gati!



E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE INFLUENCA E SAJ NË TË DREJTËN E BRENDSHME

Brikena (Buda) **DHULI** / Juelda **LAMÇE** / Yllka **LAMÇE** / Ina **XHEPA** /
Edi **SPAHO** / Hemion **BRAHO** / Ilir **ISLAMI** / Sevdie **KADRIU** / Çlirim
DURO / Jonka **CEKA** / Kejsi **RIZO** / Mirgen **PRENÇE** / Ksenofon **KRISAFI**

JUS & JUSTICIA NR 10/2014

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT JURIDIK

Kryeredaktor PROF. ASOS. DR. MIGENA LESKOVIKU ISSN 2223-8654

Bordi Editorial

PROF. DR. KSENOFON KRISAFI

PROF. DR. FERIT DUKA

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI

PROF. DR. SKËNDER KAÇUPI

PROF. DR. XHEZAIR ZAGANJORI

DR. ÇLIRIM GJATA

DR. SOKOL SADUSHI

DR. NEBI BARDHOSHI

Redaktore

MARSILDA NDINI

Arti grafik

BESNIK FRASHNI

Jeni të mirëpritur të dërgoni shkrime, recensa librash, përmbledhje punimesh shkencore, monografi apo studime të ndryshme në redaksinë e revistës "Jus&Justicia".

Redaksia do t'i shqyrtojë me objektivitet, rigorozitet shkencor dhe konsideratë.

Materialet mund të dërgohen në formën Word, në adresën e mëposhtme:

migena.leskoviku@uet.edu.al

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS / TIRANË
Bulevardi "Gjergj Fishta" / www.uet.edu.al / info@uet.edu.al



© UET Press 2014

Të gjitha të drejtat për këtë botim janë të rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet
përmes çdo mënyre ose mjete pa leje paraprake.

Punimet e paraqitura shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të
autorëve. Redaksia nuk mban përgjegjësi për sa autorët kanë shprehur në
shkrimet e tyre.

Rruga: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Tiranë, Albania
Kodi Postal: 1023
Tel: +355 4 2421 806
Web: <http://www.uet.edu.al>

përmbajtja

DOSSIER: ARTIKUJ

Barazia gjinore si një domosdoshmëri për integrimin gjinor.....5

Brikena (Buda) Dhuli

*Kuptimi i institutit të bashkëjetesës në legjislacionin shqiptar. Parimi i heteroseksualitetit
si kufizim që bie ndesh me legjislacionin dhe jurisprudencën europiane*13

Juelda Lamçe & Yilka Lamçe

Liria sindikale sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së.....25

Ina Xhepa

*Aspekte të legjislacionit për shoqëritë anonime (aksionare) të kuotuar në bursë në vende
të ndryshme Europiane*.....33

Edi Spaho

*Sekreti bankar mbi informacionet e klientit dhe marrëveshjet e normativat ndërkombëtare
që po sjellin fundin e këtij elementi sigurie*.....44

Hemion Braho

Konceptet e së ardhmes mbi sigurinë njerëzore50

Ilir Islami & Sevdie Kadriu

ARTIKUJ DHE STUDIME

<i>Këndvështrimi i një pretendimi civil në procesin penal</i>	59
Çlirim Duro	
<i>E drejta penale në mbrojtje të mjedisit</i>	72
Jonka Ceka	
<i>Gjykata Ndërkombëtare Penale; Raporti i saj me sovranitetin shtetëror</i>	82
Kejsi Rizo	
<i>E drejta për t'u mbrojtur me avokat në procesin penal</i>	93
Mirgen Prençe	
RECENSË	
<i>Imuniteti, aspekte krabasimore – libër me vlera të shumta</i>	100
Ksenofon Krisafi	
ABSTRACTS	103

DOSSIER: ARTIKUJ

Barazia gjinore si një domosdoshmëri për integrimin gjinor

Brikena (Buda) Dhuli

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS, kenadhuli@yahoo.com

Abstrakt

Integrimi si një koncept i ri u shfaq për herë të parë në tekstet ndërkombëtare në Konferencën e Tretë Botërore të Kombeve të bashkuara për gratë (Nairobi 1985) në lidhje me debatin e komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi statusin e grave dhe rolin e grave në zhvillim. Janë të shumta diskutimet për integrimin gjinor dhe ka pak konsensus rreth përcaktimit të integrimit gjinor. Integrimi gjinor është organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikës, në mënyrë që perspektiva e barazisë gjinore të inkorporohet në të gjitha politikat dhe nivelet nga aktorët që bëjnë pjesë në politikë bërje. Integrimi gjinor do të thotë që procesi i politikës duhet të riorganizohet në mënyrë që aktorët të dinë si të inkorporojnë një perspektivë dhe ekspertizë gjinore si një kërkesë normale për politikë bërësit. Integrimi i nxjerr problemet e barazisë gjinore jashtë integrimit të mekanizave të barazisë gjinore dhe përfshin më shumë aktorë të rinj në ndërtimin e një shoqërie të ballancuar. Duke bërë këtë, procesi i transformimit të marrëdhënieve gjinore në drejtimin e barazisë gjinore mund të përshpejtohet dhe të forcohet.

Fjalë kyç: Integrimi gjinor, perspektivë, barazi gjinore, mekanizma.

Hyrje

Çfarë është integrimi gjinor

Integrimi gjinor vendos strategjinë e tendencës në kontekstin e arritjeve në termat e barazisë gjinore. Integrimi si një koncept i ri u shfaq për herë të parë në tekstet ndërkombëtare në Konferencën e Tretë Botërore të Kombeve të bashkuara për

gratë (Nairobi 1985) në lidhje më debatin e komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi statusin e grave dhe rolin e grave në zhvillim. Kjo u pa si një mënyrë për të promovuar rolin e grave në fushën e zhvillimit dhe të integritit të vlerave të grave në punën kërkimore. Një rezolutë mbi punën e ardhshme të këtij komisioni u aprovua në 1986, që vendosi të integrojë *Strategjitë e së Ardhmes* në programet ekonomike dhe të zhvillimit social.

Në konferencën e katërt Botërore të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë (Pekin 1995) Strategjia e integritit gjinor u adoptua nga platforma e Pekinit. Kjo platformë kërkon promovimin e politikës së integritit gjinor duke kërkuar që “qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet në mënyrë që para se të merren vendimet të bëhet një analizë respektive mbi efektet, mbi gratë dhe burrat” Shumë vende kanë adaptuar një plan kombëtar për integritin gjinor si rezultat i Platformës për Veprim.

Në vitet e fundit brenda organizatave Europiane ndërqeveritare koncepti i integritit gjinor është promovuar mjaft. Në komisionin europian, program i veprimit të komunitetit mbi mundësitë e njëjta për gratë dhe burrat (1991-1995) e ka bërë një çështje kryesore këtë program veprimi. Komisioni ka adaptuar një komunikatë mbi integritin gjinor¹. Këshilli nordik i ministrave ka vendosur në një program për *kooperimin nordik* mbi barazinë gjinore 1995 – 2000, të adoptuar në mars 1995, për të marrë hapa aktivë për të pasur aspekte të barazisë gjinore të inkuorporuara në të gjitha fushat e politikës . Për më shumë u vendos të merreshin hapa aktivë për të pasur modele për integritin e një perspektive gjinore. Një projekt pilot 3 vjeçar u lançua në 1997, që kishte për qëllim zhvillimin dhe testimin e metodave për integritin gjinor.

Janë të shumta diskutimet për integritin gjinor dhe ka pak konsensus për rreth përcaktimin e integritit gjinor dhe si integrohet në praktikë. Komentet e mëposhtme janë bërë në vite:

- Të gjitha përkufizimet fokusohen mbi qëllimin e madh të arritjes së barazisë gjinore. Ato fokusohen mbi atë çfarë do të silltet në integritin, e *quajtur perspektiva e barazisë gjinore ose perspektiva e gruas.*
- Shumë përkufizime përshkruajnë vetë strategjinë, shpesh duke e reduktuar përkufizimin në aspekte pjesore të integritit gjinor: Ato fokusohen mbi pjesëmarrjen e plotë të grave në vendimarrje ose mbi një mjet si studimi i propozimeve të politikave nga një perspektive gjinore.
- Disa definicione fokusohen mbi efektet e integritit gjinor. Dhe çfarë

¹ Kjo komunikatë thotë që integriti Involvon “ Mobilizimin e politikave të përgjithshme dhe masave specifike për arritjen e qëllimit të barazisë duke pasur parasysh në mënyrë të qartë dhe aktive në fazën e planifikimit efektet e mundshme të tyre mbi situatat respektive të burrave dhe grave”COM (96)67 Komunikata finale21.02.1996

ai sjell në funksionimin dhe strukturimin e shoqërisë. Këto përkufizime tregojnë ndryshimet në kulturat organizative dhe mënyrën sesi punojnë institucionet ose mënyrat e reja të mendimit dhe të politikave. Zakonisht këto gjenden në *OJQ-të*.

- Shumë përkufizime presupozojnë që integriti përfshin një zhvendosje të aktorëve, që do të thotë që aktorë të zakonshëm përfshihen në integritin e perspektivës gjinore.
- Së fundmi, themi që integriti shpesh nuk përkufizohet fare.

Grupi është koshient për faktin që integriti është i vështirë të përkthehet në shumë gjuhë dhe shpesh reduktohet në terma si “*qasje e bazuar në gjini*”, por sigurisht integriti është shumë më tepër se kaq: ai është një përpjekje për ti përcjellë problemet e barazisë gjinore në integritin e shoqërisë, në drejtimet, organizatat dhe idetë që marrin vendime për politikat dhe burime të rëndësishme si edukim. Kështu integriti do të thotë, që problemet e barazisë gjinore duhet të zgjidhen brenda punës me edukim. Në çdo vend koncepti duhet të përkthehet dhe të shpjegohet me shumë kujdes për të theksuar integritin e një perspektive gjinore. Grupi i specialistëve punoi mbi përkufizimin duke përfshirë aspekte të ndryshme në të:

Së pari, i referohet asaj çfarë duhet të integrohet në tendencën kryesore gjinore p.sh., një perspektivë barazie gjinore dhe një qëllim që duhet të arrihet p.sh., barazi gjinore.

Së dyti, ai përmend implikimet strukturale dhe funksionale që involvon integriti gjinor p.sh., riorganizimi, përmirësimi, zhvillimi I proceseve të politikës. Integriti gjinor është një proces sa politikë aq dhe teknik². Integriti gjinor përfshin riorganizimin e proceseve politike sepse kërkon vëmendjen e politikave të barazisë gjinore, ndryshimin në kulturat organizative dhe institucionale.

Së treti, përkufizimi nuk është parcial dhe i kufizuar në aspekte të veçanta dhe teknika të integritit gjinor. Ajo kërkon nevojën e mjeteve dhe teknikave të shumta. Ajo përfshin pjesëmarrjen e plotë të grave në të gjitha aspektet e jetës si dhe analizën e të gjitha propozimeve dhe politikave të ndryshme nga një perspektivë e barazisë gjinore.

Integriti gjinor do të thotë që procesi i politikës duhet të riorganizohet në mënyrë që aktorët të dinë si të inkuorporojnë një perspektive dhe ekspertizë gjinore si një kërkesë normale për politikë bërësit. Integriti i nxjerr problemet e barazisë gjinore jashtë integritit të mekanizmave të barazisë gjinore dhe përfshin më shumë aktorë të rinj në ndërtimin e një shoqërie të ballancuar. Duke bërë këtë, procesi i transformimit të marrëdhënieve gjinore në drejtimin e barazisë gjinore mund të përshpejtohet dhe të forcohet.

² IDS 1997

Rëndësia e integrimit gjinor

Ka disa arsye specifike që nënvizojnë vlerën e shtuar të integrimit:

Vendos njerëzit në zemër të politikëbërjes

Problemet e barazisë së integrimit nënvizojnë nevojën për t'u bazuar dhe për të vlerësuar çdo politikë në varësi të impaktit që ajo ka mbi individët dhe grupet sociale, burra ose gra, me nevojë dhe vlerat e tyre. Një qasje e tillë përmirëson praktikën që vlerëson politikën e përgjithshme sipas rezultateve të tyre dhe hap rrugë të reja për të zëvendësuar praktikën “*tradicionale*” të indikatorëve ekonomik dhe ideologjik (si GDP dhe të dhëna të tjera të ngjashme që konsiderohen neutral) me indikatorë më të vlefshëm dhe më konkret që lidhen me mirëqënien e njerëzve).

Integrimi i barazisë gjinore mund të jetë një hap përpara në një qasje më humane dhe më pak ekonomike të zhvillimit të përgjithshëm dhe menaxhimit të shoqërive demokratike, duke përdorur perspektivën e barazisë gjinore politikën do të jenë të shprehura më qartë në lidhje me nevojat e vërteta të grave dhe burrave, duke i përmirësuar ato dhe duke i çuar në një strategji fituese.

Çon në një qeverisje më të mirë

Integrimi gjinor do të na çojë në një politikëbërje më të mirë dhe me informuese dhe rrjedhimisht në një qeverisje më të mirë. Ajo sfidon politikën si gjini neutral, që faktikisht nuk janë dhe do të tregojë supozimet e fshehura mbi realitetin dhe vlerat. Integrimi do të çojë në një transparencë më të madhe dhe hapje në procesin e politikës.

Involvon burrat dhe gratë dhe përdor me efikasitet burimet humane

Deri tani puna për promovimin e barazisë gjinore është kryer nga gra. Integrimi gjinor përfshin gra dhe burra. Ajo bën të qartë që shoqëria varet nga përdorimi i të gjithë burimeve njerëzore dhe nga eksperienca si e grave dhe e burrave dhe një përgjegjësitë të tyre të ndara në heqjen e pabarazive në shoqëri.

Së fundmi duke involvuar një numër më të madh aktorësh të jashtëm në procesin politik integrimi gjinor mund të ndihmojë në uljen e deficitit demokratik që karakterizon shumë demokraci të sotme.

I bën problemet e barazisë gjinore më të dukshme në shoqëri

Integrimi gjinor do të japë një ide të qartë të pasojave dhe impaktit të inisiativave politike të grave dhe burrave dhe të balancës mes tyre. Problemet e barazisë gjinore

do të bëhen më të dukshme dhe do të integrohen në shoqëri ndërkohë që deri më sot kanë qenë gjithmonë të mënjanuara. Ajo do të tregojë që barazia gjinore është një problem i rëndësishëm social me pasojë për të gjithë dhe nuk është “*thjesht një kosto ose një luks*”³. Integrimi gjinor njihet pabarazinë mes burrave dhe grave që nuk mund të luftohet në mënyrë eficiente pa interesin dhe angazhimin në sistemin politik dhe të shoqërisë si një e tërë. Ajo do të ndryshojë qëndrimin kundrejt barazisë gjinore që shpesh është negative dhe do të fillojë një debat të ri mbi problemet e barazisë.

Marrim parasysh ndryshimet mes burrave dhe grave

Është e ditur që gratë dhe burrat nuk janë një grup homogjen⁴, për ti kushtuar vëmendjen e duhur këtij ndryshimi. Politikën dhe instrumentat politikë duhet të lejojnë që të merret parasysh ndryshimi. Nga një perspektivë e integrimit gjinor, problem nuk është fakti që ka ndryshime por që këto ndryshime janë të lidhura me hierarkinë dhe ka një rrezik që të gjithë qytetarët të maten me norma mashkullore. Në këtë sens në këtë kuptim integrimi gjinor shkon një hap më tutje se sa thjesht të punosh drejt barazisë gjinore. Ajo lë vend për ndryshim jo hierarkik në termat të seksit, races, klasës ose një kombinimi të faktorëve.

Si lidhet integrimi gjinor me politikën e barazisë gjinore

Çfarë është barazia gjinore

Barazi gjinore do të thotë pjesëmarrje, fuqizim dhe vizibilitet tek të dyja seksit në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Barazia gjinore është e kundërta e pabarazisë gjinore, jo diferencë gjinore dhe synon promovimin e pjesëmarrjes së plotë të gruas dhe të burrit në shoqëri. Për një kohë të gjatë barazia gjinore në Europë perceptohej si dhënia *de jure* e të drejtave, mundësive, kushteve dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në të gjitha fushat e jetës dhe sferat e shoqërisë. Në ditët e sotme është e pranuar që barazia *de jure* nuk të çon automatikisht në barazi *de facto*. Është e rëndësishme të kuptohet që kushtet e jetesës së burrave dhe grave janë të ndryshme, shumë të ndryshme deri në njëfarë masë për shkak të funksionit mëmësor të gruas. Problemi kryesor nuk është ekzistenca e këtyre ndryshimeve, por fakti që këto ndryshime nuk duhet të kenë një *impact* negativ në kushtet e jetesës së burrave dhe grave, nuk duhet të jenë shkak diskriminimi kundrejt tyre dhe duhet të kontribuojnë në një ndarje të barabartë të fuqisë në ekonomi, shoqëri,

³ RUBERY1996

⁴ Burrat dhe gratë ndryshojnë në aspekte të ndryshme si klasa raca bindjet politike opinion politik etniciteti mosha ose orientimi seksual

dhe proceset politikëbërëse. Për të përcaktuar barazinë gjinore duhet të hidhet një vështrim ku të shihet më ngushtë koncepti gjinor. Dy aspekte janë të rëndësishme në këtë kontekst. Ndërtimi social i gjinisë dhe marrëdhënia ndërmjet sekseve. Gjinia është një definicion i ndërtuar në mënyrë sociale mbi gratë dhe burrat. Ajo është përshkrimi social i seksit biologjik, i përcaktuar nga punët, funksionet dhe rolet që i atribuohen burrave dhe grave në shoqëri dhe në jetën publike dhe private. Gjinia është një përcaktim specifik, kulturor i feminitetit dhe maskilitet dhe si e tillë ndryshon në kohë dhe në hapësirë. Ndërtimi dhe riprodhimi i gjinisë ndodh në nivel individual dhe social. Qëniet humane i formëzojnë rolet dhe normat gjinore përmes aktiviteteve të tyre. Ka një mirëkuptim në rritje që gjinia duhet të konsiderohet edhe në nivel politik dhe institucional⁵.

Politikat dhe strukturat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në kushtet e jetës dhe ato shpesh institucionalizojnë mirëmbajtjen dhe riprodhimin e ndërtimit social të gjinisë. Gjinia nuk është vetëm një definicion i ndërtuar në mënyrë sociale mbi gratë dhe burrat, ai është një definicion social i ndërtuar mbi marrëdhëniet ndërmjet sekseve. Ky ndërtim social përmban një marrëdhënie fuqie jo të barabartë me dominimin mashkullor dhe nënshtrimin femëror në shumicën e sferave të jetës. Burrat dhe punët, rolet, funksionet dhe vlerat që i kontribuohet atyre vlerësohen në shumë aspekte më shumë se sa ato që shoqërojnë gratë. Pranohet gjerësisht në shoqëri që norma mashkullore quhet si normë për shoqërinë në tërësi dhe kjo reflektohet në politikat dhe strukturat. Këto të fundit shprehen në mënyrë të paqëllimshme dhe riprodhojnë pabarazinë gjinore⁶. Barazia gjinore do të thotë të pranosh dhe të vlerësosh njëllë ndryshimet mes burrave dhe grave dhe rolet e ndryshme që ato luajnë në shoqëri. Barazia gjinore përfshin të drejtën për të qenë i ndryshëm dhe për të marrë parasysh ndryshimet ekzistuese mes burrave dhe grave në lidhje me klasën, opinionin politik, fenë, racën dhe orientimin seksual. Barazi gjinore do të thotë të diskutosh se çfarë mundësisht ke për të shkuar më tej, për të ndryshuar strukturat në shoqëri që kontribuojnë në mirëmbajtjen e një marrëdhënie fuqie jo të barabartë mes burrave dhe grave dhe për të arritur një balancë më të mirë në vlerat dhe prioritetet e ndryshme femërore dhe mashkullore. Problemi është hierarkia gjinore që të sigurohemi që ndërtimi social i gjinisë nuk lë vend për diferenca dhe nuk përmban nocionin e hierarkisë që i vendos burrat më lart se gratë⁷. Kjo do të thotë një partner-ship real mes burrave dhe grave dhe përgjegjësi të tyre të ndara në zhvendosjen e pabarazive në jetën e tyre publike dhe reale.

⁵ UNIFEM 1995: 7, Konkluzionet të konferencës mb “ Barazia dhe demokracia: Utopia ose sfida” Këshilli I Europës 1995. Raporti final I grupit të specialistëve për barazinë dhe demokracinë Këshilli Europës 1996

⁶ Definicioni I Scottit mbi gjininë lidh gjininë me fuqinë, sepse deklaron që “ gjinia është një mënyrë primare që përcakton marrëdhëniet e fuqisë” sipas Scottit, gjinia implikohet në konceptin e ndërtimit të vetë fuqisë sepse referencat gjinore vendosin deri në një farë mase shpërndarjen e fuqisë që është kontroll mbi burimet material dhe simbolike (Scott 1986:1067)

⁷ UNIFEM 1995: 7,

Çështja mbetet përdorimi i kompetencave, vlerave dhe talenteve të çdo qytetari involvimi i grave dhe burrave në ndërtimin e shoqërisë. Pabarazia gjinore duhet të luftohet, mbrohet dhe promovohet si një e drejtë humane. Të arrish barazinë gjinore është një proces, i cili shpesh është vënë në pikëpyetje, është rimenduar dhe ripërcaktuar. Në kohët e sotme objektivat më të rëndësishme për barazinë gjinore përfshijnë aspektet e mëposhtme:

- Një objektiv i rëndësishëm është njohja dhe implementimi i plotë i të drejtave të grave si të drejta humane. Kjo përfshin të respektosh të mbrosh dhe të promovosh të drejtat humane të grave dhe burrave njëllë duke i siguruar të dy palëve respektimin e plotë të këtyre të drejtave. Gjithashtu do të thotë të luftosh interferencat me lirinë dhe dinjitetin femëror. (Të luftosh dhunën kundër trafikut dhe institucionit, të promovosh zgjedhjen e lirë në çështjet e riprodhimit, të adresosh problemet specifike të migrimit dhe të minoritetit).

Përveç të drejtave humane zhvillimi dhe përmirësimi i demokracisë përfaqësuese është pika më e rëndësishme. Përfaqësimi i ulët ose ndonjëherë mungesa e grave në vendimarrje në të gjitha nivelet dhe fushat e jetës është një problem madhor, ndonëse ka variacione të mëdha në këtë aspekt mes vendeve të ndryshme. Kur gratë ose burrat përbëjnë rreth 1/3 e anëtarëve të një trupi vendimarrës ato influencojnë axhendën dhe ekziston një mundësi reale për ndryshim. Është e rëndësishme që gratë të jenë të dukshme në eventet sociale po aq sa burrat në historinë e çdo vendi.

- Një objektiv tjetër i rëndësishëm për barazinë gjinore është pamvarësia ekonomike individuale që çon në sigurimin e pagës së njëjtë, aksesit të njëjtë për kredi, kushtet e njëjta të tregut të punës dhe shpërndarjen e aseteve që marrin parasysh diferencat gjinore në jetën private. Pozicioni i grave dhe burrave në ekonomi është në shumë mënyra jetësor në balancën e fuqisë mes tyre. Të luftosh feminizimin e varfërisë është gjithashtu shumë e rëndësishme.
- Edukimi është një objektiv kyç në barazinë gjinore sepse përfshin mënyrat sesi shoqëritë transformojnë normat, njohuritë dhe aftësitë. Është e rëndësishme që sistemet e edukimit të fuqizojnë si vajzat si djemtë dhe të kujdesen në kundërbalancimin e hierarkive gjinore ekzistuese. Media gjithashtu ka një pozicion shumë të fuqishëm në transferimin dhe konsolidimin e këtyre normave dhe njohurive.
- Objektiv i fundit që duhet të përmendim është pranimi i nevojës që burrat dhe gratë kanë për të zhdukur disbalancat në shoqëri dhe përgjegjësinë e tyre të ndarë për ta bërë këtë.⁸

⁸ Deklarata dhe rezolucionet e bëra në Konferencën e 4 Ministeriale Europiane mbi barazinë mes burrave dhe grave. Stamboll 1997.

Bibliografia

- Komisioni European (1996) Përfshirja e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha politikën dhe aktivitetet e komunitetit
- Këshilli European (1996) Raporti final i Grupit të Specialistëve mbi Barazinë dhe Demokracinë
- Këshilli I European (1997) Gratë në politikë në Këshillin European të Shteteve anëtare
- Mc.Crudden, Cristopher (1996) Integrimi Drejtimi i duhur
- Leijenaar, Monique (1997) Integrimi, Hapi tjetër në Politikën e Mundësive të Barabarta diskutimi për takimin european të drejtorëve për Politikën e Mundësive të Barabarta, Amsterdam (Hollandë)7.2.1997
- Nanette Funk & Magda Mueller (1993) Post Komunizmi dhe Politikën Gjinore. Routledge. Londër

Kuptimi i institutit të bashkëjetesës në legjislacionin shqiptar. Parimi i heteroseksualitetit si kufizim që bie ndesh me legjislacionin dhe jurisprudencën europiane

Juelda Lamçe PhD

PEDAGOGE NË DEPARTAMENTIN E DREJTË PRIVATE, FAKULTETI JURIDIK, UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, E-MAIL: JUELDA.LAMCE@UET.EDU.AL

Dokt. Yllka Lamçe

Abstrakt

E drejta për të pasur familje dhe mbrojtja e veçantë që asaj i garantohet nga shteti janë sanksionuar në nenin 53 të Kushtetutës shqiptare. Por për cilën “familje” bëhet fjalë? Përdorimi i lidhëzës “dhe” në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 53 dëshmon për ekzistencën e qartë të dy të drejtave të mirëpërcaktuara nga Kushtetuta: përkatësisht e drejta për t’u martuar si dhe e drejta për të pasur familje. Në këtë kuptim, është e qartë se familja nuk njehsohet me institutin e martesës, por gjithashtu ajo mund të përfshijë në domethënien e saj edhe institutin e bashkëjetesës.

Sipas përkufizimit të nenit 163 Kodit aktual të Familjes (KF), bashkëjetesa kufizohet në lidhjen faktike “mes një burri dhe një gruaje”, ndërkohë që çiftet homoseksuale mbeten jashtë kuadrin ligjor. Mospërfshirja e tyre në nocionin e bashkëjetesës, në legjislacionin shqiptar, shtron problemin e përputhshmërisë së këtij përcaktimi ligjor me formulën kushtetuese të parashikuar në nenin 53, me parashikimin e nenit 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) – “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare” – si dhe me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Në dallim nga qëndrimi i saj i mëparshëm, së fundmi,

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) i ka përfshirë marrëdhëniet mes çifteve të të njëjtit seks jo më në kuadrin e të drejtës private, por në atë të jetës familjare. Garantimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ka qenë gjithashtu objekt i rezolutave më të fundit të Parlamentit Europian, sipas të cilave, vendet anëtare nuk duhet të japin një përkufizim të ngushtë të konceptit të “familjes”. Për këtë arsye, përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë europian, kërkon detyrimisht një rishikim të nocionit të bashkëjetesës si dhe një mirëpërcaktim të tij dhe të pasojave që rrjedhin prej tij.

Fjalë kyç: martesë, bashkëjetesë, familje, çifte heteroseksuale, çifte homoseksuale.

Hyrje

Koncepti i bashkëjetesës përfshin në vetvete forma të ndryshme të jetës së përbashkët në çift (homoseksuale apo heteroseksuale), në familje (p.sh. mbesa me gjyshen), në grup (p.sh. ndërmjet studentëve që ndajnë një banesë për një periudhë të përkohshme) etj. Për qëllimet e këtij punimi, do t'i referohemi vetëm bashkëjetesës në çift si institut i së drejtës familjare alternativ ndaj martesës dhe jo formave të tjera të shprehjes së saj. Pavarësisht nga kushtet apo rrethanat në të cilat ka lindur, bashkëjetesa faktike në çift, është shndërruar nga fenomen, në institut të së drejtës familjare, alternativ ndaj martesës. Ajo bazohet në arsye të ndryshme dhe mund të paraqitet si: alternativë e çifteve të divorcuara që kanë mbetur të zhgënjyer nga martesë, rezultat i vështirësive ekonomike apo e pasigurisë për të ardhmen, nevojë e çifteve të reja për të njohur më mirë njëri-tjetrin përpara se të lidhin martesë, zgjedhje e imponuar në kushtet e pamundësisë për të lidhur martesë (p.sh. ekzistenca e një lidhje tjetër martesore), apo rezultat i motiveve të tjera të ndryshme nga ato të sapo përmendura.

Garantimi i një mbrojtjeje ligjore të këtyre marrëdhënieve, pavarësisht nga formalizimi i lidhjes apo vullneti i palëve, përbën një tregues të rëndësishëm të nivelit të civilizimit në një shoqëri demokratike. Në fakt, ndërhyrja e shtetit për të rregulluar ligjërisht këto marrëdhënie, ka të bëjë me mbrojtjen e palëve më të dobëta të një marrëdhënieje siç janë gratë dhe fëmijët. Rëndësia e dyfishtë që merr familja, si institut i të drejtës private dhe publike justifikohet pikërisht nga interesi publik për të mbrojtur këto kategori pavarësisht nëse bëhet fjalë për familje të krijuara nga martesë apo nga bashkëjetesa faktike. Familja meriton mbrojtje nga shteti jo vetëm si njësi biologjike por (dhe mbi të gjitha) si njësi sociale që i përshtatet zhvillimit shoqëror në periudha të ndryshme historike.

1. Bashkëjetesa: nga fenomen në institut i të drejtës familjare

Nocioni i familjes merr kuptim të shumëfishtë si në këndvështrim historik ashtu edhe në lidhje me modelet e ndryshme që gëzojnë mbrojtje në mënyrë paralele brenda të njëjtit shtet. Në këndvështrim, në traditën shqiptare, Kanuni i Lekë Dukagjinit ndalonte bashkëjetesën duke parashikuar sanksione të ashpra, ndërkohë që Kanuni i Skënderbeut dallonte dy forma martesë, me kurorë dhe pa kurorë. Në legjislacionin civil të periudhës zogiste, ligji nr. 15180, datë 16.3.1931 “Mbi ndalimin e bashkëjetesave si bashkëshortë ilegale”, parashikonte se ata që bashkoheshin si burrë e grua sipas zakoneve të vendit për martesë dhe gjendeshin pa e celebruar martesën sipas ligjit, ndëshkoheshin me gjobë, burgim ose internim¹. Më pas, gjatë regjimit monist u miratua ligji nr. 224, datë 25.5.1946 “Mbi legalizimin e bashkëjetesave të ndaluara”. Për efekte të këtij ligji, bashkëjetuesit duhej të lidhnin dhe regjistronin martesën përpara nëpunësit të Gjendjes Civile brenda 6 muajve nga hyrja e tij në fuqi². Regjistrimi i martesës sillte për pasojë shuarjen e padisë penale: në këtë rast, përjashtimisht nuk kërkohej as dhënia e pëlqimit për martesë. Në vijim, dekreti nr. 3161, datë 10.10.1960 “Për ndalimin e bashkëjetesave si bashkëshortë, pa lidhur martesë”, sanksiononte dënimin me gjobë deri në 1000 lekë, burrin që jetonte me një grua si bashkëshortë, pa lidhur martesë të rregullt përpara nëpunësit të Gjendjes Civile. Fenomeni i bashkëjetesave në çift filloi të përhapej në vitet '90 dhe gjeti njohje ligjore për herë të parë në Kodin aktual të Familjes, të vitit 2003. Siç vihet re, ndryshimet e ndjeshme në shoqërinë shqiptare çuan jo vetëm në njohjen formale të Institutit të bashkëjetesës, si lidhje mes një burri dhe një gruaje, por edhe në dekriminalizimin e atyre veprimeve që konsideroheshin si të turpshme, sipas parashikimeve në Kodin Penal të Zogut³, të vitit 1952⁴ dhe 1977⁵.

Koncepti i bashkëjetesës sipas nenit 163 KF i referohet kuptimit të saj *strictu sensu*, si Institut i veçantë i të drejtës familjare, që do të thotë: *lidhje faktike me*

¹ “Burri dënohej me heqje lirie nga një deri në 6 muaj ose me internim nga dy muaj deri në një vit, ndërsa gruaja me një burgim deri në një muaj ose me gjobë deri në 500 franga ari. Kjo përgjegjësi shtrihej edhe mbi ata persona që kishin kujdestarinë mbi ta të cilit kishin dijeni si dhe mbi pleqësinë e fshatit dhe kryetarin e këshillit të fshatit të cilët nuk kishin lajmëruar autoritet e sigurimit publik ose prokurorin”. Shih MANDRO A., *E drejta familjare*, Emal, Tiranë, 2009, fq. 264.

² “Lehtësohej lidhja e martesave mes personave që kishin ndalime për martesë: ndalimi nga gjinia në vijë të tërthortë kufizohet deri në shkallë të tretë. Për të miturit nuk kërkohej pëlqimi i prindërve, i të paralindurve ose i këshillit familjar”. Shih MANDRO A., *op. cit.*, fq. 265.

³ Në kapitullin “Turpime të kundra natyrshme”, në nenin 377 thuhet: “Ay që ban veprën e turpënit të kundra natyrshme (...) ndëshkohet me burgim të randë nga tre muej, deri në dy vjet ose me internim nga një deri në pesë vjet dhe në të dy rastet ndëshkimit i shtohet edhe gjoba e randë, si dhe ndalimi i përkohshëm nga ofiqet publike. Po me këto ndëshkime dënohet edhe ay që turpënohet në këtë mënyrë (...)”.

⁴ Në kapitullin “Krime kundër moralit shoqëror”, neni 289 sanksiononte se: “Pederastia, d.m.th. marrëdhëniet seksuale ndërmjet meshkujve, dënohet: me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet”.

⁵ Në nenin 137 sanksionohej: “Pederastia dënohet: me heqje të lirisë, gjer në dhjetë vjet”.

karakter të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm mes një burri dhe një gruaje që jetojnë në çift. Në dispozita të tjera ligjore, koncepti i bashkëjetesës është dhënë në kuptimin *latu sensu*, si të jetuarit së bashku mes individëve dhe jo vetëm në çift, si burrë e grua. Kështu p.sh., neni 363 i Kodit Civil (KC), përfshin në kategorinë e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së dytë, edhe *personat e paaftë për punë të cilët, të paktën brenda 1 viti nga vdekja e trashëgimlënësit bashkëjetonin me atë dhe ishin në ngarkim të tij*; neni 130 i Kodit Penal (KP) sanksionon se *shtrëngimi apo pengimi për të filluar apo vazhduar bashkëjetesën dënohet me burgim gjer në tre muaj*; neni 72 i kodit të Procedurës Civile (KPRC) parashikon *detyrimin për gjyqtarin të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje kur ai vetë ose bashkëshortja e tij bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët ose nga mbrojtësit*; neni 37/2 Kodit të Procedurave Administrative (KPRA) parashikon *skualifikimin e punonjësve të organeve të administratës nga proceset vendimmarrëse administrative për arsye se bashkëjetuesi i tij ka një interes direkt ose indirekt në çështjen në fjalë.* Në të kundërt, kuptimin *strictu sensu* të bashkëjetesës e gjejmë p.sh. në nenin 5 të Kodit të Punës, sipas të cilit *përrjashtohen nga fusha e zbatimit të KP punët familjare të kryera nga partnerët bashkëjetues* apo në ligjin kundër dhunës në familje i cili mbron bashkëjetuesit si kategori më vete, krahas bashkëshortëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes⁶.

Nga pikëpamja e modeleve familjare paralele, mjafton të përmendim mënyrat e ndryshme të rregullimit ligjor të familjes brenda të njëjtit legjislacion të cilat parashikojnë njëkohësisht rregulla për martesën dhe për format e tjera të bashkëjetesës çift, qofshin këto të regjistruara ose të paregjistruara. Kështu p.sh. vendet skandinave (Finlanda, Norvegjia, Danimarka dhe Zvicra) kanë garantuar mbrojtje të çifteve faktike qoftë heteroseksuale, qoftë homoseksuale, nëpërmjet regjistrimit në regjistrat e gjendjes civile, me qëllim që të mund të përfitojnë nga legjislacioni vendas në fuqi. Në Francë, gjithashtu, ligji mbi *PACS*, datë 12.10.1999, rregullon marrëdhëniet mes çifteve faktike nëpërmjet regjistrimit në një regjistër të posaçëm. Ky ligj nuk përfshin në rregullimin ligjor të martesës në këtë kategori, por në atë që krijon një sistem paralel me të. Në Belgjikë ligji mbi “bashkëjetesën ligjore” njeh autonominë e palëve në rregullimin e marrëdhënies me kufizimin e respektimit të rendit publik dhe të normave morale. Në Spanjë, ligji nr. 13/2005 nuk u kufizua vetëm në njohjen ligjore të lidhjeve faktike homoseksuale, por solli një ndryshim radikal në vetë konceptin e martesës⁷. Ligji holandez, datë 5 korrik 1997, ashtu si ligji spanjoll, ndryshon kuptimin e martesës duke përfshirë në

⁶ Sipas përkufizimit të nenit 3.3 të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006, i ndryshuar. Shih ANASTASI A., *Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar*, Broshurë e realizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, botim i vitit 2010, fq. 26.

⁷ Në Suedi në rast vdekjeje të njërit nga bashkëjetuesit e një lidhjeje të regjistruar, bashkëjetuesi tjetër, ka të drejtë të përfitojë gjysmën e pasurisë. Në Francë, neni 44 i K.C. u ndryshua duke parashikuar se martesë do t'i nënshtrohet të njëjtave kushteve të parashikuara për lidhjen e saj si dhe se do të ketë të njëjtat pasoja nëse bashkëshortët do të jenë të të njëjtit seks. Për më gjerë, shih ASPREA S., *Famiglia di fatto*, 2 ed. Giuffrè, Milano, 2011, fq. 45-69.

të edhe lidhjet homoseksuale. Megjithatë, bashkëjetesat e regjistruara nuk janë e vetmja kategori që gëzojnë mbrojtje. Në Britaninë e Madhe përveç çifteve të regjistruara, garantohej edhe disa të drejta të çifteve të paregjistruara, qofshin ato homoseksuale ose heteroseksuale. Kësaj kategorie i njihen të drejta trashëgimore, të drejta të lidhura me Sigurimet shoqërore, të drejta që rrjedhin nga politikë fiskale, përveç të drejtës së emigracionit dhe të bashkimit familjar⁸.

2. Baza ligjore për mbrojtjen e familjes të krijuar nga bashkëjetesa faktike

Eksperienca e vendeve europiane të sapo përmendura, në rregullim ligjor të bashkëjetesës, është tregues i përhapjes së fenomenit dhe nevojës për garantimin e disa të drejtave, si të drejta themelore të njeriut. Mbrojtja e familjes si bërthama e shoqërisë, e sanksionuar në aktet më të rëndësishme ndërkombëtare⁹, garantohej nga neni 53 i Kushtetutës shqiptare dhe nga parimet e përgjithshme të Kodit të Familjes. Neni 53 i Kushtetutës sanksionon të drejtën për të pasur familje, si një të drejtë më vete dhe të pavarur nga e drejta për t'u martuar, duke i garantuar mbrojtje të veçantë secilës prej tyre (martesës dhe familjes). Kodi i Familjes, përcakton një mënyrë alternative (ndaj martesës) për të krijuar familje, përkatësisht në nenin 163, sipas të cilit bashkëjetesa është bashkim fakti *mes burrit dhe gruas* që jetojnë në çift (...). Kufizimi i institutit i bazuar në diversitetin e seksit mes bashkëjetuesve, lë vend për diskutim dhe gjithashtu ngre dyshimin e arsyeshem të një formulimi që nuk përputhet me frymën e parashikimit kushtetues, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 8 KEDNj, si dhe të interpretimit të kësaj dispozite nga Gjykata e Strasburgut.

Në fakt, nga pikëpamja e burimeve të së drejtës, vetë Kushtetuta ka parashikuar mundësinë e kufizimit me ligj të të drejtave dhe lirive të parashikuara në të. Kështu kufizimi i të drejtës për të krijuar familje në favor të çifteve heteroseksuale, duke përjashtuar ato homoseksuale, të bën të mendosh për një arsytim në emër të mbrojtjes së “një interesi publik, ose të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve”. Nga ana tjetër, Kushtetuta parashikon se: “kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë” (neni 17/ i Kushtetutës). Shtrohet pyetja: cili është interesi publik i mbrojtur në këtë rast, apo cilat janë të drejtat e të tjerëve që vihen në rrezik nga njohja e institutit të bashkëjetesës edhe në favor të çifteve homoseksuale, që justifikon këtë kufizim? Nëse qëllimi i parashikimit të institutit të bashkëjetesës

⁸ FANTETTI F., *Diritto di famiglia e diritti dei familiari*, Maggioli, Rimini, 2011, fq. 52.

⁹ Kështu p.sh. në nenin 23/1 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike: “Familja është njësi e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtë të ketë mbrojtjen e shoqërisë dhe të shtetit”; në nenin 9 të Kartës Europiane të të Drejtave Themelore “E drejta për t'u martuar dhe e drejta për të krijuar familje janë të garantuara”; në nenin 12 të KEDNj. i cili njeh burrave dhe grave “të drejtën të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve vendase që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte”.

në Kodin e Familjes është njohja e të drejtave që lindin nga një gjendje faktike, në thelb të ngjashme me ato në që lindin nga martesë, shtrohet pyetja: a është kufizimi i bashkëjetesës vetëm për çiftet heteroseksuale në përpjesëtim me mbrojtjen e interesit publik apo të të drejtave të të tjerëve?

Nga sa më sipër mbi hierarkinë e burimeve të së drejtës në sistemin ligjor shqiptar, në interpretimin e dispozitave në fjalë, duhen pasur parasysh angazhimet ligjore të ndërmarra në nivel ndërkombëtar nga shteti shqiptar, që rrjedhin nga aderimi në KEDNj, si dhe nga statusi i posaçëm që Kushtetuta shqiptare i ka njohur kësaj konvente, krahasuar me të tjera marrëveshje ndërkombëtare. Në fakt, neni 17/2 i Kushtetutës parashikon shprehimisht se “kufizimet në fjalë nuk mund të cenojnë thelbin e të drejtave dhe lirive themelore dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

Neni 8 i KEDNj sanksionon të drejtën për jetë private dhe familjare. Kuptimi që i është dhënë kësaj dispozite nga GjEDNj ka evoluar në kohë: nga referimi në konceptin tradicional të familjes të krijuar nga martesë, në atë që njeh format e reja të krijimit të familjes nga bashkëjetesa në çift. Interpretimi i kësaj dispozite favorizonte fillimisht vetëm lidhjen bashkëshortore, si të vetmen formë të krijimit të jetës familjare. Më pas, duke u bazuar në interpretimin evolutiv të institutit, në parimin e mosdiskriminimit (neni 14 KEDNj) si dhe në parimin e efektivitetit, GjEDNj ka përfshirë në nocionin e familjes burrin dhe gruan të lidhur nga një marrëdhënie afektive, edhe pse jashtë martesë, dhe së fundi ka njohur “të drejtën e çifteve gay për jetë familjare”.

Në dallim nga orientimi i mëparshëm i saj, Gjykata e Strasburgut, në çështjen *Scalk dhe Kopf kundër Austrisë*¹⁰, u shpreh për herë të parë se marrëdhëniet mes çifteve të të njëjtit seks nuk mund të konsiderohen më në kuadrin e të drejtës private, por në atë të jetës familjare¹¹. Vendimi në fjalë i referohej në radhë të parë pamundësisë për të zbatuar nenin 12 KEDNj (e drejta për martesë) edhe për çiftet homoseksuale. Së fundi, në vitin 2013, në çështjen *Vallianatos dhe të tjerë kundër Greqisë*, GjEDNj u shpreh se: “kur një Shtet vendos të përfshijë në rendin e tij të brendshëm çfarëdo forme të lidhjeve civile, ai nuk mund të përjashtojë çiftet e të njëjtit seks”¹². Kjo për faktin se në vitin 2008 Greqia e kufizoi rregullimin normativ të të ashtuquajturave “Marrëveshjet e lira të bashkëjetesës”, vetëm për çiftet heteroseksuale duke përjashtuar ato homoseksuale.

Nga ana tjetër, mbi rëndësinë e institutit të bashkëjetesës është shprehur edhe Gjykata e Drejtësisë, e kufizuar kryesisht në rastet e bashkimit familjar të punëtorëve komunitarë me familjarët e tyre. Pamundësia për të gjetur një

¹⁰ Me kusht që lidhja të ketë zgjatuar një farë kohe dhe të ketë qenë e qëndrueshme (p.sh. të kenë bashkëjetuar, të kenë lindur fëmijë etj.)

¹¹ Partnerët i kërkoi gjykatës që e drejta për martesë dhe për të krijuar familje, sanksionuar në nenin 12 KEDNj të shtrihet edhe për çiftet homoseksuale. Shih vendimin e GjEDNj aplikimi n. 30141/04, datë 24 qershor 2010.

¹² Vendimi i GjEDNj, datë 7 nëntor 2013, aplikimi n. 29381/09 dhe aplikimi n. 32684/09.

emërues të përbashkët mbi rregullimin ligjor të lidhjeve në çift jashtë martesore ndërmjet vendeve anëtare të BE-së, ka bërë që pozicioni i bashkëshortit/es dhe ai i bashkëjetuesit/es të jetë i ndryshëm.

Ndalimi i çdo forme diskriminimi në bazë të orientimit seksual sanksionohet gjithashtu në Traktatin e Lisbonës, në Kartën e Nicës si dhe në KEDNj. Ndërkohë, Parlamenti evropian është shprehur prej vitesh për njohjen e “të drejtave të barabarta” lidhur me çiftet faktike. Në raportet vjetore mbi të drejtat civile (datë 16 mars 2000) dhe mbi të drejtat e njeriut (datë 15 janar 2003), Parlamenti evropian u ka kërkuar vendeve anëtare regjistrimin e çifteve faktike qofshin ato heteroseksuale ose homoseksuale. Në fakt, edhe pse njohja e martesave gay mbetet në varësi të diskrecionalitetit të secilit vend anëtar, Parlamenti evropian rekomandon adoptimin nga vendet anëtare të çdo lloji tjetër “Instituti ekuivalent”, që mund t’u garantojë çifteve homoseksuale të njëjtat të drejta dhe avantazhe që rrjedhin nga martesë. Së fundi, nëpërmjet Rezolutës datë 14 janar 2009, në lidhje me të drejtat themelore në BE, Parlamenti evropian u ka kërkuar vendeve anëtare të marrin masa për eliminimin e diskriminimit ndaj çifteve për shkak të orientimit të tyre seksual.

3. Problemet ligjore që rrjedhin nga bashkëjetesa në çift. Mungesa e kuadrin ligjor rregullues dhe roli i praktikës gjyqësore në Shqipëri

Duke u nisur nga përkufizimi i bashkëjetesës, sipas nenit 163 të Kodit të Familjes, si dhe nga mundësia që marrëdhëniet lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës të rregullohen me një marrëveshje mes palëve, sipas parashikimeve të nenit 164 të Kodit të Familjes, shtrohen disa pikëpyetje mbi bashkëjetesën dhe pasojat që ajo sjell¹³.

1. Cila është rëndësia e përfshirjes së neneve 163, 164 KF, nëse ajo nuk përvijohet nga dispozita të tjera plotësuese? A mund të shtrihen mbi bashkëjetuesit, dispozitat ligjore të parashikuara për bashkëshortët nga Kodi i Familjes, dhe nëse po deri në ç’masë? Si do të vlerësohet kriteri i stabilitetit dhe i vazhdueshmërisë së bashkëjetesës?

Neni 163 KF jep kuptimin e bashkëjetesës, ndërsa neni 164 KF parashikon mundësinë e rregullimit të pasojave që rrjedhin nga martesë për: a) pasurinë dhe b) fëmijët. Problemi i pasojave që sjell bashkëjetesa në çift nuk shtrohet për marrëdhëniet prind-fëmijë sepse parimi i trajtimit të barabartë të fëmijëve të lindur

¹³ Mbi mungesën e pasojave juridike morale dhe materiale në lidhje me personat që bashkëjetojnë *more uxorio* si dhe domosdoshmërinë e një rregullimi juridik të posaçëm për bashkëjetesën në çift, shih OMARI S., *E drejta familjare*, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2007, fq. 31-32. Autorja vë theksin mbi natyrën juridike të marrëveshjes të parashikuar në nenin 164 të KF si kontratë jotipike, për të cilën do të gjejmë zbatim dispozitat e Kodit Civil mbi veprimin juridik dhe mbi detyrimet.

nga martesë dhe jashtë saj bën që dispozitat e Kodit të Familjes të gjejnë zbatim edhe për këtë kategori¹⁴. Mënyra e ushtrimit të përgjegjësive prindërore mund të parashikohet shprehimisht në marrëveshje, por gjithsesi në rast mosmarrëveshje mes partnerëve bashkëjetues, vlerësimi i mënyrës së ushtrimit të saj do të bëhet nga gjykata mbi bazën e parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës.¹⁵

Për sa i përket marrëdhënive pasurore, shprehja e lirisë (autonomisë) kontraktore është parashikuar shprehimisht në nenin 660 KC: “Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi”. Sigurisht që nëse bashkëjetuesit do të detyroheshin të respektonin dispozitat ligjore të parashikuara për martesën, atëherë do t’u imponohej një zgjedhje që bie ndesh me vullnetin e tyre të lirë për të mos lidhur martesë. Megjithatë, shtrohet pyetja nëse mund t’iu garantohen disa të drejta (të njohura tashmë në disa vende të tjera europiane), kur bashkëjetesa ka rezultuar e konsoliduar në kohë dhe partnerët kanë kontribuar respektivisht në të ashtuquajturin *ménage* familjar. Kështu p.sh.

a) E drejta për të trashëguar në trashëgiminë ligjore dhe testamentare.

Neni 360 i K.C. përfshin në kategorinë e trashëgimtarëve ligjore *personat e paafte për punë në ngarkim të trashëgimlënësit*, të cilët mund të thirren në trashëgimi në radhën e dytë ose të tretë (nenet 363, 364 të KC). Shtrohet pyetja nëse partneri bashkëjetues mund të konsiderohet si person në ngarkim të trashëgimlënësit? Në favor të trashëgimtarëve që bashkëjetonin me trashëgimlënësin në kohën e vdekjes së tij, neni 368 i KC, parashikon gjithashtu edhe të drejtën për të marrë tej pjesës që u takon në pasurinë trashëgimore, sendet shtëpiake të përdorimit të zakonshëm. Për sa i përket të drejtave si trashëgimtarë ligjorë të fëmijëve të lindur nga bashkëjetesa, këta barazohen me fëmijët e lindur nga martesë me kusht që *amësia ose atësia të jenë njohur rregullisht* (neni 362 i KC).

Për sa i përket trashëgimisë testamentare, partnerët bashkëjetues mund të disponojnë lirisht pasurinë e tyre sipas përcaktimeve të KC duke respektuar dispozitat mbi rezervën ligjore.

b) Kontributi kompensues në rast zgjidhjeje martesë.

Shtrohet pyetja: A do të ketë të drejtë të përfitojë kontributin kompensues ish bashkëshorti që bashkëjeton me një person tjetër. A ndikon bashkëjetesa mes ish-bashkëshortit dhe një personi të tretë në masën e kontributit kompensues që

¹⁴ Neni 4 i KF parashikon se: “Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si fëmijët e lindur nga martesë”. Ky parim rrjedh edhe nga aderimi i Shqipërisë në Konventën Europiane “Për statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martesë”, si vend anëtar i Këshillit të Europës.

¹⁵ Në fakt, një shembull të kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijëve të lindur jashtë martesë në legjislacionin shqiptar, e gjejmë në periudhën e sistemit monist, përpara se të sanksionohej parimi i barazisë së fëmijëve të lindur nga martesë dhe jashtë saj, në Kodin e Familjes të vitit 1982. Shih VKM nr.171, datë 14.5.1962 “Mbi kriteret e pranimit të fëmijëve në shtëpitë e foshnjës”, i cili përfshin në kategorinë e fëmijëve që pranohen në shtëpitë e foshnjës, fëmijët e lindur jashtë martesë (neni 3/a).

detyrohet të derdhë ish-bashkëshorti tjetër në rastin e zgjidhjes së martesës? Neni 148 i KF në paragrafin e fundit, përcakton se kontributi kompensues ndërpritet “nëse ish-bashkëshorti përfitues lidh martesë të re”. A mund t’i referohemi interpretimit me analogji, për të arritur në konkluzionin se ndërprerja e kontributit kompensues do të zbatohet edhe në rastin kur ish-bashkëshorti përfitues krijon një lidhje të re bashkëjetese me një person tjetër? Jurisprudenca italiane i ka dhënë përgjigje pozitive pyetjes në fjalë, duke specifikuar se në këtë rast, përfitimet që ka ish-bashkëshorti përfitues nga bashkëjetesa efektive (që përfshin interesa morale, afektive dhe pasurore), nuk duhet të kenë karakter të përkohshëm ose kalimtar¹⁶.

c) Detyrimi për ushqim.

Për sa i përket detyrimit për ushqim, shtrohet pyetja nëse ky detyrim mund të shtrihet edhe për familjen faktike. Dispozitat e Kodit të Familjes dhe të Kodit Civil i referohen shprehimisht marrëdhënive që lindin nga martesë mes bashkëshortëve ose nga lidhjet gjinore mes anëtarëve të familjes. Mund të argumentohet se përjashtimisht, bashkëjetuesi do të jetë i detyruar të përmbushë detyrimin për ushqim në preferencë kundrejt çdo të detyruari tjetër, vetëm nëse ka qenë përfitues i dhurimit të kryer në favor të tij nga partneri në nevojë (neni 193 i KF). Në lidhje me raportin prind/fëmijë të krijuar nga bashkëjetesa, prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim edhe sikur t’iu jetë hequr përgjegjësia prindërore (neni 195 i KF).

d) E drejta për të përfituar nga pensioni familjar, si pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit.

Ligji “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” nuk përfshin në kategorinë e subjekteve të legjitimuar të përfitojnë pension familjar bashkëjetuesin¹⁷. Kategoritë që mund të përfitojnë pension familjar sipas dispozitës në fjalë, nëse plotësohen kushtet e parashikuara në ligj, janë: a) e veja, b) burri i ve, c) jetimi, ç) prindërit, prindërit e prindërve, d) nipërit e mbesat. E veja dhe burri i ve humbasin të drejtën për pension familjar kur martohen. Nga ana tjetër, dispozita e nenit 40/3 i ligjit e cila parashikon shprehimisht se “E veja dhe personi i ve humbasin të drejtën për pension familjar kur martohen”, nënkupton gjithashtu se bashkëjetesa në çift nuk sjell humbjen e kësaj të drejte.

e) E drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit moral dhe pasuror për shkak të vdekjes së bashkëjetuesit.

Sipas praktikës gjyqësore shqiptare: “legjitimim aktiv gëzon edhe personi që pretendon se bashkëjetonte me viktimën pa lidhur martesë me të (*more uxorio*),

¹⁶ Sipas Gjykatës së Lartë italiane, bashkëjetesa do të konsiderohet e qëndrueshme nëse ajo ka zgjatuar 10 vjet. Shih vendimin nr. 4158 datë 17.10.1989, në ASPREA S., *La famiglia di fatto*, 2 ed. Giuffrè, Milano, 2009, fq. 288.

¹⁷ Neni 40 i ligjit nr. 7703 datë 11.5.1993 i ndryshuar.

me kusht që të vërtetohet ekzistenca e bashkëjetesës së qëndrueshme ndjesore dhe ekonomike me të lënduarin a viktimën¹⁸. I dëmtuari mund të provojë shkaktimin e dëmit moral me anë të prezumimit të thjeshtë se, sa më e afërt është lidhja gjinore familjare apo e bashkëjetesës, aq më i rëndë është edhe turbullimi e dhimbja shpirtërore e të afërmit të të lënduarit apo viktimës, pra aq më e lartë është shuma e dëmshpërblimit moral që duhet t'i caktohet nga gjykata”.

2. A mund të gëzojë mbrojtje në legjislacionin shqiptar bashkëjetesa e krijuar gjatë ekzistencës së një lidhjeje martesore? Ndalimet për lidhjen e martesës i referohen vetëm poligamisë ligjore dhe jo asaj faktike. Mund të argumentohet se përderisa neni 163 i KF parashikon si elementë ligjorë të bashkëjetesës jetën e përbashkët që paraqet karakter stabiliteti dhe vazhdueshmëri, ekzistenca e një lidhjeje martesore paralele me lidhjen e bashkëjetesës do të bënte të pamundur përmbushjen njëkohësisht të detyrimeve që rrjedhin nga martesa dhe të atyre që rrjedhin nga bashkëjetesa. Për më tepër, edhe vendet që rregullojnë me ligje të posaçme bashkëjetesën në çift (si *Civil Partnership* në Britaninë e Madhe, *Registered Partnership* në Finlandë dhe Danimarkë, *PACS* në Francë etj.), parashikojnë si ndalime për regjistrimin e tyre ekzistencën e një martese apo të një lidhjeje tjetër të regjistruar.

3. Si ndikon bashkëjetesa në bashkimin familjar në Shqipëri?

Ligji “Për të huajt” i vitit 2013 sjell risi në këtë drejtim në raport me ligjin e mëparshëm të vitit 2008. Sipas nenit 3/14 Ligji Nr. 108/2013 “Për të huajt”: “Anëtarë të familjes” së të huajit janë (...) bashkëjetuesit/bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar (...); Sipas nenit 62/2 të këtij Ligji, “Bashkëjetuesit trajtohen njëllor për aq sa është e zbatueshme, si bashkëshortët, lidhur me bashkimin familjar”.

A janë parashikimet e neneve 163 dhe 164 të KF në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare? Në këtë kuptim duhet medoemos të mbajmë në konsideratë hierarkinë e burimeve të së drejtës shqiptare, lidhur me normativën mbi të drejtën familjare, përkatësisht nenin 5 të Kushtetutës, i cili sanksionon detyrimin për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, dhe nenin 17 të cituar tashmë, mbi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, të brendësuar në tekstin kushtetues, sipas të cilit: *kufizimet e të*

¹⁸ Në veçanti, me humbjen e jetës, krahas përkujdesjes, viktimë e mitur nuk mund të kontribuojë më, me të ardhurat që do të siguronte në të ardhmen, në mbajtjen e familjarëve pasjetues me të cilët kishte lidhje gjinore (familjare) shumë të afërt dhe një bashkëjetesë të qëndrueshme, ekonomike dhe afektive (neni 163 i KF). E drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit moral në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht (*ius proprius*) edhe secilit prej familjarëve të afërt të personit që ka humbur jetën apo i është cenuar shëndeti nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkëjetesës. Shih, Gjykata e Lartë, Vendim Unifikues nr. 14, datë 14.09.2007, fq. 17.

drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë, në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (neni 17/2 i Kushtetutës).

Konkluzione

Nga analiza e institutit të bashkëjetesës dhe evolucionit të tij deri në legjislacion aktual shqiptar vihen re disa probleme që kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë e dispozitave të Kodit të Familjes për ta rregulluar atë. Në radhë të parë, për sa i përket konceptit, u argumentua se parimi i heteroseksualitetit i parashikuar në nenin 163 të KF, si kusht për njohjen e institutit nga legjislacioni shqiptar, rrezikon të paraqesë aspekte që nuk përputhen me Kushtetutën, nën dritën e interpretimit të nenit 8 të KEDNj, Konventë kjo drejtpërdrejtë e zbatueshme dhe që ka epërsi mbi ligjin shqiptar që vjen në kundërshtim me të¹⁹. Ky interpretim sipas konsideratave më të fundit në vendimet e argumentuara në punim, merr në konsideratë ndryshimet aktuale në shoqëri, dhe për pasojë nevojën për përshtatje në terma normues të saj me realitetin në evoluim e sipër. Parimi i përgjithshëm që ndiqet në përcaktimin e ekzistencës së marrëdhënieve familjare është *ekzistenca e lidhjeve të ngushta personale* midis palëve²⁰.

Aktualisht kadri ligjor vendas në mbrojtje të të drejtave dhe lirive që mund të lindin nga bashkëjetesa paraqitet modest dhe lë shumë për të dëshiruar. Parimi i efektshmërisë të mbrojtjes të këtyre të drejtave dhe lirive, ngarkon shtetet anëtare me detyrime me karakter pozitiv (të cilat shkojnë përtej mosveprimit nga ana e tyre dhe nënkuptojnë veprimtarinë e autoriteteve shtetërore) që këto shtete kanë ndërmarrë me nënshkrimin apo aderimin në Konventë. Në këtë vakum ligjor, edhe roli i praktikës gjyqësore shqiptare ka qenë sporadik. Në fakt, praktika gjyqësore e deritanishme është kufizuar në njohjen e të drejtës së shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga vdekja e bashkëjetuesit, por ka lënë shumë për të dëshiruar lidhur me një spektër të gjerë të drejtash morale dhe pasurore që mund të lindin nga bashkëjetesa.

Për këtë arsye, do të ishte e arsyeshme nisja e procesit për hartimin e një ligji të posaçëm, me qëllim rregullimin e aspekteve personale dhe pasurore mes bashkëjetuesve në çift. Eksperienca e vendeve të tjera europiane, si ato të

¹⁹ Mbi epërsinë e KEDNj dhe domosdoshmërinë e përputhshmërisë së ligjeve me të, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese shqiptare përbën një tjetër burim të pasur normativ orientues. Gjykata Kushtetuese i është referuar vazhdimisht kësaj konvente lidhur me standardet që domosdoshmërisht duhen respektuar lidhur me liritë dhe të drejtat e parashikuara në të dhe protokollet e saj. Në këtë kuptim, shih vendimet 65/1999, 25/2002, 15/2003, 16/2004, 30/2006, 4/2011 e të tjera të Gjykatës Kushtetuese.

²⁰ Shih *Soderback kundër Suedisë*, gjykimi i 28 tetorit 1998, në *E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Ursula Kilkelly, botim i Këshilli të Europës, 2011, fq. 17.

regjistrimit të lidhjeve faktike në çift në regjistra të posaçëm, mund të shërbejë si udhëzues në hartimin e një legjislacioni në përputhje me angazhimet e ndërmarra në nivel ndërkombëtar. Përfshirja në kategorinë e partnerëve bashkëjetues edhe të çifteve homoseksuale do të ishte koherente edhe me orientimet e dhëna nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, nëpërmjet interpretimeve të vazhdueshme në këtë drejtim të normave të konventës dhe protokolleve të saj, duke përfshirë në konceptin e të drejtës për jetë familjare, edhe këtë kategori.

Bibliografia

Akte ndërkombëtare

Konventa Europiane për të drejtat e Njeriut

Konventa Europiane "Për statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese".

Rezoluta e Parlamentit europian, datë 14 janar 2009.

E drejta për respektimin e jetës private dhe Familjare. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Ursula Kilkelly, botim i Këshilli të Europës, 2011.

Literaturë juridike

MANDRO A., *E drejta familjare*, Emal, Tiranë, 2009.

BIANKU L., *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, Qendra Europiane – Këshilli i Europës dhe Komisioni Europian, 2007

OMARI S., *E drejta familjare*, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2007

ANASTASI A., *Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar*, Broshurë e realizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, botim i vitit 2010.

PRENÇI D., *Dritëbije në familjen shqiptare*, Globus, Tiranë, 2009

ASPREA S., *La famiglia di fatto*, 2 ed. Giuffrè, Milano, 2009.

BIANKU L., *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, Qendra Europiane – Këshilli i Europës dhe Komisioni Europian, 2007

FANTETTI F. R., *Diritto di famiglia e diritti dei familiari*, Maggioli, Rimini, 2011.

Praktikë gjyqësore

GjEDNj, *Vallianatos dhe të tjerë kundër Greqisë*, vendimi datë 7 nëntor 2013.

GjEDNj *Schalk dhe Kopf kundër Austrisë*, vendimi datë 24 qershor 2010.

GjEDNj *Soderback kundër Suedisë*, vendimi datë 28 tetorit 1998.

Vendime të Gjykatës Kushtetuese shqiptare 65/1999, 25/2002, 15/2003, 16/2004, 30/2006, 4/2011

Vendimi nr. 4158, datë 17.10.1989 i Gjykatës italiane të Kasacionit.

Gjykata e Lartë, Vendim Unifikues nr. 14, datë 14.09.2007.

V.K.M. nr.171, datë 14.5.1962 "Mbi kriteret e pranimit të fëmijëve në shtëpitë e foshnjës".

Liria sindikale sipas jurisprudencës së GJEDNJ- së

Msc. Ina Xhepa

Abstrakt

Njohja dhe zbatimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është një nga sfidat kryesore të çdo sistemi ligjor demokratik. Europa sikurse është botërisht e ditur po shkon drejt një unifikimi të sistemeve ligjore dhe praktikës gjyqësore, në kuadër të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky punim synon të trajtojë në mënyrë të përmbledhur një çështje tepër relevante, siç është e drejta e punëmarrësve për t'u organizuar në sindikata.

E drejta sindikale përfaqëson tërësinë e normave juridike, që rregullojnë pozitën ligjore të organizatave profesionale, kontratave kolektive, të drejtën e grevës, si edhe konfliktet potenciale në marrëdhënien juridike të punës. Kjo e drejtë njihet dhe garantohet nga neni 11 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nga i gjithë sistemi ligjor vendas në rend hierarkik. Pavarësisht rregullimeve normative, që i janë bërë kësaj të drejte në vendin tonë, ende hasen problematika. Për këtë arsye vlen të analizohen standardet e vendosura nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtën sindikale, të cilat duhet të zbatohen edhe në sistemin tonë, si një "qonditio sine qua non" për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Fjalë kyç: KEDNJ, e drejtë sindikale, liria e shprehjes, jurisprudencë e GJEDNJ-së

Edrejta sindikale përfaqëson tërësinë e normave juridike, që rregullojnë pozitën juridike të organizatave profesionale, kontratat kolektive, të drejtën e grevës si dhe zgjidhjen e konflikteve të punës¹. Liria për t'u organizuar në formën e sindikatave për të gjithë punëmarrësit gëzon një mbrojtje kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndër aktet më të rëndësishme ndërkombëtare mund të përmendim konventat

¹ Uka, Nj. (2011). *Fjalor i Drejtësisë*. Tiranë: botimet Iliar, f. 199.

dhe rekomandimet e nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Punës², Neni 11 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut³ dhe Karta Sociale Europiane⁴. Në aktet juridike ndërkombëtare jo vetëm që theksohet parimi i lirisë së shoqatave sindikale, por në të njëjtën kohë njihet dhe e drejta për kontratat kolektive, e drejta e grevës⁵. Sigurisht nuk mund të lemë pa përmendur këtu dhe parashikimet, që i ka bërë lirisë sindikale Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁶ në nenet 46, 49, 50 dhe 51 të saj, Kodi i Punës⁷ në nenet 176 e vijues të tij. Gjithashtu, në korpusin e normave të vendit tonë ekziston dhe një ligj i posaçëm, i cili parashikon rregullimet ligjore specifike për sindikatat⁸.

Këtë punim zgjodhëm ta nisim në mënyrë klasike me një përkufizim në pamje të parë statik, i cili kornizon të drejtën sindikale dhe një renditje të normave ligjore të cilat rregullojnë atë. Natyrisht, tërësia e normave dhe e rregullave, që “disiplinojnë” një fushë të së drejtës nuk mund të analizohet në mënyrën e duhur nëse nuk shqyrtohen rastet praktike ku këto norma janë vënë në zbatim, ose janë marrë në shqyrtim. Për një analizë sa më të plotë shpesh duhet ndalur dhe tek “përplasja”, që normat e një fushe të caktuar të së drejtës ndeshin me fushat e tjera. Ky punim do të analizojë disa nga vendimet më të rëndësishme të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, të cilat kanë në thelb të tyre lirinë sindikale.

Qëllimi i lirisë sindikale

Neni 11 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut sanksionon të drejtën e tubimit dhe organizimit.⁹ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, institucioni përgjegjës për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në

² Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) është një agjenci e OKB-së, themeluar në 1919 në Gjenevë, Zvicër. ILO përbën një nga organizatat e para në nivel ndërkombëtar për rregullimet në fushën e marrëdhënieve të punës. Ndër konventat e ILO-s që lidhen me të drejtën sindikale janë Konventa Nr. 87 dhe Konventa Nr.98.

³ Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut neni 11 - Liria e tubimit dhe e organizimit.

⁴ Karta sociale Europiane nënshtruar në 18 Tetor 1961, Torino, Itali.

⁵ Cela. K. (2010). *E drejta e Punës*, Tiranë:botimet Iliar, f. 531.

⁶ Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Neni 46§1 ”Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.

⁷ Ligji nr. 7961 datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁸ Ligji nr. 7516 datë 07.10.1991 “Për sindikatat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁹ Neni 11 i KEDNJ “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.”

Konventë, ka shqyrtuar shumë çështje në lidhje me të drejtën sindikale dhe qëllimin e saj.

Ndër vendimet kryesore, që sanksionoi parimet kryesore mbi sindikatat është ai i *Unionit Kombëtar të Policëve Belg kundër Belgjikës*¹⁰. Në këtë çështje kërkuesi apeloj faktin se Ministria e Punëve të Brendshme belge nuk konsultohet për vendimmarrje të rëndësishme me sindikatën e policëve, si organi më përfaqësues i punëmarrësve, duke kryer kështu një shkelje ligjore. Në këtë rast *GJEDNJ* nuk vërejti shkelje të nenit 11 të Konventës, duke u shprehur se kërkuesit kishin mënyra të tjera për të bashkëpunuar me qeverinë, përveç konsultimit me Ministrinë e Brendshme.

Gjykata e Strasburgut në këtë çështje nënvizoi parimet kryesore përsa i përket lirisë sindikale, ku ndër të tjera u theksua se në bazë të nenit 11 të Konventës çdo punëmarrës ka të drejtë për të krijuar një sindikatë dhe për t’iu bashkuar një sindikate. Gjithashtu, liria sindikale garanton të drejtën për t’u dëgjuar duke mbrojtur interesat e sindikatës dhe anëtarëve të saj. Megjithatë, jo në çdo rast ku mungon konsultimi, mund të cilësohet si shkelje e Konventës nga ana e shtetit të paditur.

Përsa i përket së drejtës për të lidhur *kontrata kolektive*, Gjykata në të kaluarën, ka deklaruar, në një moment të parë, që neni 11 i KEDNJ-së, nuk u garanton sindikatave të përfitojnë në mënyrë retroaktive të drejta. Ky vendim është marrë në çështjen *Schmidt dhe Dahlstrom kundër Suedisë*.¹¹ Kërkuesit, të cilët ishin profesorë në Universitetin e Stokholmit, në momentin e rinovimit të kontratës së punës, pretendonin se u ishte mohuar e drejta të përfitonin nga benefitet e kontratës kolektive në aspekt retroaktiv, si pasojë e faktit se ata kishin qenë pjesë e grevave të shumta të organizuara nga sindikata. Gjykata vërejti se nuk kemi të bëjmë me një cenim të Nenit 11 të *KEDNJ-së*, duke konsideruar se ky nen detyron, që legjislacioni kombëtar i vendeve anëtare të parashikojë të drejtën sindikale si një aspekt të së drejtës së tubimit, por nuk i detyron *Shtetet Anëtare* të parashikojnë rregullime të veçanta për anëtarët e sindikatave.

Sot, jurisprudenca e *GJEDNJ-së*, ka evoluar në qëndrimet dhe interpretimin e Konventës në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në të drejtën sindikale.

Në çështjen *Demir dhe Baykara kundër Turqisë*¹², Gjykata u prononcua mbi ndalimin e disa funksionarëve të bashkisë për të krijuar një sindikatë dhe shuarjen e të gjithave efekteve të kontratës kolektive të firmosur nga sindikata. Sindikata *Tum Bel Sen* e krijuar nga funksionarë të bashkive kishte si objekt të veprimtarisë së saj, mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të nëpunësve civil në shërbimin publik. *Tum Bel Sen* kishte nënshkruar në qytetin e Gaziatep-it, një kontratë kolektive, që rregullonte disa aspekte në lidhje me kushtet e punës, për pagat, shpërblymimet dhe shërbimet e asistencës sociale për një periudhë dy vjeçare. Kërkuesve u ishin

¹⁰ Çështja *Unioni Kombëtar i Policëve Belg kundër Belgjikës*, Strasburg 27 tetor 1975.

¹¹ Çështja *Schmidt et Dahlstrom kundër Suedisë*, Strasburg 6 Shkurt 1976.

¹² Çështja *Demir e Baykara kundër Turqisë*, GJEDNJ-2008.

mohuar të drejtat e parashikuara në këtë kontratë kolektive. Gjykata e Lartë e Turqisë u shpreh se edhe në rastet kur nuk do të kishte pengesa ligjore për krijimin e sindikatave nga ana e funksionarëve publikë, atyre nuk u lejohet nënshkrimi i kontratave kolektive në bazë të legjislacionit të brendshëm kombëtar. Gjykata arriti në konkluzionin se për të negociuar dhe nënshkruar kontratën kolektive midis nëpunësve të shërbimit civil dhe administratës shtetërore, duhet të ekzistojë rregullimi ligjor specifik, i cili në këtë rast nuk parashikohej në legjislacionin e Turqisë. Gjykata vërejtë se ushtrimi i të drejtës sindikale, mund të kufizohet për pjesëtarët e forcave të armatosura, të policisë dhe administratës shtetërore, por ky kufizim i parashikuar në nenin 11§2 të Konventës, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe duhet të kufizohet vetëm për ushtrimin e disa të drejtave, duke mos përfshirë këtu të drejtën e organizimit. Në interpretimin e ngushtë të nenit 11§2 të Konventës, GJEDNJ i u referua si praktikës gjyqësore¹³ tashmë të konsoliduar, po ashtu dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë.¹⁴ Gjykata u shpreh se nëpunësit e administratës, nuk mund të ishin të përjashtuar nga fusha e aplikimit të nenit 11. Gjykata, riafirmoi qëndrimin e saj se neni 11§1 *KEDNJ-së*, sanksionon të drejtën sindikale si një aspekt të rëndësishëm të së drejtës së organizimit. Sipas *GJEDNJ-së* qëllimi kryesor i këtij neni është mbrojtja e individit nga ndërhyrjet arbitrare nga ana e autoritetit shtetëror në ushtrimin e të drejtave të parashikuara në të, duke detyruar kështu shtetet, që të sigurojnë dhe garantojnë gëzimin e këtyre të drejtave. Sipas nenit 11 të *KEDNJ-së*, ndërhyrja e shtetit në gëzimin e së drejtës së mbrojtur është e lejuar vetëm në qoftë se është e parashikuar me ligj, për një qëllim të ligjshëm dhe ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike¹⁵. Gjykata përcaktoi që neni 11§2 i Konventës duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe kufizimi i të drejtave të garantuara në paragrafin e parë të nenit 11, mund të bëhet vetëm për arsye objektive.

Përsa i përket të drejtës për lidhjen e kontratës kolektive, GJEDNJ u shpreh se: kontrata kolektive është një mjet thelbësor për promovimin e interesave të sindikatave dhe e drejta për të nënshkruar këto kontrata është e mirënjohur në nivel ndërkombëtar, kështu që nuk mund të lejohet në një shoqëri demokratike përjashtimi i një kategorie punëmarrësish nga e drejta për të lidhur një kontratë kolektive. Këto parime nuk duhet të nënkuptohen në mënyrë statike dhe shteruese, por si koncepte të cilat evoluojnë nga zhvillimet, që karakterizojnë marrëdhënien juridike të punës.¹⁶

¹³ Çështja *Sigurdur A. Sigurjonsson kundër Islandës*, Strasburg 30 Qershor 1993.

¹⁴ Gjykata iu referua Konventës së ILO-s, nr.87 "Për lirinë e organizimit", ku neni 2 sanksionon që punëmarrësit kanë të drejtën të krijojnë organizata dhe të jenë pjesëmarrës në to. Kështu që, dhe punonjësit e administratës publike kanë të drejtën të krijojnë dhe të marrin pjesë në organizata të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe interesat e punonjësve që përfaqësojnë.

¹⁵ Bianku, L. (2001). *Të drejtat e Njeriut në Europë*. Tiranë: Qendra evropiane, f. 32.

¹⁶ Galantino, L. (2009). *Diritto Sindacale*. Torino: ..., f. 62.

Liria e shprehjes

Një ndër arsyet themelore të krijimit të sindikatave është sigurimi i lirisë së shprehjes për punëmarrësit karshi punëdhënësve. Gjykata e Strasburgut ka gjykuar një sërë çështjesh, të cilat pretendojnë për cenim të nenit 10 të Konventës, duke kufizuar lirinë e shprehjes. Një rast i tillë ka qenë çështja *Heinisch kundër Gjermanisë*¹⁷, në të cilën kërkuesi pretendonte se ishte shkarkuar nga puna pas publikimit të një animimi ku tregohet shefi i burimeve njerëzore, duke përfituar nga "favore" seksuale nga punëmarrësit të ndryshëm. Këtë rast Gjykata e cilësoi si cenim të nenit 10, duke vërejtur se është e drejtë e çdo punëmarrësi të shprehet lirisht.

Një cenim tjetër i lirisë së shprehjes është vërejtur nga Gjykata e Strasburgut në çështjen *Vellutini dhe Michel kundër Francës*¹⁸, ku Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i sindikatës së policëve bashkiak u dënuan për fyerje kundrejt Kryetarit të Bashkisë së qytetit në të cilin punonin. *GJEDNJ* u shpreh se fyerjet e thëna në kontekstin e sindikatave janë të "përfshira" në lirinë e shprehjes, e për këtë arsye në këtë rast kemi cenim të nenit 10 të Konventës.

E drejta për të marrë pjesë

Mund të ngjajë "non sens" diskutimi mbi demokracinë e organizimit të brendshëm në sindikata. Megjithatë, sindikatat (jo vetëm në vendet në tranzicion) vuajnë shpesh nga ajo që synimet e dëshiruara në statutet e tyre nuk mund të arrihen gjithmonë¹⁹. E drejta e garantuar nga neni 11 i Konventës Evropiane përbëhet nga dy anë të medaljes. Në njërin anë qëndron e drejta e çdo punëmarrësi për të marrë pjesë në sindikata, pra e drejta e pjesëmarrjes, ndërsa në anën tjetër qëndron aspekti negativ i saj: çdo personi punëmarrësi i garantohet e drejta të mos marrë pjesë në një organizim sindikal në rast se nuk e dëshiron një gjë të tillë²⁰. Në çështjen *Sigurdur A. Sigurjonsson kundër Islandës*²¹, kërkuesi i punësuar si shofer taksie ishte detyruar të anëtarësohej në sindikatën e taksistëve Farmi, në rast të kundërt do t'i hiqej licenca e ushtrimit të profesionit. Gjykata e Strasburgut u shpreh se, në këtë rast gjendemi përballë cenimit të së drejtës së anëtarësimin, por në aspektin negativ të saj. Sipas Gjykatës asnjë punëmarrës nuk mund të detyrohet të marrë pjesë në një sindikatë jashtë vullnetit të tij.

¹⁷ Çështja *Heinisch kundër Gjermanisë*, Strasburg 21 korrik 2001.

¹⁸ Çështja *Vellutini dhe Michel kundër Francës*, Strasburg 6 tetor 2011.

¹⁹ Hantke, F. (2013). *Manual diskutimi për sindikatat në vendet në tranzicion*. Tiranë: Fridrich Ebert Stiftung, f. 70.

²⁰ Wino J.M. van Veen. (2000, Shtator). "Negative Freedom of Association: Article 11 of the European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms" *The International Journal of Not-for-Profit Laë*. (http://ëëë.icnl.org/research/journal/vol3iss1/art_6.htm)

²¹ Çështja *Sigurdur A. Sigurjonsson kundër Islandës*, Strasburg 30 qershor 1993.

E drejta e grevës

Në çështjen e *Enerji Yapi-Yol Sen kundër Turqisë*²², në lidhje me masat disiplinore të adaptuara kundër disa funksionarëve për pjesëmarrjen në një grevë, Gjykata nënvizoi se, parimi i lirisë së organizimit, mund të jetë i pajtueshëm me ndalimin e së drejtës së grevës nga ana e nëpunësve civil, me kusht që ky kufizim të jetë i ligjshëm dhe të specifikojë kategorinë e funksionarëve, të cilët janë të ndaluar të ushtrojnë këtë të drejtë. Në këtë çështje, kërkesit (sindikata e nëpunësve civilë për shërbimet e infrastrukturës dhe mirëmbajtjes së autostradave) kundër të cilëve ishte marrë një masë disiplinore në bazë të një rregulloreje të ministrisë, për pjesëmarrjen në mbledhjet dhe në manifestimet e sindikatës. Sipas kësaj rregulloreje manifestimet e sindikatës komprometonin vazhdueshmërinë e shërbimit publik. *GJEDNJ-ja* u shpreh se Konventa u njuh të drejtën sindikatave të luftojnë për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të tyre. E drejta e grevës është një mjet, që lejon sindikatën t'i dëgjohet zëri dhe është një aspekt shumë i rëndësishëm për anëtarët e saj në mbrojtjen e të drejtave të tyre.²³

Megjithatë, *GJEDNJ* nënvizoi se kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të kufizohet. Konventa i njuh kufizime kësaj të drejte, më kusht që norma kufizuese të jetë e ligjshme dhe që interferenca e autoritetit shtetëror të jetë e nevojshme dhe proporcionale me qëllimin e ndjekur. Në rastin në fjalë, Gjykata vlerësoi që kjo rregullore e formuluar në mënyrë të përgjithshme ndalonte të gjithë kategoritë e nëpunësve civil për të ushtuar të drejtën e grevës, nuk ishte në përputhje me qëllimin nenit 11§2 të *KEDNJ-së*. Pas një analize të gjerë nga ana e saj, *GJEDNJ* vlerësoi se adaptimi dhe aplikimi i rregullores nuk ishte i nevojshëm dhe në këtë rast interferenca e autoritetit shtetëror nuk ishte proporcionale me gëzimin e të drejtave sindikale në përputhje me nenin 11 të Konventës. Për rrjedhojë Gjykata evidentoi shkelje të nenit 11 *KEDNJ*.

Konkluzione

Nga sa trajtuam gjatë këtij punimi më sipër mund të themi se organizatat sindikale janë pjesë përbërëse dhe organizma të rëndësishëm të sistemeve shoqërore demokratike. Këto organizata të pavarura kanë qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore të anëtarëve të tyre. Thelbi i garancive juridike të së drejtës sindikale, përveçse gjendet në aktet kushtetuese, gjithashtu është i sanksionuar dhe në aktet ndërkombëtare, siç janë ato të ILO-s, *KEDNJ-së*, Karta Sociale Europiane etj. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Strasburgut ka dhënë një kontribut të madh në interpretimin e normave mbi

të drejtën sindikale. Përmes vendimeve të saj, *GJEDNJ-ja* interpreton Konventën nën dritën e kushteve aktuale, duke ndjekur zhvillimet e së drejtës ndërkombëtare me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Dinamizmi i zhvillimeve të së drejtës është pasqyruar dhe në vendimet e kësaj Gjykate, e cila ka ndryshuar e zgjeruar interpretimin e saj gjithmonë e më shumë në favor të respektimit të të drejtave të punëmarrësve në çështjet, që lidhen me nenin 11 të Konventës. Standardet e vendosura në jurisprudencën e *GJEDNJ-së* duhet të adaptohen në sistemet e brendshme ligjore të Shteteve Palë në Konventë, me qëllim përmirësimin e gjendjes aktuale të të drejtave të njeriut në Evropë.

Bibliografia

Burime parësore:

Ligje:

Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 “ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

(1950) Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Ligji nr. 7961 datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 7516 datë 07.10.1991 “Për sindikatat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Akte ndërkombëtare:

(1961) Karta Sociale Europiane

(1948) Konventa nr. 87 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

(1949) Konventa nr. 98 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Vendime gjyqësore:

Çështja *Unioni Kombëtar i Policëve Belge kundër Belgjikës*, Strasburg 27 Tetor 1975.

Çështja *Schmidt et Dahlstrom kundër Suedisë*, Strasburg, 6 Shkurt 1976

Çështja *Sigurður A. Sigurjonsson kundër Islandës*, Strasburg 30 Qershor 1993.

Çështja *Tum Haber Sen et Çinar kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 28602/95, Strasburg 2006.

Çështja *Sorensen et Tamussen Kundër Danimarkës*, Kërkesa nr. 52562/99, Strasburg 2006.

Çështja *Sindikata e ndihmësve të fluturimit kundër Greqisë*, Kërkesa nr. 19634/92, Strasburg 1995.

Çështja *Demir e Baykara kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 34503/97, Strasburg 2008.

Çështja *Enerji Yapi-Yol Sen kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 68959/01. Strasburg 21 prill 2009.

Çështja *Vellutini dhe Michel kundër Francës*, Strasburg 6 Tetor 2011.

Burime dytësore:

Libra:

Bianku, L. (2001). *Të drejtat e Njeriut në Evropë (Jurisprudencë dhe Komente)*. Tiranë: botim i Qendrës Europiane.

Bianku, L. (2007). *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*. Tiranë: botim i Qendrës Europiane.

Çela, K. (2010). *E drejta e Punës*. Tiranë: botimet Iliar.

Galantino, L. (2009). *Diritto Sindacale*. Torino: CEDAM.

Hantke, F. (2013). *Manual diskutimi për sindikatat në vendet në tranzicion*. Tiranë: Fridrich Ebert Stiftung.

Webografi:

http://www.echr.coe.int/echr/homepage_EN

<http://eur-lex.europa.eu/>

²² Çështja *Enerji Yapi-Yol Sen kundër Turqisë*, Strasburg 21 prill 2009.

²³ Çështja *Schmidt et Dahlstrom kundër Suedisë*, shih më lart.

Wino J.M. van Veen (2000, Shtator). "Negative Freedom of Association: Article 11 of the European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms" *The International Journal of Not-for-Profit Law*. (http://www.icnl.org/research/journal/vol3iss1/art_6.htm) Konsultuar më 31.01.2015.

Aspekte të legjislacionit për shoqëritë anonime (aksionare) të kuotuar në bursë në vende të ndryshme Europiane

Prof. Asoc. Dr. Edi Spaho

Abstrakt

Shoqëritë aksionare të kuotuar në bursë në vende të ndryshme të Europës kanë të përbashkëtat e tyre, të ndikuara këto nga përshtatja e legjislacionit vendas me direktivat përkatëse të Bashkimit Europian, por kanë dhe dallimet e tyre që i karakterizon ato, si pasojë e faktorëve të ndryshëm historikë, ekonomikë dhe sociale. Legjislacioni italian nuk bën dallim midis shoqërisë aksionare me aksione të kuotuar në bursë dhe atyre të pakuotuar në bursë. Ai bën dallimin vetëm mes shoqërisë së kapitalit dhe shoqërisë së personit. Shoqëria anonime është shoqëria më e përdorur në Francë. Formalitetet për shoqëritë me ofertë publike janë më komplekse se sa për shoqërinë anonime pa ofertë publike. Ajo i nënshtrohet kontrollit të COB-it (Commission des Operations de Bourse). Legjislacioni gjerman, ashtu si ai italian, nuk bën ndryshim midis shoqërive aksionere me ofertë publike dhe pa ofertë publike. Megjithatë Aktiengesellschaft (AG) është më e përdorur se sa Gesellschaft mit beschränkter Haftung (GmbH). Formalitetet për themelimin e AG janë gjithashtu komplekse. Aksionet shoqërive aksionare në Greqi, AE, mund të shlyhen pjesërisht. Dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë, grekë ose të huaj mund të themelojnë një AE. Shoqëria themelohet me anë të një akti noterial që përmban statutin dhe që aprovohet nga Prefekti i Zonës ku shoqëria është e regjistruar. Që të themelohet shoqëria në Mbretërinë e Bashkuar duhet të ketë një kapital themeltar minimumi 50 mijë sterlina dhe të paktën 2 aksionerë. Nëse vlera e asetëve bie nën 50% të kapitalit, shoqëria duhet të mbledhë asamblenë e aksionerëve që të vendosë në lidhje me situatën.

Fjalë Kyç: *Shoqëri aksionare, aksion, bursa e letrave me vlerë, bordi i drejtorëve, administrim.*

1.1 Italia, shoqëritë aksionare: le societa per azioni

Legjislacioni italian nuk bën dallim midis shoqërisë aksionere me aksione të kuotuar në bursë dhe atyre të pakuotuar në bursë. Ai bën dallimin vetëm mes shoqërisë së kapitalit dhe shoqërisë të personit. Ndër shoqëritë aksionere dallohet shoqëria e aksioneve (*le societa per azioni*) dhe shoqëria komanditë aksionere (la societa in accomandita per azioni).

1.1.1 Krijimi i shoqërisë

Për krijimin e saj një shoqëri duhet të përgatisë aktin konstituitiv, të marrë miratimin e gjykatës dhe të regjistrohet në regjistrin e shoqërive. Nënshkrimi i kapitalit mund të bëhet ose nga nismëtarët (*costituzione simultanea*) ose nga publiku (*costituzione per publica sottoscrizione*). Pastaj kërkohet një procedurë tjetër:

- a. nënshkrimi i plotë i kapitalit të shoqërisë;
- b. pagimi i të paktën 3/10 të çdo kontributi me të holla;

Akti Konstituitiv duhet të bëhet në formën e aktit publik të bërë para noterit publik dhe duhet të përmbajë të gjitha të dhënat rreth shoqërisë. Gjykata kompetente kontrollon nëse të gjithë kërkesat e ligjit janë plotësuar dhe kur i konstaton në rregull lëshon një dekret miratimi (*decreto di omologazione*) ku urdhërohet regjistrimi në regjistrin e shoqërive.¹ Ky regjistrim krijon personalitetin juridik për shoqërinë. Çdo kontratë e lidhur nga një person në emër të shoqërisë para themelimit do të detyrojë personin. Shoqëria mund të bëjë të vetën këtë kontratë vetëm pas themelimit. Çdo emërtim aksionesh para themelimit është nul.

1.1.2 Aksionet

Përgjithësisht aksionet kanë vlerë të njëjtë dhe aksionerët të drejta të barabarta. *Akti Konstituitiv* mund të parashikojë edhe aksione, mbajtësit e të cilave nuk kanë të drejtë vote në asamblenë e zakonshme të aksionerëve duke parashikuar që të kenë prioritet në ndarjen e dividendëve dhe të mos kalojnë 1/2 e kapitalit të shoqërisë. Shoqëria mund të parashikojë edhe një tip të veçantë aksionesh për punonjësit e saj.

1.1.3 Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit bëhet në 2 mënyra:

1. duke futur në kapital rezervat dhe fondet e tjera, ose duke rritur vlerën

¹ Gastone Cottino, Diritto Commerciale, V. 1, t.2, Padova, Cedam 1994. Kapitulli i Krijimit të Shoqërive.

nominale të aksioneve ekzistuese ose duke rivlerësuar asetet në raste të caktuara;

2. nëpërmjet nënshkrimit në të holla të aksionerëve aktualë në përpjesëtim me numrin e aksioneve që ata zotërojnë. Vendimi për të rritur kapitalin është kompetencë e asamblesë së jashtëzakonshme. Megjithatë akti konstituiv mund t'u japë drejtorëve pushtetin për të rritur kapitalin në disa rrethana. Ky pushtet është i kufizuar deri në 5 vjet nga data e regjistrimit të shoqërisë.

1.1.4 Blerja nga shoqëria e aksioneve të veta

Një shoqëri mund të blejë aksionet e veta në masën e fitimit që do të shpërndahe dhe rezervat e përshtatshme tësiguruara (*parashikuara*) duke plotësuar këto kushte:

- a. aksionet janë shlyer plotësisht;
- b. aksionet nuk kalojnë 1/10 e kapitalit dhe;
- c. blerja është e miratuar dhe e rregulluar me rezolutë nga asambleja e aksionerëve.

Një shoqëri nuk duhet të japë hua ose garanci duke u bazuar tek blerja apo nënshkrimi i aksioneve tëveta ose tëpranojë aksionet e veta si siguri.²

1.1.5 Bordi i Drejtorëve

Menaxhimi i shoqërisë u është deleguar drejtorëve. Numri i drejtorëve përgjithësisht është i caktuar në statut. Megjithatë aty mund edhe të parashikohet një minimum ose maksimum. Detyra e drejtorit mbaron kur skadon afati, kur jep dorëheqjen, kur bëhet i paaftë dhe kur shkarkohet nga asambleja e aksionerëve. Drejtorët mund të mbajnë përgjegjësi civile ndaj shoqërisë, kreditorëve dhe të tretëve. Gjithashtu ata mund të mbajnë edhe përgjegjësi penale.

1.1.6 Pushimi i shoqërisë

Kodi Civil cakton rastet kur shoqëria prishet:

1. skadimi i afatit;
2. objekti i shoqërisë është përmbushur ose nuk mund tëpërmbushet;
3. pamundësia e shoqërisë për tëoperuar nëpërmjet asamblesë së aksionerëve;
4. zvogëlimi i kapitalit nën minimumin ligjor;
5. me njërezolutë tëasamblesë së aksionerëve;

² Francesco Galgano, Diritto Privato, Padova, Cedam 1992, Kapitulli i Shoqërive Aksionere.

6. me ngjarje tëspecifikuara nga statute;
7. masat që mund të merren nga autoritetet qeveritare;
8. me vendim gjyqësor si rrjedhojë e insolvencës.

1.1.7 CONSOB

Një formë e kontrollit të jashtëm është ajo që kryhet nga Komisioni Kombëtar për Shoqëritë dhe Bursën (*CONSOB*). Funkcionet e *CONSOB* kufizohen vetëm ndaj shoqërive me aksione të kuotuar në bursë. Ai ka pushtetin që të urdhëroje pranimin në kuotime të titujve që kontraktohen zakonisht dhe në shkallë të gjere, të emërtuar nga shoqëritë që përmbushin kushtet e parashikuara.

1.1.8 Kushtet e listimit

1. Kërkuesi duhet të jetë një shoqëri ose agjenci ligjërishit e themeluar në Itali ose jashtë saj.
2. Llogaritë financiare për 3 vitet e fundit fiskale: bilancin, të miratuar nga një ekspert kontabël i autorizuar.
3. Aksionet duhet të jenë lehtësisht të transferueshme.

1.2 Franca, la societe anonyme avec appel public, L'epargne

1.2.1 Të përgjithshme

Shoqëria anonime është shoqëria më e përdorur në Francë. Formalitetet për këtë shoqëri janë më komplekse se sa për shoqërinë anonime pa ofertë publike. Ajo i nënshtrohet kontrollit të COB-it (*Commission des Operations de Bourse*). Gjithashtu ajo ka detyrimin për publikimin në një gazetë ligjore ("Bulletin des Annonces Legales Obligatoires") të disa akteve si njoftimi i aksionierëve, zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit, aktet e bashkimit, ndarjes, likuidimit etj. Për kontratat e lidhura para themelimit të shoqërisë mban përgjegjësi personi. Shoqëria e bën të vetën këtë kontratë me anë të një aneksi në statut vetëm pas themelimit.³

1.2.2 Aksionet

Tipi i aksioneve është i përcaktuar nga statuti. Ai mund të parashikojë aksione të zakonshme, preferenciale, pa të drejtë vote ose me votë të dyfishtë. Aksionet mund të jenë tek prurësi ose në një formë të regjistruar.

³ Robert Casimir, Droit des affaires, Paris 1990, fq.82.

1.2.3 Blerja e aksioneve të veta

Shoqëria nuk mund të blejë direkt ose indirekt aksionet e veta, përveç:

- a. në rastin e zvogëlimit të kapitalit
- b. me qëllimin për t'ia atribuar këto aksione të punësuarve ose vetë shoqërisë.
- c. me qëllim për të rregulluar kuotimet në bursë.

Ky proces kërkon:

- që aksionet të jenë shlyer plotësisht.
- duhet të blihen me para në dorë (*cash*)
- shoqëria nuk duhet të mbajë direkt ose indirekt aksionet e veta që kalojnë 10% të aksioneve;
- shoqëria duhet të ketë rezerva kapitali tjetër përveç rezervave statuore që arrijnë të paktën vlerën e aksioneve të kërkuara.

1.2.4 Zvogëlimi i kapitalit

Shoqëria mund të reduktojë kapitalin e vet duke kaluar një rezultat në asamblenë e jashtëzakonshme, e cila mund t'i delegojë pushtetin Bordit të Drejtorëve për të realizuar zvogëlimin. Zvogëlimi i kapitalit në disa rrethe mund të shkelë parimin e barazisë mes aksionerëve dhe pa miratimin e aksionerëve.

1.2.5 Drejtimi

Ka 2 mënyra drejtimi:

1. Bordi i Drejtorëve (*conseil d'administration*) i kryesuar nga një kryetar bordi.
2. Direktorati (*directoire*) i kontrolluar nga këshilli mbikqyrës (*conseil de surveillance*).

Struktura me Direktorat është më pak fleksibël dhe më pak e përdorur se struktura me Bordin e Drejtorëve. Drejtorët kanë detyrën e përgjithshme të ushtrorinë pushtetin e tyre në mirëbesim dhe kujdes të arsyeshëm në shërbim të interesave të shoqërisë. Ata duhet të jenë të pranishëm në mbledhje, përveçse kur kanë një justifikim. Ata duhet të mbajnë sekret çdo informacion që i përket shoqërisë. Bordi i Drejtorëve ka pushtet të gjerë që të veprojnë në çdo rrethanë, brenda kufijve të objektit të shoqërisë dhe nuk mund të ndërhyjnë në pushtetet që i përkasin asamblësë së aksionerëve. Drejtorët kanë përgjegjësi kundrejt shoqërisë dhe të tretëve.⁴

⁴ Georges Ripert, René Roblot, Traité de Droit Commercial, T. 1, Paris 1992. Kapitulli i Administrimit.

1.2.6 Likuidimi

Ligji francez parashikon katër masa për të parandaluar falimentimin: asistencë ekspertësh, procedurat e observimit, pajtimi i kreditorit me debitorin, rehabilitimi. Nëse edhe këto masa nuk funksionojnë, atëherë shoqëria vihet në likuidim. Observimi është një fazë ku shoqëria drejtohet nga një administrator i caktuar nga gjykata. Gjatë kësaj faze veprimtaria e shoqërisë vazhdon. Gjithsesi gjykata ka pushtetin të kërkojë që kontratat midis shoqërisë dhe të tretëve të vazhdojnë.

Në fund të periudhës së observimit, gjykata do të vendosë nëse shoqëria do të rehabilitohet, shitet ose likuidohet. Gjukata mundet që, në bazë të raportit të administratorit, të vendosë që aktiviteti të vazhdojë mbi bazën e një plani rehabilitimi të propozuar nga administratori.

1.2.7 Konsultimi me Komitetin e Punës

Kodi i Punës francez parashikon që, nëse shoqëria ka një komitet pune, drejtuesit e shoqërisë mund të konsultohen me këtë komitet. Ky komitet krijohet nëse shoqëria ka të paktën 50 të punësuar.

1.2.8 Oferta publike

Çdo shoqëri që dëshiron të bëjë një ofertë publike duhet të publikojë çdo informacion që lidhet me organizimin, gjëndjen financiare dhe aktivitetin e shoqërisë. Të gjitha këto pas shqyrtimit nga COB duhet të publikohen në një gazetë ligjore të autorizuar.

1.3 Gjermania, aktiengesellschaft

1.3.1 Të përgjithshme

Legjislacioni gjerman nuk bën ndryshim midis shoqërive aksionere me ofertë publike dhe pa ofertë publike. Megjithatë *Aktiengesellschaft (AG)* është më e përdorur se sa *Gesellschaft mit beschränkter Haftung (GmbH)*. Formalitetet për themelimin e AG janë më komplekse. AG është e përdorur për organizimet e mëdha të biznesit, të firmave industriale, bankave dhe shoqërive të sigurimit. AG është shoqëria më e leverdisshme për ata që synojnë të financohen me anë të blerjes së aksioneve nga publiku.

1.3.2 Themelimi

5 nënshkrues është numri minimum për themelimin e *AG-ve*. Përveç të tjerash, statuti i *AG* duhet të përmbajë:

Aspekte të legjislacionit për shoqëritë anonime (aksionare) të kuotuar në bursë në vende të ndryshme ...

- vlerën nominale të aksioneve dhe numri i aksioneve që kanë të njëjtën vlerë nominale të aksioneve dhe numrin e aksioneve për çdo kategori;
- nëse aksionet janë tek prurësi apo në formë të regjistruar;
- numrin e anëtarëve të Bordit të Drejtimit, ose rregullat mbi të cilat caktohet ky numër;
- formën si do të publikohen aktet e *AG-së*.

1.3.3 Aksionet

Sipas ligjit gjerman ka një ndryshim midis aksioneve tek prurësi (*inhaberaktien*) dhe aksioneve të regjistruara (*namensaktien*). Një nga ndryshimet më të mëdha është lehtësia e transferimit të aksioneve tek prurësi. Aksioni tek prurësi nuk mund të vihet në qarkullim para se të paguhet e plotë vlera nominale e tij. Aksione me të drejta të ndryshme janë të kategorizuara në klasa të ndryshme aksionesh, psh.:

- a. prioritet me shpërndarjen e dividendëve;
- b. preferenca në likuidim;
- c. diferenca përta i përket detyrimeve të aksionerëve;
- d. diferenca në të drejtën e votës.

1.3.4 Drejtimi

Struktura drejtuese e AG është:

- Asambleja e aksionerëve;
- Bordi i Drejtimit;
- Bordi i Mbikqyrjes.

Bordi i Drejtimit duhet të përbëhet nga një ose disa persona. Afati i anëtarësisë në Bord nuk duhet të kalojë 5 vjet, por rinovimi është i mundshëm 1 vit përpara mbarimit të afatit. Emërimin e bën Bordi Mbikqyrës, i cili mund të vendosë edhe t'i japë një ose disa individëve të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë. Bordi i Drejtimit ka të drejtën dhe detyrën të drejtojë shoqërinë. Bordi i Mbikqyrjes i ka detyrat të ndara në mënyrë strikte nga Bordi i Drejtimit. Anëtarët e tij janë të zgjedhur nga aksionerët. Ai ka të drejtën të mbikqyrë aktivitetin e biznesit.⁵

1.3.5 Brokerat

Një person që ka për aktivitet negocimin e kontratave për shitblerjen e aksioneve ka nevojë për një licensë. Licensa refuzohet nëse ka të dhëna të mendohet se ai

⁵ Company Law in Europe, Butterworths 1993, Shoqëritë Tregtare në Gjermani.

nuk është i aftë të kryejë një aktivitet të tillë ose ka gjëndje të ç'rregullt financiare. Me qëllim mbrojtjen e investitorëve brokerat duhet që informacionin e paraqitur investitorit ta kenë të vertetë dhe të kompletuar, duhet t'i japin atij shpjegime për detajet dhe rrethanat e investimit, që mund të jetë i rëndësishëm për vendimin e investitorit.

1.3.6 Listimi zyrtar

Kushtet për listim janë:

- a. aksionet pranohen për listim vetëm me anë të aplikimit të plotësuar nga kërkuesi;
- b. kërkuesi duhet të ketë ekzistuar si shoqëri për të paktën 3 vjet;
- c. aksionet duhet të jenë lehtësisht të transferueshme dhe gjerësisht të shpërndara;
- d. duhet të plotësohet një prospekt me të gjitha të dhënat që shërbejnë për vlerësimin e aksioneve që do të listohen.

Prospekti, në versionin e aprovuar nga Bordi i Miratimit të Bursës, duhet të publikohet në *Gazetën Zyrtare Federale*.

1.4 Greqia, AE

1.4.1 Të përgjithshme

Aksionet shoqërive aksionare, *AE*, mund të shlyhen pjesërisht. Dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë, grekë ose të huaj mund të themelojnë një *AE*. Shoqëria themelohet me anë të një akti noterial që përmban statutin dhe që aprovohet nga Prefekti i Zonës ku shoqëria është e regjistruar. Pastaj shoqëria duhet të regjistrohet në regjistrin e shoqërive në Departamentin e Ministrisë së Tregtisë në Prefekturë.

Ky regjistrim publikohet në gazetën qeveritare. *AE* fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin e shoqërive. Koha midis hartimit të aktit noterial dhe aplikimit për regjistrim te Prefekti dhe regjistrimi i shoqërisë varet nga numri i aplikimeve në proces dhe varion nga 8 - 30 ditë. Për kontratat e lidhura para themelimit mban përgjegjësi personi, megjithatë shoqëria mund ta bëjë të vetën kontratën, brenda 3 muajve nga themelimi i saj.

1.4.2 Aksionet

Statuti përcakton llojet e aksioneve. Përgjithësisht aksionet mund të jenë nominativë ose tek prurësi. Përveç aksioneve, ligji grek njih edhe "*të drejtat e themeluesve*" që

Aspekte të legjislacionit për shoqëritë anonime (aksionare) të kuotuar në bursë në vende të ndryshme ...

u japin beneficiarëve të drejtën për të ndarë fitimet, por nuk janë aksione. Është Bordi i Drejtorëve ai që merr vendim për emërtimin e aksioneve.

Megjithatë statuti mund të parashikojë ndryshe, duke përcaktuar afatet dhe kushtet për emërtimin e aksioneve. Në çdo rast, aksionet e reja duhet t'u afrohen aksionerëve ekzistues proporcionalisht me aksionet që zotërojnë. Çmimi i një aksioni mund të paguhet *cash* ose në natyrë. Nëse paguhet në natyrë, vlera duhet të vlerësohet nga një komitet special ekspertësh, të emëruar nga Ministria e Tregtisë. Kontributet në shërbime nuk lejohen.⁶

1.4.3 Zvogëlimi i kapitalit

Duke zvogëluar kapitalin shoqëria mund të arrijë objektiva financiare të ndryshme. Përveç rastit kur aksionet, që janë shlyer plotësisht, humbasin dhe ligji detyron shoqërinë t'i riftojë ato, në të gjitha rastet e tjera ligji ia lë diskrecionit të shoqërisë për zvogëlimin e kapitalit. Nuk mund të zvogëlohet kapitali nën minimumin ligjor të kërkuar. Zvogëlimi i kapitalit kërkon një mendim të statutit dhe duhet t'i paraqitet asamblesë së jashtëzakonshme.

1.4.4 Drejtimi

Bordi i Drejtorëve drejton dhe përfaqëson *AE* dhe përbëhet nga të paktën 3 anëtarë. Nuk është e nevojshme që drejtorët të jenë aksionerë, përveç kur statuti parashikon ndryshe. Mandati i tyre është 6 vjeçar me të drejtë rinovimi. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve zgjidhen nga asambleja e përgjithshme e aksionerëve. Kur personat e nevojshëm për administrim mungojnë, gjykata mund të emërojë një Bord Drejtorësh të përkohshëm me kërkesën e çdo personi të interesuar.

1.4.5 Listimi

Shoqëritë me aksione të kuotuar në Bursë janë të detyruara për publikimin e prospektit me ofertat potenciale me gjithë informacionin e nevojshëm financiar. Bordi i Bursës mund të imponojë detyrime dhe sanksione për kërkuesin dhe t'i kërkojë atij gjithë informacionin e nevojshëm para miratimit për listim. Aplikantët për listim në Bursën e Athinës janë:

Bordi i Drejtorëve i shoqërisë kërkuese; Një grup aksionerësh i shoqërisë që përfaqëson të paktën ¼ e kapitalit me aksione; Bordi i Drejtorëve i Bursës për aksionet mbi të cilat ka një numër të konsiderueshëm transaksionesh jashtë Bursës.

⁶ Id. Shoqëritë Tregtare në Greqi

1.5 Mbretëria e Bashkuar, Public Limited Company

1.5.1 Të përgjithshme

Që të themelohet shoqëria duhet të ketë një kapital themeltar minimum 50 mijë sterlina dhe të paktën 2 aksionerë. Nëse vlera e aseteve bie nën 50% të kapitalit, shoqëria duhet të mbledhë asamblenë e aksionerëve që të vendosë në lidhje me situatën. Formalitetet për krijimin e kësaj shoqërie janë më të rrepta se sa për ato private *limited company* (shoqëritë pa ofertë publike). *Public Limited Company* mund të regjistrohet fillimisht si private *company* dhe pastaj të shndërrohet me një rezolutë të aksionerëve. Kontratat e lidhura para themelimit bëjnë me përgjegjësi personat themelues. Shoqëria mund ta bëjë të vetën duke e riezekutuar.⁷

1.5.2 Aksionet

Llojet e aksioneve përcaktohen nga artikujt e statutit. Nuk ka ndonjë shtrëngim në përcaktimin e llojeve të aksioneve. Drejtorët e shoqërisë mund të vendosin emërtimin e aksioneve sipas statutit ose sipas vendimit të asamblesë së aksionerëve; ose mund të vendosin **blerjen nga shoqëria e aksioneve të veta**.

Kërkesat që shoqëria të blejë aksionet e veta duhen parashikuar në statut dhe janë:

- Aksionet që do të blihen duhet të jenë shlyer tërësisht;
- Aksionet duhet të blihen *cash*;
- Edhe pas blerjes, ato duhet të mbesin aksione, dhe të mos shndërrohen në forma të tjera të letrave me vlerë.

Shoqëria mund t'i blejë aksionet e veta edhe në një bursë të njohur nëpërmjet kontratave specifike mes shoqërisë dhe aksionerit ose aksionerëve.

1.5.3 Zvogëlimi i kapitalit

Nëse e parashikon statuti, një shoqëri mund të vendosë të zvogëlojë kapitalin, duke kaluar një rezolutë të veçantë dhe duke marrë miratimin e gjykatës. Nuk ka kufi mbi mënyrën se si mund të bëhet zvogëlimi i kapitalit.

1.5.4 Drejtimi

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga drejtorët, duke vepruar kolegjisht ose individualisht nëse u është deleguar pushteti. Në *UK* nuk njihet koncepti i këshillit

⁷ Remarks on Joint Stock Companies An Old Merchant, fq.73.

Aspekte të legjislacionit për shoqëritë anonime (aksionare) të kuotuar në bursë në vende të ndryshme ...

mbikqyrës. Megjithatë në shoqëritë e mëdha kontrolli ndaj ekzekutivit i besohet disa drejtorëve joekzekutivë.

Drejtesit e parë të shoqërisë gjatë themelimit emërtohen nga nënshkruesit e memorandumit. Emërimi i drejtorëve të tjerë përcaktohet nga statuti.⁸

1.5.5 Listimi

Listimi bëhet në përputhje me rregullat e vendosura nga Këshilli i Bursës. Këto janë të trupëzuara në "*Admission of Securites to Listing*" që njihet më mirë si "*Yellow Book*", i publikuar nga këshilli. Përgjithësisht listimi refuzohet nëse vlera e tregut e letrave me vlerë nuk është 700.000 sterlina në rastin e aksioneve. Listimi ka rregulla të forta që synojnë mbrojtjen e investitorëve.⁹

Këto ishin disa nga aspektet kryesore të institutit në Itali, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Këto synojnë kryesisht nxjerrjen në pah të ndryshimeve mes këtyre legjislacioneve, edhe pse duhet pranuar që ndryshimet nuk janë thelbësore për përmbajtjen e institutit. Në këtë këndvështrim gjithashtu duhet pranuar që edhe legjislacioni shqiptar në këtë fushë i afrohet legjislacioneve përëndimore. Kjo duket qartë përse i përket çështjeve kryesore që janë thellësisht të ngjashme. Afrimi më i madh i legjislacionit shqiptar është me legjislacionin francez. Ky afrim dallohet që nga emërtimet e përdorura e deri në përmbajtjen e institutit.

Bibliografia

Gastone Cottino, Diritto Commerciale, V. 1, t.2, Padova, Cedam 1994.

Francesco Galgano, Diritto Privato, Padova, Cedam 1992.

Robert Casimir, Droit des affaires, Paris 1990.

Company Law in Europe, Butterworth's 1993, Shoqëritë Tregtare në Gjermani.

Clarendon G. Hyde, Henry Hurreli, "The Law of Directors and Officers of Joint Stock Companies, Their Powers, Duties and Liabilities".

⁸ Clarendon G. Hyde, Henry Hurreli, "The Law of Directors and Officers of Joint Stock Companies, Their Powers, Duties and Liabilities", fq.147.

⁹ Joint Stock Company: An entry from Tomson Gale's, fq.36.

Sekreti bankar mbi informacionet e klientit dhe marrëveshjet e normativat ndërkombëtare që po sjellin fundin e këtij elementi sigurie

PhD. Hemion Braho

Abstrakt

Ky artikull shqyrton shkurtimisht situatën në lidhje me sekretin bankar, duke filluar nga situata normative në vendin tonë dhe duke i analizuar konceptet bazë të normave brenda botës.

Parlamentet dhe qeveritë në të gjithë botën po thirren për të ratifikuar marrëveshjen me legjislacionin FATCA, me të cilën Uashingtoni e pretendon të dhënat e gjithë personave që i nënshtrohen autoriteteve tatimore të SHBA-së. Përballë arsenalit të kësaj superfuqie, e ardhmja e sekretit bankar është shënuar. Përgatitja e fuqive e kohëve të fundit për të rrëzuar sekretin bankar, është mbresëlënëse. G20 dëshiron sa më shpejt shkëmbimin automatik të informacionit tatimor në të gjithë botën. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) ka për qëllim të zhvillojë standardet ndërkombëtare dhe në muajt e ardhshëm BE-ja dëshiron që të hapë negociatat për të imponuar transparencën fiskale për të gjithë anëtarëve të tij dhe të Zvicrës që nga 2015.

Sekreti bankar zbatohet nga Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë dhe çdo subjekt tjetër që kryen shërbime për bankat e nivelit të dytë si dhe përbën një nga pikat kryesore të aktivitetit bankar në kuadrin e detyrimeve ndaj klientit.

Sipas udhëzimit “Për sekretin bankar” nr.31 datë 08.05.2002 të Bankës së Shqipërisë, banka është e detyruar të ruajë sekretin e informacionit të klientit (klient është personi, individ fizik ose juridik, i cili në emër dhe për llogari të tij apo në emër dhe për llogari të personit të tretë përfiton veprimtari bankare nga banka).

Në kuadër të këtyre detyrimeve mund të përmendim faktin që Banka duhet të sigurojë informacionin e klientit duke e trajtuar atë vetëm në ambiente në të cilat lejohet përdorimi vetëm nga personat e autorizuar, duke pasur parasysh faktin që asnjëherë këta subjekte nuk mund t’a përdorin këtë informacion për qëllime vetjake. Me informacion mbi klientin do të kuptohet e dhëna ose bashkësia e të dhënave mbi gjëndjen financiare dhe personale të klientit, si dhe ose tërësia e veprimeve që kanë të bëjnë me mbledhjen, regjistrimin, organizimin, sistemimin, ruajtjen, përpunimin, ndryshimin, seleksionimin, nxjerrjen, krahasimin, përdorimin, ndërlidhjen, bllokimin, komunikimin, përhapjen, fshirjen e këtyre të dhënave të klientit që trajtohet nga banka gjatë ushtrimit të veprimtarisë bankare¹.

Trajtimi informacionit të klientit është në kundërshtim me sekretin bankar, sipas pikës 5 të udhëzimit të mëparshëm, kur cënon: a) sigurinë, gjëndjen civile, personalitetin dhe integritetin e klientit; b) interesat direkte apo indirekte personale, familjare, ekonomike, financiare dhe tregtare të klientit; c) marrëdhëniet e bankës dhe klientit; d) marrëdhëniet e klientit me personat e tretë; e) procesin gjyqësor të çështjeve të klientit; f) gjëndjen mendore dhe shëndetësore të klientit; si dhe g) çdo interes tjetër të deklaruar si konfidencial nga klienti ose që mund të konsiderohet si e tillë nga ligji.

Sekreti i informacionit mund të hiqet nga personi i interesuar ose me ligj, në favor të autoriteteve gjyqësore ose fiskale ashtu si edhe ndaj Bankës së Shqipërisë².

¹ Neni 91 ligji nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 10 481, Datë 17.11.2011 (Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional) “1. Administratorët, të punësuarit dhe agjentët aktualë e të mëparshëm të bankës ose degës së bankës së huaj, autoritetet gjyqësore, si dhe inspektorët apo nëpunësit e tjerë të Bankës së Shqipërisë ose të autoriteteve respektive të huaja të mbikëqyrjes bankare, për çdo informacion që marrin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në bankë ose në degën e bankës së huaj, ruajnë sekretin dhe nuk e përdorin atë për përfitime vetjake ose për të tretët jashtë bankës ose degës së bankës së huaj, të cilave u shërbejnë ose u kanë shërbyer. 2. Informacioni i përshkruar në pikën 1 të këtij neni mund t’i jepet vetëm Bankës së Shqipërisë, ekspertit kontabël të autorizuar të bankës ose degës së bankës së huaj, administratorëve, agjentëve, nëpunësve të çdo sistemi informacioni ose shërbimi zyrtar të parashikuar në nenin 23 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, autoritetet juridike që e fitojnë këtë të drejtë me ligj, si dhe kur e kërkon mbrojtja e interesave të bankës ose i degës së bankës së huaj, në procedurat ligjore. 3. Çdo shkelje e dispozitave të këtij neni përbën kundërvajtje penale. Personat fajtorë dënohen me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit. 4. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose për të dëmtuar një person tjetër, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 (dy) vjet”. Neni 125 ligji nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 10 481, Datë 17.11.2011 (Ruajtja e sekretit të informacionit për klientin): “1. Banka ose dega e bankës së huaj ruan sekretin e informacionit për klientin dhe nuk e përdor atë për përfitime vetjake ose për të tretët, të cilëve u shërbejnë ose u kanë shërbyer, në përputhje me nenin 91 dhe kriteret e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë me akt nënligjor. 2. Detyrimi i bankës ose i degës së bankës së huaj për ruajtjen e sekretit të informacionit për klientin, sipas pikës 1 të këtij neni, është pjesë e marrëveshjes apo e kontratës së përcaktuar në nenin 124, pika 2 të këtij ligji”

² E. MISHA, *E drejta bankare*, Tiranë, 2009, fq 90-104; N. KALLFA, *Aspekte juridike të veprimtarisë bankare*, Tiranë 2002, fq. 74 -100; R. CRANSTON, *Principles of Banking Law Oxford*, 2008, fq.432-456.

Në rast detyrimi ligjor (psh. kerkesë nga organe gjyqësore apo tatimore) ose kur nxjerrja e informacionit personal bëhet me aprovim të klientit, bankat duhet të ushtrojnë kujdes maksimal kur përdorin informacione të tilla, me të cilin janë njohur gjatë çdo faze të ofrimit të shërbimit (përpara, gjatë ose pas përfundimit të marrëdhënies kontraktore), si dhe duhet të marrin të gjitha masat e mundshme dhe të arsyeshme për përmbushjen e këtyre detyrimeve³.

I gjithë ky kuadër normativ, që në sektorin bankar shqiptar ka një frymë “europiane” dhe me të cilin kemi patur vështirësi të përshtatemi, duket se po bie poshtë nga normativat që kanë dalë dhe po përgatiten për të dalë, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si në Bashkimin Europian.

Së pari do fillojmë këtë studim të shkurtër nga SHBA-ja që ka nxjerrë normativën më të rëndësishme në këtë sektor të quajtur Foreign Account Tax Compliance Act (FATCA). FATCA (Akti për Përputhjen Tatimore të Llogarive të Huaja) është një akt normativ i njëanshëm i SHBA-së që vlen për të gjitha vendet e botës. Ky akt normativ kërkon nga institucionet financiare të huaja që ofrojnë për autoritetet tatimore të SHBA informacion mbi llogaritë me prejardhje amerikane⁴.

Ligji amerikan i përmendur ka si qëllim të luftojë evazionin tatimor nga tatimpaguesit amerikanë. Shërbimi i Brendshëm i të Ardhurave (“IRS” – autoritet tatimor i SHBA) ka hartuar një strukturë për të mbledhur nga institucionet financiare joamerikane, në bazë vjetore, informacione lidhur me të ardhurat e huaja dhe asetet e mbajtura nga tatimpaguesit amerikanë jashtë Shteteve të Bashkuara.

Institucionet financiare në BE, shprehën shqetësim në lidhje me aplikimin apo zbatimin e FATCA, duke marrë parasysh se ky imponim i njëanshëm ka një kosto të lartë dhe është një barrë shtese për institucionet financiare. Për këtë arsye, në vitin 2011, Komisioni Europian me mbështetjen e plotë të vendeve anëtare të BE zhvilloi një dialog me IRS në konkluzion të cilit, SHBA propozoi dy modele marrëveshje, ku sipas modelit të parë, institucionet financiare do të paraqesin të dhënat tek Administrata Kombëtare Tatimore të cilat automatikisht do të vazhdojnë çdo vit të shkëmbejnë informacion me IRS.

Shkëmbimi automatik i informacioneve do të bëhet midis vendeve që vendosin të aplikojnë FATCA dhe Shtetet e Bashkuara, përkatësisht administratat tatimore kombëtare ku objektivi i marrëveshjes do të jetë shmangia e tatimit të dyfishtë dhe marrëveshja për shkëmbimin e informacionit tatimor.

Sipas modelit të dytë të marrëveshjes, institucionet financiare u lejohet të bëjnë marrëveshje direkte me IRS, që në thelb nënkupton trasmetimin e të dhënave për taksapaguesit amerikanë, drejtpërdrejt tek IRS (Administrata Tatimore e SHBA-se). Ky model marrëveshje nuk bazohet në reciprocitet dhe ngre çështjen e

³ Sipas nenit 24 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”⁹⁷ (MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETIT SHQIPTAR) [...] “5. Banka e Shqipërisë përcakton llojin, mënyrën e dhënies, personat e ngarkuar për dhënien e informacionit të kërkuar, si dhe sekretin zyrtar që zbatohet për dhënien e këtij informacioni”.

⁴ <http://www.irs.gov/Businesses/Corporations/Foreign-Account-Tax-Compliance-Act-FATCA>

mbrojtjes së të dhënave personale, por nga ana tjetër i ofron vendeve që pranojnë këtë marrëveshje, një ndihmë ekonomike dhe në burime njerëzore për të zbatuar normativën ndaj instituteve financiare të pranishëm në vendin nënshkruar.

Pas një sere diskutimesh midis SHBA-ve dhe BE-së arritën në përfundimin se zbatimi i FATCA-s do të zgjidhet në mënyrë bilaterale ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe shtetit që vendos të zbatojnë ligjin në fjalë. Shumica dërmuese e vendeve anëtare të BE-së kanë për qëllim të hyjë në një marrëveshje sipas modelit të parë, që ka të bëjë me shkëmbimin automatik të informacionit ndërmjet administratave tatimore.

Në qershor të vitit 2012, thesari i shtetit Amerikan lëshoi një deklaratë të përbashkët me Japoninë dhe Zvicrën, sipas të cilës institucionet financiare do të bëjnë shkëmbimin e informacionit sipas modelit të parë të kontratës.

Duke filluar nga data 1 Korrik 2014 institucionet financiare, si bankat, do të duhet të përcaktojnë procedurë për të identifikuar klientët e tyre amerikanë. Gjatë vitit 2015, institucionet financiare do të nisin raportimin në autoritetet tatimore amerikane të Identitetit dhe Numrit të Identifikimit Tatimor të klientëve të tyre amerikanë si edhe tepricat e llogarive të tyre në datën 31/12/2014. Informacione shtesë mbi të ardhurat, dhe më pas të ardhurat bruto që rezultojnë nga shitja e letrave me vlerë do të shtohen progresivisht në raportim në vitet në vijim. Në mënyrë që të lehtësojnë implementimin e FATCA një numër i madh vendesh kanë negociuar marrëveshje ndërqeveritare me SHBA⁵. Këto vende do të duhet të përshtasin legjislacionin e tyre kombëtar me kërkesat e raportimit tatimor të FATCA, në këtë pikë Shqipëria nuk e ka nënshkruar ende këtë marrëveshje me SHBA.

Institucionet financiare që nuk zbatojnë FATCA përjashtohen nga tregu i kapitalit dhe SHBA shmanget nga institucionet financiare që punojnë në përputhje me FATCA. Sipas marrëveshjes (FACTA), të dhënat mbi llogaritë nuk mund të përcillen automatikisht por vetëm me miratimin e klientit. Por nëse klienti e refuzon këtë, këmbimi i të dhënave është megjithatë i mundur në bazë të një marrëveshjeje ekzistuese për tatimin e dyfishtë, dhe klientët e “*pabindur*”, do të dënohen me një tatim në burim prej 30% për pagesat me origjinë amerikane.

Këto masa kanë hyrë në fuqi në Zvicër nga 1 korriku 2014 pas marrëveshjes bilaterale midis dy vendeve (modeli 1). Bankat zvicerane të cilat më parë kanë pranuar miliarda nga pasuri të padeklaruara të qytetarëve amerikanë, kërcënohen të përjashtohen nga tregu amerikan.

Masat prekin llogari bankare aktuale dhe të ardhme të shtetasve amerikanë në Zvicër. Pak kohë më parë të dy vendet ranë dakord për trajtimin e pasurisë së patatuar nga e kaluara. Sipas marrëveshjes bankat zvicerane mund të shmangin pasojat me anë të pagimit të gjobave.

⁵ <http://www.irs.gov/Businesses/Corporations/Foreign-Account-Tax-Compliance-Act-FATCA>

Për të përmbushur këto kërkesa, bankat do të duhet të zgjerojnë procedurat e tyre të identifikimit të klientëve, si për klientët e rinj, si për ata ekzistues, duke identifikuar “US Accounts” siç përcaktohet në FATCA dhe për të raportuar tek IRS (“Internal Revenue Service”) të tilla llogari; pikërisht për këto operacione mund të kërkojnë ndihmë ekonomike nga SHBA për të realizuar këto objektiva në rast marrëveshje dypalëshe.

Përveç kësaj, për bankat pjesëmarrëse do të jetë e nevojshme të identifikojnë FFI (“foreign financial institutions”) me të cilën ata operojnë, dhe të verifikojnë nëse janë në përputhje me FATCA (ose marrëveshje korrespondente ndër-qeveritare), dhe në rastin e FFI jo-pjesëmarrës në këto akorde, bankat duhet të aplikojnë tatimin prej 30% (e mbajtur në burim) për pagesat kundrejt këtyre FFI.

Europa po ndjek të njëjtën rrugë, edhe pse me hapa shumë më të ngadalta, me direktivën 16/2011, ku përcaktohet kooperimi midis shteteve pjesëtarë, për shkëmbimin e informacionit në sektorin fiskal, duke dekretuar fundin e sekretit bankar në raportet midis vendeve anëtarë që nga 1 janari 2013⁶. Sot çdo vend i BE-së është i detyruar t’i japi çdo informacion mbi klientët e tyre, autoriteteve fiskale të çdo vendi tjetër anëtar që operojnë në kuadër të luftës kundër evazionit fiskal⁷.

Sidoqoftë këto mekanizma nuk veprojnë në mënyrë automatike, si në rastin e marrëveshjes FACTA me SHBA-në, sidomos kundrejt institutive financiare zvicerian, dhe kjo e lë BE-në në një pozicion dizavantazhi në luftën ndaj evazionit fiskal.

Siç u përmënd Shqipëria aktualisht nuk ka marrëveshje të tipit FACTA, por disa institute financiare (si banka *Credit Agricole*⁸) kanë filluar të apikojnë marrëveshje

⁶ Neni 1 i direktivës 16/2011 Subject matter: 1. *This Directive lays down the rules and procedures under which the Member States shall cooperate with each other with a view to exchanging information that is foreseeably relevant to the administration and enforcement of the domestic laws of the Member States concerning the taxes referred to in Article 2.* Neni 2 i direktivës 16/2011 Scope: 1. *This Directive shall apply to all taxes of any kind levied by, or on behalf of, a Member State or the Member State’s territorial or administrative subdivisions, including the local authorities.* Article 18 Obligations: 1. *If information is requested by a Member State in accordance with this Directive, the requested Member State shall use its measures aimed at gathering information to obtain the requested information, even though that Member State may not need such information for its own tax purposes. [...] 2. In no case shall Article 17(2) and (4) be construed as permitting a requested authority of a Member State to decline to supply information solely because this information is held by a bank, other financial institution, nominee or person acting in an agency or a fiduciary capacity or because it relates to ownership interests in a person.*

⁷ Bontempi, *Diritto bancario e finanziario*, Giuffrè, Milano, ult. Ed, fq 17-19.

⁸ Pozicioni i Bankës Credit Agricole Shqipëri SH.A: Banka Credit Agricole Shqipëri, duke qenë pjesë e Grupit Credit Agricole SHA, ka vendosur më herët të jetë në përputhje me FATCA dhe të zbatojë këtë rregullore si një Institucion Financiar I Konsideruar Përmbushës i FATCA si “Anëtar Jo-Raportues i Grupit PFFI”. Për Bankën Credit Agricole Shqipëri kjo do të thotë se ajo nuk mund të pranojë ose të ketë në stokut e saj llogari amerikane ose llogari subjekt i tatimit në burim ose Institucione Financiare të Huaja JoPjesëmarrëse. Banka Credit Agricole Shqipëri Sh.A është duke punuar me përkushtim për të qenë në përputhje me rregulloren dhe të jetë e gatshme sapo ajo të hyjë në fuqi. Grupi Credit Agricole SHA po planifikon të regjistrohet në portalin IRS brenda afateve kohore të përcaktuara në mënyrë që të listohet si një Institucion Financiar në përputhje me FATCA në listën e parë të pulikuar

direkte me IRS për shkëmbimin e informacionit fiskal për klientët amerikanë.

nga IRS. Ndikimet për klientët: Statusi i një anëtari jo raportues nga një Grup Institucioni Financiar pjesëmarrës i huaj nënkupton që Banka Credit Agricole Shqipëri SH.A nuk është e lejuar të hapë ose mirëmbajë llogari për persona specifike amerikanë, për rrjedhojë: Banka Credit Agricole Shqipëri SH.A do të kontaktojë klientët e saj ekzistues individë kur udhëzime (indikacione) të këtyre rregullave të SHBA të zbulohen në mënyrë që të përcaktojnë situatën e tyre në përputhje me ligjin dhe për të marrë dokumentacionin përkatës nëse është e nevojshme ose të mbyllë llogarinë. Kompanitë e listuara dhe degët e tyre si dhe kompanitë tregtare dhe industriale janë të përjashtuara nga kjo rregullore. Gjithsesi, njësitë për të cilat shumica e të ardhurave vjen nga aktivet financiare ose nëse më shumë se 50% e bilancit konsiston në aktive financiare do të jetë subjekt i një analize të pronësisë. Në masën që një pronar përfitues është nënshtruar amerikan ose rezident amerikan për qëllime tatimore, ai duhet të vendosë nëdispozicion numrin e tij të identifikimit tatimor amerikan. Banka Crédit Agricole Shqipëri SH.A duhet të kontaktojë klientët e saj të biznesit për të konfirmuar statusin e tyre në lidhje me rregulloren. Nëse, gjatë rishikimit të stokut, Gjenden llogari amerikane, këto duhet të mbyllën brenda 6 muajve. Pas datës 1 Korrik 2014, kur të hapet një llogari e re, Banka Credit Agricole Sh.A do të mbledhë informacion nga klientët e saj për të lejuar identifikimin e nënshtruarve amerikanë ose rezidentëve amerikanë për qëllime tatimore. Për më tepër, dokumenta specifike mund ti kërkojnë klientëve biznese në mënyrë që të konfirmohet statusi i tyre FATCA. Llogaritë e konfirmuara si llogari amerikane ose llogari të mbajtësve të llogarive të pabindura ose llogari të Institucioneve Financiare të Huaja jo pjesëmarrëse nuk do të hapen. Burim: <http://www.credit-agricole.al/wp-content/uploads/2014/06/FATCA-nje%CC%88-rregullore-qe%CC%88-ndikon-Banke%CC%88n-Cre%CC%81dit-Agricole-Shqipe%CC%88ri-SH.A-dhe-kliente%CC%88t-e-saj.pdf>

Fjalët kyç: koncepti i sigurisë, siguria njerëzore, të drejtat e njeriut, “përgjegjësia për të mbrojtur”.

Konceptet e së ardhmes mbi sigurinë njerëzore

Ilir ISLAMI, PhD Kandidat

Sevdie KADRIU, PhD Kandidate

Abstrakt

Avancimi i konceptit të sigurisë njerëzore dhe vendosja e individit në qendër të vëmendjes kur bëhet fjalë për sigurinë në përgjithësi, ka rezultuar me ndryshime të mëdha në studimet bashkëkohore mbi këtë temë. Duke patur parasysh se koncepti i sigurisë njerëzore akoma nuk është i përcaktuar shumë qartë, autorë të ndryshëm bëjnë përpjekje të vazhdueshme që këtë koncept ta përcaktojnë sa më qartë dhe ta operacionalizojnë sa më tepër me qëllim që në këtë mënyrë ta rrisin vlerën e tij si në aspektin teorik ashtu dhe në atë praktik. Hapi i parë në këtë drejtim sigurisht është Raporti i vitit 2001 i hartuar nga Komisioni Ndërkombëtar mbi Intervenim dhe Sovranitet Shtetëror (ICISS) “Përgjegjësia për të mbrojtur”, të cilin raport Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki-Mun e ka aktualizuar në vitin 2009 përmes Raportit Zbatimi i Përgjegjësive për të Mbrojtur”. Në këtë kumtesë do të vihet në dukje se kontributi i doktrinës “Përgjegjësia për të mbrojtur” është ajo që në diskutimet e shumta të cilat bëhen rreth sigurisë merr parasysh interesat e njeriut dhe të drejtat njerëzore të tij, dhe po ashtu, për shkak të karakteristikave që ka kjo doktrinë, shkakton polemika sipas të cilave mund të bëhet fjalë ndoshta për ndonjë lloj doktrine hegjemoniste e cila nuk është e bazuar në principet njerëzore, por si një përpjekje që shteteve të dobëta t’ju kufizojë sovranitetin dhe pavarësinë politike. Siguria si një kusht i mbijetesës dhe veprimtarisë së individit, shoqërisë, shteteve dhe bashkësisë ndërkombëtare është një nga funksionet themelore shoqërore. Por me të vërtetë qëndron ky konstatim, dëshmon e dhëna se sigurisë së përgjithshme i është kushtuar kujdes që nga kohërat kur njerëzit kanë jetuar në bashkësi primitive, dhe deri më sot kur veç kemi hyrë në shekullin e XXI. Megjithatë, termi shumëdimensional i sigurisë, nuk ka pasur gjithnjë domethënie të njëjtë përgjatë gjithë kësaj kohe, por ajo është emërtuar me terme të ndryshme tek teoricienë të ndryshëm. Përfundimi i sigurisë dhe përmbajtjes së tij është i ndryshëm në konceptet tradicionale për dallim prej koncepteve moderne.

1. Hyrje

Siguria përfaqëson një nga dukuritë themelore të shoqërisë njerëzore në të gjitha etapat e zhvillimit njerëzor. Pa marrë parasysh se a është fjala për sigurinë e individëve, shteteve, apo bashkësisë ndërkombëtare vazhdimisht punohet për të siguruar vlera dhe gjendje të cilat konsiderohen si të rëndësishme së veçantë. Pikërisht për këtë arsye është me rëndësi për tu njohur me këtë koncept, posaçërisht kur bëhet fjalë për sigurinë njerëzore.

Koncepti siguri njerëzore në kohërat moderne ka filluar të përdoret pothuajse në të gjitha hapësirat dhe veprimtaritë e njerëzve. Nga ky aspekt nuk është fare për tu çuditur përse disa autorë këmbëngulin se ky është njëri ndër konceptet më të shpeshta që përdoret në përgjithësi sot. Megjithatë, krahas kësaj ata rikujtojnë se ky njëkohësisht është edhe njëri ndër konceptet që më së paku është sqaruar deri më sot.

Periodha pas Luftës së Dytë Botërore, përveç të tjerash, karakterizohet me themelimin e *Organizatës së Kombeve të Bashkuara* dhe miratimin e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara (24 tetor 1945), Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut (1948) dhe Deklaratës të Kombeve të Bashkuara për njohjen e pavarësisë së vendeve koloniale dhe kombeve (1960). Miratimi i këtyre akteve normative vetëm ka përshpejtuar zhdukjen e imperializmit si politikë legale dhe legjitime e disa shteteve si dhe raportet koloniale që kanë ekzistuar, dhe ka sjell deri tek formimi i një numri të madh të lëvizjeve popullore çlirimtare dhe krijimin e shteteve të reja nacionale, posaçërisht në vendet e Azisë dhe Afrikës¹.

Mirëpo, këto shtete të reja të krijuara janë ballafaquar me një sërë problemesh: revolucione të ndryshme, luftëra qytetare, probleme të theksuara ekonomike, korrupsion, varfëri, papunësi etj.

Përgjigjja e vendeve të zhvilluara në këto sfida nuk ka qenë adekuate, sepse përveç të tjerash, ka qenë e bazuar në qëllimet strategjike, në funksion të mbajtjes joformale të ndikimit të tyre tek kolonitë e vjetra. Në këto rrethana, lajmërohen rryma të ndryshme në teorinë ekonomike, të cilat fokusohen në problemin e zhvillimit jo të barabartë dhe shpërndarjes jo të drejtë të resurseve dhe fitimit.

Faktorët e sipërpërmendur kanë krijuar një mjedis të tillë intelektual i cili ka inkurajuar gërshetimin e ekonomisë me studimet mbi sigurinë në kontest të sigurisë individuale (*njerëzore*) dhe gjithashtu kanë krijuar parakushtet ekonomike për ta arritur atë siguri.

¹ Berger, Mark T. (2003): *The Battle for Asia: From Decolonization to Globalization (Asia's Transformations)*, Routledge, London

2. Konceptet mbi sigurinë njerëzore

Megjithatë, konceptet themelore mbi sigurinë njerëzore, së paku ato që ne i njohim deri më sot, duhet të kërkohen në ngjarjet që konkretisht kanë ndodhur në fund të viteve të 1980-të dhe fillim të viteve 1990-të të shekullit të kaluar. Fundi i luftës së ftohtë, defaktorizimi i komunizmit dhe orientimi i BRSS-së drejtë integritimeve në Europë, dhe konceptet strategjike të Paktit Veri-Atlantik shkaktuan lindjen e ideve neoliberales lidhur me këtë problematikë².

Në këtë mënyrë, konceptet tradicionale mbi sigurinë shtetërore kanë ngelur si koncepte shumë të ngushta për t'i kuptuar marrëdhëniet ndërkombëtare dhe para së gjithash sigurinë ndërkombëtare. Siguria njerëzore është e fundit në listën e çështjeve e cila i shtyn politikanët dhe hulumtuesit e ndryshëm që sigurinë ndërkombëtare ta kuptojnë si diçka më të gjerë sesa mbrojtja ushtarake e interesave shtetërore dhe territoreve. Për këtë arsye, koncepti i sigurisë njerëzore, edhe pse nuk është i përcaktuar saktësisht, zgjeron fushën e hulumtimit të sigurisë në përgjithësi duke shkaktuar në këtë mënyrë ndryshime si në mjedisin politik ashtu edhe në atë akademik. Të gjitha rrethanat e krijuara kanë çuar deri aty që pikërisht UNDP si Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara e dedikuar për çështjet e zhvillimit global të jetë iniciatore e kësaj ideje. Prandaj, koncepti i sigurisë njerëzore është për shkak të diskursit politik dhe akademik duke ju falënderuar Raportit të Zhvillimit Njerëzor nga viti 1994 i cili e formulon konceptin e sigurisë njerëzore³. Sipas këtij raporti thuhet se: ideja për sigurinë njerëzore, edhe nëse është shumë e thjeshtë do ta revolucionarizojë shoqërinë e shekullit XXI.

3. Siguria njerëzore në aspektin e sigurisë për jetë, shëndet, liri

Kur flasim për sigurinë individuale (*njerëzore*) ajo nënkupton sigurinë për jetë, shëndet, status, liri etj. Elementet e cekura janë shumë të rëndësishme, dhe shumë prej tyre nuk mund të zëvendësohen në rast se humbin. Për këtë arsye mund të thuhet se siguria njerëzore ka dy aspekte kyçe:

Aspekti i parë përfaqëson mbrojtjen nga kërcënimet kronike siç mund të jenë uria, sëmundja dhe represioni, kurse, *aspekti i dytë* nënkupton mbrojtjen nga çrregullimet e papritura dhe të dhimbshme të cilat e përcjellin jetesën e përditshme pavarësisht se a ndodhin në shtëpi, në punë apo edhe në vende të tjera. Ky përkufizim natyrisht shumë i gjerë dhe i pa precizuar në mënyrë të mjaftueshme, ka shkaktuar që siguria njerëzore të shihet si një fushë e papërcaktuar qartë. Një

² Gupta, Sanjeev; Clements, Bend edict, Bhattacharya, Rina, Chacravarti, Shamit(2002): The Elusive Peace Dividend, Finance and Development

³ UNDP (1993): Human Development Report, Chapter 1, p.12. <http://hdr.undp.org/en/reports/global/hdr1993>

vështirësi shtesë në studimin e këtij koncepti vjen nga fakti se, ende nuk ekziston një term i përgjithshëm dhe i pranueshëm nga të gjithë mbi sigurinë njerëzore. Megjithatë shumica e përkufizimeve e trajtojnë si diçka të dobishme për njerëzit e zakonshëm.

Siguria njerëzore, siç thekson *Kofi Anan*, në kuptimin e gjerë përfshin, të drejtat njerëzore, qeverisjen e mirë, mbrojtje shëndetësore si dhe krijimin e kushteve që secili individ ka rastin dhe zgjedhjen të arrijë potencialin e vet. Çdo hap në këtë drejtim është një hap drejtë zvogëlimit të varfërisë, rritjes ekonomike dhe tejkalimit të konflikteve⁴.

Edhe pse shumë shkurtimisht, kjo pikëpamje e ish *Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së* është e rëndësishme së veçantë sepse ngërthen në vete dy aspekte të rëndësishme të sigurisë njerëzore: *heqjen e lirisë* dhe *heqjen e frikës*.

Ideja e heqjes së lirisë si përkufizim i sigurisë njerëzore nisët nga fakti se në konfliktet e armatosura brenda vitit vriten shumë më pak njerëz sesa ishte rasti me humbjet që shkaktohen si pasojë e mungesës së ujit dhe ushqimit, varfërisë, papunësisë, sëmundjeve të ndryshme, nga mos animi i katastrofave në rast të fatkeqësive natyrore etj. Prandaj ajo nga e cila njeriu është i privuar në shkallën më të madhe në jetën e tij, nuk janë kërcënimet ushtarake por janë pikërisht faktorët e përmendur më lartë.

Kur flasim për këtë problematikë, mund të themi se koncepti i sigurisë njerëzore, dallohet nga të tjerat nga koncepti i sigurisë nacionale për faktin se objekt referimi këtu nuk është shteti por individit. Sipas hulumtimeve të ndryshme të bëra mos suksesi më i madh i sigurisë shtetërore lidhet me faktin se shteti nuk ka arritur qëllimin e vet kryesor, e kjo është mbrojtja e plotë e individit. Në këtë mënyrë siguria nacionale gjegjësisht siguria shtetërore nuk ka arritur që ta përmbush këtë pjesë të përgjegjësisë ndaj shoqërisë. Në këtë kuadër siguria njerëzore përfshin edhe bashkësitë e ndryshme shoqërore, por edhe kombet në përgjithësi. Megjithatë, individët janë objekt më i rëndësishëm i referimit kur flasim për sigurinë njerëzore sepse me sigurinë e tyre arrihet edhe siguria e subjekteve të tjera. Në këtë aspekt, individit nuk është më vetëm mjet për arritjen e sigurisë nacionale, por bëhet koncept themelor i sigurisë.

Prandaj nuk është për tu çuditur Raporti për zhvillimin njerëzor i UNDP-se i vitit 1994, i cili pas të tjerash konstaton se lista e kërcënimeve të sigurisë njerëzore është relativisht e gjatë, por shumica e këtyre mund të grupohen në disa kategori si në vijim:

Siguria ekonomike, ballafaqohet nga kërcënimet që vijnë nga papunësia, nga mos siguria në vendet e punës, nga kushtet e vështira të punës, nga pabarazia në hyrjet që realizojnë, inflacioni, nga mungesa e sigurimeve shëndetësore dhe nga faktorët e tjerë.

⁴ Franklin Delano Roosevelt- Speech about Four Freedoms: <http://www.americanhetoric.com/speeches/fdrthefourfreedoms.htm> (25.01.2011)

Siguria në aspektin e ushqimit arrihet me zgjidhjen e problemeve që lidhen me sjelljen fizike dhe ekonomike në ushqim. Njerëzit janë të uritur, jo nga arsyeja se nuk ka ushqim, por nga fakti se nuk kanë mundësi që ta sigurojnë atë.

Siguria shëndetësore, ka të bëjë me kërcënimet ndaj sigurisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve të shkaktuar nga sëmundjet e ndryshme infektive dhe nga parazit të ndryshëm, nga virusi HIV, sëmundjet e shkaktuara nga ajri i ndotur dhe uji, si dhe nga sjellje jo adekuate në shërbimet shëndetësore.

Siguria personale merret me luftimin e kërcënimeve të cilat mund të shfaqen në forma të ndryshme: kërcënimet nga ana e shtetit (*dhuna fizike*), kërcënimet që mund të vijnë nga shtete të tjera (*luftërat e ndryshme*), kërcënimet nga grupe të ndryshme ndër etnike (*tensionet e ndryshme ndërmjet komuniteteve*), kërcënimet që mund të vijnë nga grupe të ndryshme kriminale (format e ndryshme të kriminalitetit), kërcënimet që janë të drejtuara nga femrat (*dhunimet e ndryshme dhe dhuna në familje*), kërcënimet e drejtuara ndaj të miturve (*keqtrajtimi i tyre në forma të ndryshme*) dhe në fund kërcënimet të cilat janë të drejtuara kundër vetvetes (*vetëvrasjet, përdorimi i substancave narkotike*) etj.

Siguria ekologjike, merret me pengimin e degradimeve në ekosistemet lokale dhe globale, situatat e mungesave të ujit, menaxhimin e situatave të vërshimeve dhe katastrofave të ndryshme natyrore, shpyllëzimeve të panevojshme, ndotjeve të ajrit, tokës dhe ujit etj.

Siguria politike përfaqëson njërin nga aspektet më të rëndësishme të sigurisë njerëzore, dhe nënkupton jetën në një shoqëri të caktuar në të cilën respektohen të drejtat themelore të njeriut ku dhe nuk zbatohet aparati i dhunës shtetërore.

Sot shteti duhet të jetë instrument funksional, sepse ai duhet që individit si objekt referimi t'i ofrojë siguri, jetë të sigurtë dhe të qetë, pa skamje, pa uri dhe pa sëmundje. Mirëpo, nëse kjo nuk është duke ndodhur, atëherë fjala është për shtet i cili përfaqëson burim problemesh apo edhe kërcënim për sigurinë e qytetarëve të vet. Në këtë rast vetvetiu do të lind pyetja: cili shtet do t'ju ofronte siguri këtyre njerëzve nëse një gjë të tillë nuk do t'ua bëjë shteti i tyre. Në rastet e tilla paraqiten organizatat e ndryshme ndërkombëtare të cilat do të bëjnë përpjekje që së paku për të sensibilizuar opinionin publik se çfarë në realitet është duke ndodhur. Në këtë mënyrë hapen dyert për zbatim të politikave të ndërhyrjes së bashkësisë ndërkombëtare dhe shpeshherë vihen deri tek keqpërdorimi i konceptit në kuptim të shkatërrimit të sovranitetit dhe sistemit politik të këtyre shteteve, edhe pse koncepti i sigurisë njerëzore është i përfshirë në kuadër të *Kombeve të Bashkuara*, disa prej shteteve janë treguar jo të gatshme që një koncept të këtillë ta zbatojnë në praktik.

Në deceniet e fundit si në rrafshin politik ashtu edhe në atë akademik është zhvilluar përkufizimi rreth domenit të sigurisë njerëzore me qëllim të operimit më të lehtë si në kuptimin praktik-politik ashtu edhe në kuptimin teorik-akademik. Një iniciativë e këtillë vlen të përmendet ajo e *Qeverisë së Kanadasë*, e cila sigurinë

njerëzore e kupton si: liri nga kërcënimet të cilat rrezikojnë të drejtat njerëzore, sigurinë apo jetën e njerëzve, dhe në këtë kuptim ajo ka përcaktuar pesë prioritete të politikës së jashtme në kontest të avancimit të sigurisë njerëzore:

- *Mbrojtja e popullatës civile*- duke forcuar vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare, normat dhe kapacitetet me qëllim të zvogëlimit të humbjeve njerëzore në konfliktet e armatosura.
- *Operacionet në përkrahje të paqes*- përmes rolit më aktiv të saj në misionet paqësore të Kombeve të Bashkuara.
- *Qeverisja dhe përgjegjësia*- nënkupton avancimin e përgjegjësisë të sektorit publik dhe atij privat në kuptim të zhvillimit të parimeve demokratike dhe të drejtave njerëzore.
- *Tejkalimin e konflikteve*- përmes kapaciteteve të bashkësisë ndërkombëtare, si dhe përmes zhvillimit të kapaciteteve autonome lokale, me qëllim të tejkalimit të konflikteve përmes marrëveshjeve.
- *Siguria publike*- nënkupton zhvillimin e ekspertizave ndërkombëtare, kapaciteteve dhe instrumenteve me qëllim për t'ju përgjigjur organizatave të ndryshme transnacionale të kimit te organizuar.

Në vitin 2000, është themeluar po ashtu Komisioni Ndërkombëtar për Intervenim dhe Sovranitet Shtetëror. Qëllimi i këtij Komisioni ka qenë të ofrojë zgjidhje praktike në rastet kur ka shkelje elementare të të drejtave të njeriut, dhe mekanizmat efikase për mbrojtjen e popullatës në rastet kur ka shkelje të këtyra. Në vitin 2001, ky komision doli me raportin e ashtuquajtur: *"Përgjegjësia për të Mbrojtur"* sipas të cilit raport ndërhyrja ushtarake me qëllim të mbrojtjes së njerëzve arsyetohet në dy raste: *së pari* me qëllim të parandalimit ose ndaljes së humbjeve të mëdha të njerëzve i drejtuar me qëllime gjenocidi dhe i cili është rezultat i veprimtarisë së qëllimshme shtetërore dhe *së dyti* për shkak të *"spastrimit etnik"* pavarësisht a bëhet fjalë për vrasjen, deportimin me dhunë, terrorit apo dhunimeve. Nëse është plotësuar njëri nga këto kushte apo të dyja, qëndrimi i këtij komisioni është se vendimi për ndërhyrje është plotësisht i drejtë.

Prandaj është me rëndësi këtu të theksohet çka në fakt këto dy kushte përfshijnë në vetvete dhe çka ato përjashtojnë. "Qëndrimi i Komisionit Ndërkombëtar për Intervenim dhe shtetet sovranë" është se këto dy kushte përfshijnë rastet si në vijim:

- Ato veprime të cilat janë të definuar me Konventën e vitit 1948, për gjykimin dhe dënimin e krimineleve të gjenocidit dhe të cilat paraqesin kërcënime serioze apo shkaktojnë humbje të mëdha në jetët e njerëzve.
- Kërcënime serioze apo humbje të mëdha në njerëz, pavarësisht se a janë si produkt i gjenocidit të paramenduar dhe pavarësisht a përfshihen aksionet nga shteti apo jo.

- Format e ndryshme të “*spastrimeve etnike*”
- Krimet kundër njerëzimit dhe shkelja e ligjeve të luftës, në atë mënyrë siç janë të përcaktuara me Konventat e Gjenevës dhe akteve të tjera, ku nënkuptohet numër i madh i vrasjeve dhe “*spastrimeve etnike*”.
- Uria masive e banorëve apo lufta qytetare si pasojë e paralizimit të shtetit.
- Katastrofa të ndryshme natyrore dhe ekologjike me të cilat shtetet nuk dëshirojnë apo nuk janë në gjendje të ofrojnë apo të kërkojnë ndihmë, apo në fakt bëhet fjalë për një numër të madh humbjesh në njerëz dhe në objekte.

Megjithatë, pothuajse të gjitha këto situata apo kërcënime janë të përfshira në rendin juridik ndërkombëtar. Krimet kundër paqes, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit së pari herë janë përfshirë në Statutin e Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare të Nynbergut⁵. Me vonë janë përfshirë edhe në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare për Krime lufte të ish Jugosllavisë, Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ruandën dhe përfundimisht me Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare të Romës⁶.

Në këtë aspekt, objektivi i doktrinës së raportit “*Përgjegjësia për tu mbrojtur*” është pikërisht mbrojtja e njeriut kur ekzistenca e tij është e rrezikuar, në situatat kur shteti nuk dëshiron apo nuk mundet t’i ofrojë sigurinë, prandaj edhe zhvillohen mekanizmat e ndryshëm për zbatimin e intervenimeve multilaterale me të vetmin qëllim mbrojtjen e tyre në cilindo vend në botë.

Po ashtu, e drejta e intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare në raste të: rrezikimit të *paqes*, cenimit të saj apo akteve agresore është e definuar shumë qartë me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara. Veprimet e specializuara, në pajtim me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara, si kundërpërgjigje në kërcënimet ndaj sigurisë janë sanksionet politike dhe ekonomike që zbatohen ndaj vendeve të cilat me të vërtetë e rrezikojnë sigurinë e qytetarëve të vet. Megjithatë shpeshherë këto masa kanë edhe efekte të kundërta ngaqë edhe ashtu vështirësojnë edhe më shumë jetën e këtyre banorëve. Prandaj, raporti në fjalë aksentin e vendos pikërisht tek intervenimet ushtarake.

Që siguria njerëzore si koncept themelor i sigurisë të mund realisht të zbatohet në praktikë, është e domosdoshme që ata kufijtë e “*mjegullt*” lidhur me të, të definojnë qartë. Testi kryesor mbi rëndësinë e çdo koncepti, është mundësia e zbatimit praktik të saj. Që një koncept i caktuar të mund të zbatohet në praktikë ai domosdo duhet të operacionalizohet. Kjo është shumë e vështirë posaçërisht kur kemi të bëjmë me konceptin mbi sigurinë njerëzore, ngaqë në rrugën e zbatimit të sigurisë njerëzore ballafaqohemi me disa sfida.

⁵ Internacional Military Tribunal(1945) Nurnberg IMT Statute , Article 6

⁶ Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë; neni 3,4 dhe 5 Statute of the International Tribunal for Rwanda, Article 2,3 and 4 : Rome Statute of the International Criminal Court, Article 6, 7 and 8

Së pari, që të jemi në gjendje ta zbatojmë një koncept të këtillë, duhet të dimë se çka në fakt paraqet ai. Pajtuemshëri e plotë rreth definicionit të sigurisë njerëzore nuk ekziston, dhe pa një definicion të qartë, mundësia e zbatimit adekuat të saj në praktikë themi se është shumë e vogël.

Së dyti, ngjarjet që kanë ndodhur me 11 shtator 2001, nga aspekti i sigurisë njerëzore kanë shkaktuar një tronditje të jashtëzakonshme dhe pasoja të paparashikueshme.

Pikërisht ngjarja e tillë ka ndikuar edhe në ndryshimin e koncepteve mbi sigurinë në përgjithësi dhe për sigurinë njerëzore në veçanti.

Së treti, dhe ndoshta sfida më e rëndësishme për operacionalizimin e këtij koncepti është pyetja, kush është përgjegjës për ofrimin e sigurisë njerëzore?

Siguria njerëzore është paramenduar si siguri në të cilën njerëzit do të ofronin mbrojtje për njeriun, mirëpo një sistem i menduar nën konstelacionin e tillë të forcave në nivel lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar paraqet një ide shumë të vështirë për tu implementuar.

Pavarësisht objektit që i referohemi (individ, bashkësia shoqërore, shteti apo sistemi ndërkombëtar) shteti, prapsepap mbetet si kujdestari kryesor i sigurisë njerëzore. Megjithatë nuk janë të gjitha shtetet të njëjta në pikëpamje politike, ekonomike dhe ushtarake. Ekzistojnë disa shtete të cilat janë aq të fuqishme që mundën jo vetëm të përkujdesen për sigurinë njerëzore brenda shtetit të vet por edhe për të siguruar mbrojtjen e njerëzve përmes mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtar dhe në shtetet e tjera.

Pikërisht për këtë arsye lidhur me konceptin e sigurisë njerëzore lidhen disa kontraverza të caktuara. Megjithatë, pa marrë parasysh se në rolin e titullarit të kësaj forme të sigurisë shfaqen shtetet apo bashkësia ndërkombëtare, se a do të zbatohet siguria njerëzore në kuadër të konceptit të zgjeruar mbi sigurinë nacionale apo do të realizohet përmes ndërhyrjeve qoftë në aspektin ekonomik apo edhe në atë ushtarak nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, padyshim një kontribut pozitiv do të mund të arrihej nëse në bisedimet e ndryshme që zhvillohen mbi sigurinë t’i kushtohet një vëmendje e posaçme njerëzve dhe qytetarëve të thjeshtë. Prandaj, nga ky aspekt duhet të shikohet kontributi që jep koncepti mbi sigurinë njerëzore.

4. Përfundim

Koncepteve të deri tanishme mbi sigurinë njerëzore i adresohen shume kritika, sipas të cilave këto koncepte paraqesin pretekse që shteteve të dobëta tu merret sovraniteti dhe pavarësia politike, dhe pikërisht këto pikëpamje na shtyjnë të mendojmë se a është fjala me të vërtetë për “*koncepte të vjetra në letër të re*” të cilat koncepte me retoriken e paqes mundohen që ta “*helmojnë*” opinionin dhe tërheqin vëmendjen me dyshimin se ndoshta bëhet fjalë për ndonjë doktrinë hegjemoniste

në ballë të së cilës nuk janë idealet humanitare, por lufta pa kompromise e shteteve për ta shtuar fuqinë dhe për ta përmirësuar pozitën e tyre konkurrense në sistemin ndërkombëtar.

Kontributi praktik dhe intelektual i koncepteve të reja mbi sigurinë njerëzore duhet të qëndrojë pikërisht që në debatet që zhvillohen mbi sigurinë njerëzore ku do të merret parasysh interesi i njerëzve të thjeshtë.

Edhe nëse siguria njerëzore si një e mirë publike është përgjegjësi e shtetit, në të njëjtën kohë kërkon nga njerëzit (*individët*) të angazhohen më shumë aktivisht në sigurinë e përgjithshme. Individët kanë aftësi që t'i identifikojnë problemet dhe të ofrojnë zgjidhje për ato probleme. Në rastin e kundërt, në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ndërmjet organizatave ndërkombëtare, ku nxjerrin vendime, individit nuk është prezent, dhe duke pasur parasysh këtë edhe nuk mund të vendos.

Përmes nxjerrjes dhe aplikimit të normave për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, të cilat paraqesin themelet e sigurisë njerëzore dhe përparimin e fundit të koncepteve mbi sigurinë njerëzore, bota ka vërejtur se siguria duhet të jetë e ndërtuar në themelet e sigurisë individuale të secilit, për të pasur kuptim në nivelin ndërkombëtar.

Ndaj konsiderojmë, se përderisa dialogusit kryesor të koncepteve mbi sigurinë njerëzore, të vazhdojnë promovimin e definicioneve të përgjithësuara, joprecize dhe të papërdorshme, siguria njerëzore do të mbetet vetëm një ide e mirë, pa ndonjë vlerë të mirëfilltë praktike.

Përfundimisht, fokusi i qarqeve politike dhe akademike do të duhet të jetë në operacionalizimin dhe sendërtimin në praktikë të koncepteve të reja mbi sigurinë njerëzore, dhe konsiderojmë se ky punim është një shembull i mirë në këtë drejtim.

Bibliografia

- Berger, Mark T. (2003): *The Battle for Asia: From Decolonization to Globalization (Asia's Transformations)*, Routledge, London.
- Franklin Delano R.- *Speech about Four Freedoms*(25.01.2011): <http://www.americanhetic.com/speeches/fdrthefourfreedoms.htm>
- Gupta, Sanjeev; Clements, Benedict; Bhattacharya, Rina; Chacravarti, Shamit (2002): *The Elusive Peace Dividend, Finance and Development*;
- Internacional Military Tribunal(1945) Nurnberg IMT Statute , Article 6
- Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale per ish Jugosllavinë;
- Statut of the International Tribunal for Rwanda,
- Rome Status of the International Criminal Court,
- UNDP (1993): *Human Development Report, Chapter 1, p.12.* <http://hdr.undp.org/en/reports/global/hdr1993>.

ARTIKUJ DHE STUDIME

Këndvështrimi i një pretendimi civil në procesin penal

Dr. Çlirim Duro

Abstrakt

Padia civile në procedimin penal, si një e drejtë për kërkim dhe gjykim, është mjete procedural i cili vë në lëvizje organin procedues dhe pushtetin gjyqësor për shqyrtimin në themel të saj, në bazë të fakteve dhe karakteristikave të njëjta, së bashku me aktet penale, që sipas ligjit në fuqi vlerësohen dhe gjykohen në një proces të vetëm, me qëllim dhënien e një vendimi të përbashkët si për akuzën penale ashtu edhe për pretendimin civil. Ky institut i të drejtës Procedurale Penale të RSH, ka rëndësi teorike dhe praktike, pasi mbron interesat e ligjshme private, shtetërore dhe publike, duke reflektuar siç janë më poshtë:

Në aplikimin dhe zbatimin e këtij instituti në praktikën aktuale gjyqësore, pasi përgjithësisht për çdo veprë penale që parashikon ligji, kemi cenim të interesave të ligjshme të personave fizikë ose juridikë (privat ose publik).

Në planin teorik paraqiten vështirësi konceptuale procedurale që pengojnë dhe vështirësojnë nga ana praktike kërkimin civil në procedimin penal sipas kërkesave ligjore. Trajtimi dhe konceptimi i drejtë i normave juridike respektive sjell logjikisht instrumentalizimin e tyre, i cili shërben për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme materiale të subjekteve të ndryshëm, gjë e cila realizohet nëpërmjet dhënies së vendimit gjyqësor.

Ky artikull, ka si qëllim trajtimin teorik, që përfshin: konceptimin analitik të pretendimit civil në procedimin penal, analizën e normave dhe situatave juridike respektive si dhe përshtatjen aplikative legjislative në zbatimin praktik, mbështetur mbi baza doktrinale dhe normative.

Fjalë Kyç: *padia civile, procedurë penale, juridiksioni gjyqësor, garanci procedurale.*

1. Raporti midis disiplinës penale dhe disiplinës civile

Sistemi i të drejtës ndahet në dy grupe të mëdha normash juridike, të cilat rregullojnë aktivitetin e subjekteve të ndryshëm të së drejtës dhe dallojnë në norma materiale, që rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhëniet që krijohen mes subjekteve të së drejtës dhe normave procedurale, që kanë për objekt garantimin dhe mbrojtjen e vetë të drejtave materiale që rregullohen nga normat materiale¹.

E drejta procedurale në çdo degë të saj (civile, penale, administrative) rregullon veprimtarinë në dhënien e drejtësisë, duke garantuar në të njëjtën kohë si respektimin e të drejtës, ashtu dhe personalitetin e subjekteve të ndryshëm, pra të drejtat subjektive materiale të këtyre subjekteve, qoftë në marrëdhëniet e tyre reciproke, qoftë kundrejt organeve të pushtetit publik dhe duke u ofruar këtyre subjekteve mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme².

Bazuar në sa u tha më sipër, mund të nxjerrim dhe karakteristikat e së drejtës procedurale, si civile ashtu dhe penale, duke i shprehur në union të plotë dhe që janë një e drejtë instrumentale, dinamike e që i përkasin të drejtës publike³.

1.1 Padia civile në procesin penal

Një nga institutet më të rëndësishme që paraqet elementin privat në disiplinën procedurale penale është përkatësisht “*Padia civile në procesin penal*”, në të cilën ndërthuret elementi publik me atë privat, ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, neni 61 KPrP.

Ky institut lejon krijimin e marrëdhënies juridike civile në brendësi të procesit penal, ku, së bashku me shqyrtimin gjyqësor të akuzës, bëhet dhe ai i padisë civile. Marrëdhënia juridike civile gjatë procesit penal jo gjithmonë mund të përputhet me karakterin publik të së drejtës penale, por ndodh që të korrespondojë me procesin penal ku evidentohet marrëdhënia private e palëve.

Pretendimi civil në procesin penal vjen si pasojë logjike e katër kushteve të procedimit:

1. Juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal.
2. Kompetenca e gjykatës penale për shqyrtimin e padisë civile.
3. Palët private në procesin penal.
4. Paragjyqeshmëria (parimi i gjësë së gjykuar).

¹ *Procedura Civile*, Alban Brati, Botimet DUDAJ 2008, fq. 45.

² Po aty.

³ Po aty.

1.2 Karakteristikat e padisë civile në procesin penal

Prezantimi i marrëdhënies juridike civile nuk kërkon zbatimin e normave procedurale civile, sikundër do të ishte e logjikshme gjatë procesit civil, pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar mbi provat dhe ligjin penal (*neni 382 KPrP*), por marrëdhënia juridike civile qëndron e ndërvarur nga faktet dhe rrethanat e çështjes penale dhe në konkluzion janë ato të cilat provokojnë ushtrimin e pushtetit gjyqësor. Subjektet në procesin penal mund të shfrytëzojnë të drejtën subjektive procedurale në parashtrimin e pretendimeve civile, por është prokurori dhe gjykata ata që kanë pushtetin për pranimin ose jo të padisë civile, legjitimimi i paditësit civil mund të bëhet nga organi procedues derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, (*neni 62/1 KPrP*), gjithmonë jo për të dëgjuar kërkuesin mbi themelin e pretendimit, por për të shqyrtuar atë në varësi të akteve penale.

“Bashkimi i gjykimit të padisë civile në gjykimin e çështjes penale, nuk cenon as procedimin penal dhe as atë civil. Të dy procedimet ruajnë karakteristikat e tyre të veçanta sipas dispozitave respektive që i rregullojnë, por për shkak të elementëve të përbashkët si palët, provat e nevojshme etj [...], bashkohen në një procedim të përbashkët”⁴. Gjykimi i padisë civile së bashku me atë të veprës penale, krijon mundësinë për të mënjeluar për çdo eventualitet dhënien e vendimeve penale e civile kontradiktore për të njëjtën çështje⁵.

Bazuar në sa u tha më sipër, mund të evidentojmë karakteristikat e padisë civile në procesin penal, të cilat janë:

1. Formimi i një raporti procedural civil i pavarur dhe i ndryshëm, i vendosur në brendësi të një procesi ku është parakusht një raport procedural penal. Ndërtimi i marrëdhënies juridike civile shërben për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të subjektit që pretendon që është cenuar nga vepra penale, padia mund të ngrihet, për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur (neni 32 i KPrC). Nga ana tjetër, krijimi i një procesi penal ka si qëllim ndëshkimin e personit që prezumohet të ketë shkaktuar faktin e paligjshëm që sjell efekte juridike, si në marrëdhënien juridike objekt akuze, ashtu edhe në atë ku të interesuar të drejtpërdrejtë janë palët private. Për këtë arsye janë palët private që ndërtojnë marrëdhëniet e tyre në bazë të faktit të paligjshëm, që ka parakusht logjik një proces penal. Këto raporte, në bazë të konceptit normativ që i parashikon bashkë, ndërveprojnë në një proces të vetëm, duke respektuar garancitë procedurale themelore, karakteristikat përkatëse si dhe normat, të cilat krijojnë hapësirat e nevojshme juridike respektive, me gjithë dallimet që karakterizojnë disiplinat e ndryshme.

⁴ “*Ekstrakt*” Vendim unifikues nr. 284, datë 06. 10. 2000.

⁵ *Padia Civile në Procesin Penal Shqiptar*, Fehmi Abdiu, Botimet Pex 2003, fq. 46.

2. Natyra dytësore e padisë civile në raport me akuzën penale. Normat respektive për vënien në jetë të procesit janë të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale; ndërsa ato civile, me të cilat shprehet pretendimi i kërkesit, duhet të aplikohen për atë që nuk pengojnë procesin penal, si dhe mund të shërbejnë për një interpretim më të hollësishëm të instituteve të parashikuara në normat procedurale penale që lidhen me gjykimin e padisë civile në procesin penal. Në rast të kundërt, do të jemi përpara situatës juridike të parashikuar në nenin 62 paragrafi 3 të KPrP. që disponon se, me kërkesë të palëve ose kryesisht, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile, nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

2. Garancitë thelbësore procedurale penale dhe civile

Me ndërthurjen pjesore të të dyja disiplinave gjatë procesit ekzistojnë garanci procedurale për zhvillimin sa më të drejtë të gjyimit të çështjes dhe si rrjedhojë të dy procedimet nuk mund të ruajnë individualitetet që i karakterizojnë gjatë gjithë ekzistencës së procesit. Tipare të ndryshme të procesit krijojnë simbolikisht raportin midis procedimeve respektive. Në themel të detyrimit të gjyimit penal në raport me atë civil, paraqiten dy momente thelbësore që karakterizojnë në mënyrë të veçantë disiplinat përkatëse, që më konkretisht janë:

- parimi i prezumimit të pafajësisë;
- barra e provës.

Garantimi i parimit të prezumimit të pafajësisë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 30 të saj parashikon, se kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim të formës së prerë, i cili gjen shprehje dhe aplikim në nenin 4 të KPrP ku parashikohet, se i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Parimi i prezumimit të pafajësisë së të pandehurit është koncepti më i rëndësishëm dhe i aplikuar gjatë të gjithë procedimit penal, në çdo fazë dhe deri kur gjykata e apelit shprehet me vendim përfundimtar. Kjo është arsyeja që justifikon pasivitetin e personit që ka marrë cilësinë e të pandehurit, si dhe identifikon krijimin, zhvillimin dhe përfundimin e procedimit penal.

Kur gjykimi i padisë ka parakusht logjik procedural një proces penal, raporti ndërmjet dy disiplinave njihet gjatë procesit në funksion të gjyimit dhe drejtimin e procesit të drejtë e korrekte në përputhje me normat juridike substanciale dhe procedurale që vihen në dispozicion të palëve ndërgjyqës dhe gjykatës në dhënien e drejtësisë.

Në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile nuk është parashikuar shprehimisht se kush nga palët ndërgjyqës prezumohet i fajshëm ose i pafajshëm. Si rrjedhojë, mund të nxjerrim konkluzione nga mënyra se si është ndërtuar marrëdhënia procedurale civile në bazë të dispozitave të saj e shprehur në nenin 6 të KPrC i cili parashikon, se gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

Nga ky parim i prezumimit të pafajësisë buron rregulli i njohur i interpretimit të dyshimeve në favor të të pandehurit (*indubio pro reo*), sipas të cilit, kur faktet dhe rrethanat e çështjes lejojnë vlerësime dhe interpretime të ndryshme, duhet pranuar interpretimi më i favorshëm për të pandehurin, çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit, neni 4 i KPrP.⁶ Në procesin civil gjykata dyshimet nuk i interpreton në favor të asnjërës prej palëve, por ka detyrimin e dhënies së një vendimi sipas bindjes së saj të brendshme.

Si konkluzion, mund të themi se gjykata në interpretimin dhe zbatimin e normave juridike ruan parimet themelore të proceseve respektive në çdo fazë të procedimit si dhe në dhënien e vendimit.

Barra e provës. E lidhur ngushtësisht me parimin e prezumimit të pafajësisë është koncepti që mbështetet mbi detyrimin e palëve në proces për të provuar faktet që paraqiten gjatë shqyrtimit të padisë civile në procesin penal, pra barra e provës e cila i shoqëron palët dhe procedimin në të gjithë ekzistencën e tij, janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën [...] dhe përgjegjësinë civile (neni 150 KPrP).

Parimi i prezumimit të pafajësisë e çliron të pandehurin nga barra për të provuar pafajësinë e tij, i jep të drejtën të mos i përgjigjet akuzës dhe të mos mbajë përgjegjësi për deklaratimet që bën, të kërkojë nga organi procedues marrjen e provave që e shfaqësojnë dhe të mbrohet në çdo mënyrë të përshtatshme që lejohet me ligj⁷.

Gjykata gjatë procesit civil, edhe pse është e lidhur dhe e detyruar nga parimi i disponibilitetit të provës, në fushën e hetimit gjyqësor disponon disa pushtete, ku në disa raste mund t'i lejohen asaj për të dalë nga pasiguria në të cilat e kanë lënë provat e palës. Në procedimin penal parimi i disponibilitetit të provës vlen për organin procedues, e cila lidhet që me fazën e hetimeve paraprake dhe në çdo fazë të procesit, dhe më konkretisht barrën e provës në procesin penal e kanë prokurori, i dëmtuari akuzues ose paditësi civil.

Për sa i përket të dëmtuarit akuzues, disiplina procedurale penale nuk e parashikon taksativisht barrën e të provuarit, por prezumohet se është ai që disponon detyrimin për të provuar faktin e paligjshëm penal që përbën shkak për krijimin e padisë civile. Megjithatë, gjykata në çdo rast gjatë hetimit gjyqësor, si për akuzën penale ashtu edhe për padinë civile disponon të drejtën të kërkojë ose krijojë situata procedurale

⁶ Procedura Penale; *Komentar*; Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda; Tiranë 2003; fq. 55-56.

⁷ Po aty.

që i konsideron themelore në gjykim, për të formuar bindjen e saj të brendshme mbi faktet që janë objekt hetimi gjyqësor, në bazë të provave.

Prezantimi i provave të nevojshme në procesin penal, të cilat kanë efekt edhe për padinë civile, bëhet nga prokurori, për shkak të faktit të paligjshëm të prezumuar që formon objektin e hetimit gjyqësor si për çështjen penale ashtu edhe për atë civile, që nga ana tjetër përbëjnë elemente të përbashkëta procedurale për vërtetimin e tyre në gjykimin e padisë civile në procesin penal. Ky pozicion procedural nuk i pengon palët private që me iniciativën e tyre të kërkojnë dhe të paraqesin vetë prova për të ndihmuar hetimin gjyqësor.

Në procesin penal barrën e provës e ka prokurori ose i dëmtuari akuzues, ndërsa paditësi civil e mbështet pretendimin e tij mbi faktet penale dhe si rrjedhojë mund t'i kërkojë organit procedues marrjen e provave që mund të jenë të rëndësishme për hetimin gjyqësor të çështjes, i dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave (neni 58 KPrP, pika 2).

Nga ana tjetër, paditësi civil me iniciativë mund të paraqesë gjatë hetimit gjyqësor prova të cilat mbështesin pretendimet e tij, pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj⁸, si dhe të ndihmojë gjykatën në saktësimin e dëmit⁹.

Parimi i prezumimit të pafajësisë e çliron palën nga barra për të provuar pafajësinë e vet¹⁰. Kështu që mbi të pandehurin vlen parimi i mosveprimit gjatë procedimit për faktin e paligjshëm të prezumuar penal; ndërsa, për sa i përket efekteve të tij mbi padinë civile, i pandehuri ose i padituri civil mund të shfrytëzojnë parimin e fitimit procedural ose të mosveprimit të parimit të disponibilitetit të provës në drejtim të kundërt.

Një fakt mund të vërtetohet dhe në bazë të provave që nuk janë dhënë nga pala të cilës i rëndonte barra e vërtetimit të këtij fakti, por që gjenden në akte (sepse janë parashtruar nga prokurori, i dëmtuari akuzues ose paditësi civil)¹¹.

3. Juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal

Juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal është sfera e çështjeve civile, ku është parakusht një raport procedural penal, që në bazë të ligjit kanë të drejtë të shqyrtojnë gjykatat penale. Në nenin 61 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet, se ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.

⁸ Neni 12 i Kodit të Procedurës Civile.

⁹ Neni 395 i Kodit të Procedurës Penale.

¹⁰ Procedura Penale, *Komentar*, Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Tiranë 2003, fq. 55.

¹¹ *Procedura Civile*, Alban Brati, Botimet DUDAJ 2008, fq. 287-8.

Në juridiksionin e gjykatës ku është ngritur një çështje penale, dispozita përkatëse i lejon të dëmtuarit nga vepra penale të paraqesë pretendimin civil, në procesin penal në vijim të kësaj paraqitjeje i dëmtuari duhet të heqë dorë nga aktet në procesin civil, ndërkohë që gjyqtari penal parashikon edhe mbi shpenzimet e procedimit civil.

Heqja dorë nga aktet civile, nga njëra anë, vjen nga ekzistenca e juridiksionit civil në procesin penal; nga ana tjetër, lidh dy konsekuenca automatike që ligji i njeh padisë civile të të dëmtuarit nga vepra penale (ose trashëgimtarëve të tij) në krahasim të të pandehurit për kthimin dhe shpërblimin e dëmit.

Ekzistenca e funksionimit të juridiksionit civil brenda një procesi penal sjell pasojat juridike të rëndësishme për sa i përket "*përshtatshmërisë*" strukturës dhe funksionimit të gjykimit penal. Nga dispozita e mësipërme konstatojmë se juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal nuk është juridiksion i përgjithshëm, ku, siç mund të pretendohet, të përfshihen të gjitha marrëdhëniet juridike civile që përbejnë objekt të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën civile.

Qëllimi i parashikimit të juridiksionit civil në procesin penal është për thjeshtëzimin dhe shpejtësinë me të cilën gjykohet padia civile së bashku me aktet penale në një proces të vetëm të cilat janë të ndara në rendin juridik të shtetit dhe bashkimin e tyre në gjykimin penal të faktit të prezumuar të paligjshëm, dhe dhënien e një vendimi që shprehet edhe për kërkimin civil.

Duhet theksuar se juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal nuk është i detyrueshëm për gjykatën që të pranojë pretendimin civil, edhe në rast se padia është e bazuar, e cila shprehet në nenin 62 të KPrP ku parashikohet, se legjitimitimi i paditësit civil mund të bëhet nga organi i procedurës [...] si dhe në paragrafin e dytë shpreh, se me kërkesën e palëve ose kryesisht, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile, nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

Si përfundim mund të themi se juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal ka për objekt marrëdhënien juridike civile nga e cila lindin të drejta subjektive dhe interesa të ligjshme në favor të mbajtësit të saj, kur dëmi ekziston dhe lidhet në mënyrë ekzistenciale pjesore me veprën penale, për të cilën është parakusht logjik një proces penal.

3.1 Konkurrimi i juridiksioneve gjyqësore

Dy të drejta janë konkurrese kur janë të lidhura midis tyre nga pikëpamja funksionale në mënyrë që përmbushja e njërës prej tyre shuan edhe të drejtën tjetër. Në këtë mënyrë një rezultat praktik i caktuar mund të arrihet nëpërmjet realizimit dhe të drejtave të ndryshme, të cilat, megjithëse qëndrojnë të pavarura dhe të mbrojtura veç e veç, lejojnë që ky rezultat të arrihet vetëm një herë të vetme¹².

¹² *Procedura Civile*, Alban Brati, Botimet DUDAJ 2008, fq. 193.

Respektivisht, e drejta për të ngritur padi është e lidhur me detyrimin që përmbushja e saj i heq mundësinë disponuesit të të drejtës të realizojë për herë të dytë të drejtën e ushtrimit të juridiksionit për të njëjtën çështje. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës për të rivendosur të drejtën ose një interes të ligjshëm të cenuar ose të shkelur, është padia e cila individualizohet në tre elemente që shoqërojnë ekzistencën e saj, siç janë: objekti, shkaku dhe subjektet.

Në rastet kur çështja i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor civil në procesin penal, nuk mund të ekzistojë në të njëjtën kohë edhe në gjykatën kompetente civile. Kështu që, do të konsiderohet se kemi konkurrin të juridiksioneve në rast se prezantohen në procese të ndryshme padi me të tre elementet e njëjta.

Përmbajtja e njërës nga paditë në secilin proces respektiv, shuan mundësitë e ngritjes të së njëjtës padi në procesin tjetër, pasi rezultati i kërkuar mund të arrihet vetëm një herë të vetme. Në rast se padia rrëzohet në njërin proces, nuk mund të ngrihet më në asnjë proces tjetër, përveçse kur ndryshojnë elementet e padisë.

Nga rregulli i përgjithshëm evidentojmë edhe përjashtimet për këtë rast, kur identitetit të personave dhe objektit të padisë i korrespondojnë shkaqe të ndryshme (konkurrimi objektiv i padive) dhe si rrjedhojë ekzistenca e padisë në njërin nga proceset shuan edhe tjetrën, sepse mungon interesi për të ngritur padi, pra për të arritur për herë të dytë atë që është arritur nga padia e parë, duke qenë se ekzekutimi do të bëhet vetëm një herë¹³.

Në këtë rast padia civile nuk mund të ngrihet në të njëjtën kohë brenda juridiksionit gjyqësor civil në procesin penal dhe në gjykatën kompetente civile. Përkundrazi, rrëzimi i një padie nuk paragjykon dhe pengon ngritjen e padisë tjetër¹⁴.

Ndodh që subjekteve të ndryshme i takojnë padi të ndryshme, objektivisht të njëjta për nga shkaku dhe objekti (konkurrimi subjektiv i padive), pra si pasojë procedurale pranimit i njërës prej padive shuan paditë konkurruese¹⁵. Kështu që nuk mund të pranohen në juridiksionin gjyqësor civil në procesin penal dhe në gjykatën kompetente civile, sepse rezultati i arritur kënaq të gjithë të interesuarit e tjerë.

Megjithatë kjo teorikisht, pasi praktikisht dhe ligjërisht nuk mund të ndodhë, për shkak se në rastin e konkurrimit subjektiv, vendimi gjyqësor që do të jepet do të ketë efekte mbi të gjitha palët e ndryshme legjitimuese, pasi do të krijohet bashkëndërgjyqësi e detyrueshme sipas gërmës (a) të nenit 161 të KPrC¹⁶.

3.2 Përparësia e juridiksionit gjyqësor civil

Kodi i Procedurës Civile parashikon në nenin 36, se në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile [...]. Është gjykata civile ajo që zgjidh

¹³ *Procedura Civile*, Alban Brati, Botimet DUDAJ 2008, fq. 193.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ *Procedura Civile*, Alban Brati, Botimet DUDAJ 2008, fq. 194.

¹⁶ Po aty.

mosmarrëveshjet civile ndërmjet palëve private dhe në raste të veçanta kur ka ardhur një dëm që ka si parakusht logjik procedural një veprë penale kjo mosmarrëveshje zgjidhet nga gjykata penale, ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale [...] mund të ngrejë padi civile në procesin penal [...], neni 61 i KPrP.

Kodi i Procedurës Penale disponon një pjesë të juridiksionit gjyqësor civil për dëmin e shkaktuar nga vepra penale dhe i jep mundësinë të dëmtuarit nga situata e kundër-ligjshme penale të bëjë kërkimin civil në këtë proces. Kjo e dhënë juridike krijon mundësinë e ngritjes së padisë civile, si në gjykatën civile ashtu dhe në gjykatën penale, por, gjithsesi, nuk mund të ndodhë që padia civile të shqyrtohet në të njëjtën kohë nga të dyja gjykatat.

Ngritja e padisë civile në gjykatën civile ka disa avantazhe dhe përparësi në dallim nga ngritja e saj në procesin penal, dhe më konkretisht:

- nuk ekziston një afat për legjitimimin dhe paraqitjen e padisë civile në gjykatën civile, përveç rastit kur shuhet e drejta substanciale objekt gjykimi;
- nuk kërkohet pëlqimi i prokurorit për legjitimimin e paditësit civil;
- nuk është në diskrecion të gjykatës veçimi i padisë civile, për shkak se gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal;
- nuk kërkohet si parakusht logjik procedural ekzistenca e një raporti procedural penal;
- është mjeti kryesor dhe i vetëm procedural që vë në lëvizje pushtetin gjyqësor civil.

4. Ekskluziviteti i juridiksionit kushtetues

Në nenin 131 germa (a) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet, se Gjykata Kushtetuese vendos për, papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën [...], kjo është një normë që vendos kufizimin e pushtetit gjyqësor të gjykatave për kontrollin Kushtetues të dispozitave konkrete, ku bazohet gjykimi i çështjes në çdo fazë dhe shkallë të procedimit.

Secila nga palët ndërgjyqëse mund të pretendojë papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, dhe, në qoftë se pretendimi i ngritur mbi antikushtetutshmërinë e normës nuk është qartësisht i pabazuar (gjë që është lënë në çmim të gjyqtarit), gjyqtari nuk zbaton normën juridike, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese¹⁷, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, paragrafi 2 i nenit 142 i Kushtetutës së RSH.

Kur evidentohet se zbatimi i një norme penale për zgjidhjen e çështjes në gjykim. Në këtë rast, ato pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës

¹⁷ *Procedura Civile*, Alban Brati, Botimet DUDAJ 2008, fq. 67.

Kushtetuese, neni 145 paragrafi 2 i Kushtetutës së RSH. Gjatë shqyrtimit të padisë civile në procesin penal, çështja bëhet e ndërlikuar në lidhje me normën juridike, e cila bie në juridiksion ekskluziv të Gjykatës Kushtetuese, kështu që ekzistojnë dy aspekte që pushteti gjyqësor dërgon normën nën veprimin e juridiksionit ekskluziv të Gjykatës Kushtetuese:

- kur evidentohet se zbatimi i një norme penale për zgjidhjen e çështjes në gjykim ka papajtueshmëri me Kushtetutën;
- kur evidentohet se zbatimi i një norme civile për zgjidhjen e çështjes në gjykim ka papajtueshmëri me Kushtetutën.

Evidentimi i zbatimit të një norme penale për zgjidhjen e çështjes në gjykim ka papajtueshmëri me Kushtetutën. Gjatë procesit penal ku shqyrtohet edhe një pretendim civil, del që një normë, e cila ndikon ose nga e cila varet zgjidhja e çështjes, ka papajtueshmëri me Kushtetutën dhe nuk është qartësisht e pabazuar, gjyqtari pezullon gjykimin dhe ia dërgon aktet Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur mbi kushtetutshmërinë e kontestuar të normës juridike.

Në një moment të tillë procedural efektet e pezullimit të procesit penal do t'i shtrijnë pasojat edhe në procesin civil, që është krijuar autonom dhe i pavarur në brendësi të procesit penal. Gjyqtari kur vlerëson se duhet të pezullojë gjykimin penal, në mënyrë automatike pezullon edhe procesin civil, pasi ekzistenca e tij ka parakusht logjik një proces penal. Kjo situatë juridike procedurale nuk privon të drejtën e paditësit civil të ngrejë pretendimin e tij në gjykatën civile.

Evidentimi i zbatimit të një norme civile për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim ka papajtueshmëri me Kushtetutën. Kur gjatë shqyrtimit të padisë civile në procesin penal, evidentohet se një normë civile e cila përfshihet në zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile ka papajtueshmëri me Kushtetutën dhe nuk është qartësisht e pabazuar, gjyqtari, si rregull i përgjithshëm, pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur mbi kushtetutshmërinë e normës juridike civile të dhënë.

Përpara një situatë të tillë juridike, ekzistojnë dy zgjidhje të mundshme procedurale:

- gjyqtari pezullon procesin civil dhe vazhdon të shqyrtojë faktin penal objekt akuze, duke mos e ndërprerë procesin penal, derisa Gjykata Kushtetuese të shprehet mbi kushtetutshmërinë e kontestuar të normës juridike civile;
- gjyqtari pezullon procesin civil gjatë gjyimit penal dhe dërgon aktet në gjykatën kompetente civile.

5. Palët private në procesin penal

Palë private në procesin penal janë ato të cilat gjatë shqyrtimit të padisë civile, së bashku me aktet penale, kanë të drejta dhe detyrime mbi objektin e padisë, si rrjedhojë do të konsiderohen subjekte të procesit civil që ka parakusht logjik një procedim penal, [...] personat fizikë ose juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi, neni 90 i KPrC.

Pra, palë ndërgjyqës në procesin penal janë personat që nga njëra anë janë subjekte të akteve të palës, dhe nga ana tjetër, janë destinatarë të efekteve të vendimit të gjykatës. Palët janë subjekte të kundërta në dialektikën e procesit kundrejt të cilave gjykata, për definicion, është mbajtësja e një pushteti të paanshëm¹⁸.

Kompleksiteti i palëve ndërgjyqës gjatë shqyrtimit të padisë civile në procesin penal, bëhet i dukshëm nga aplikimi i normave penale nga njëra anë dhe ndërveprimi i palëve në një proces të vetëm penal nga ana tjetër, ku është ngritur një pretendim civil. Janë palët ato të cilët vënë në lëvizje pushtetin gjyqësor dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në juridiksionin gjyqësor civil në procesin penal.

Për këtë arsye subjektet, të cilët, në emër dhe kundër të cilëve do të zhvillohet gjykimi civil, do të pozicionohen në procesin penal në zbatim të normave juridike që parashikon ligji substancial dhe procedural civil për atë sa lejohen dhe nuk kundërshtohen me normat Procedurale Penale.

Në nenin 61 të KPrP parashikohet, se ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil [...], nga dispozitivi i dispozitës kuptohet që rrethi i subjekteve dhe mundësitë procedurale që mund të konstatohen gjatë shqyrtimit të padisë civile në procesin penal janë të shumta.

Kështu që, gjatë gjyimit të padisë civile në procesin penal, paditësi civil është pala, [...] që ka pësuar dëm material ose trashëgimtarët e tij [...], pra, ashtu si në procesin civil edhe në procesin penal, subjektet të cilët kanë një pretendim civil janë, persona fizikë, personat juridikë privat ose publik.

Ndërsa nga ana tjetër kërkimi civil bëhet konkretisht kundrejt palës tjetër, që, si rregull, është i pandehuri; por në raste të caktuara mund të ketë legjitimitet shkakësor për të vepruar personi civilisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga i pandehuri, sipas përgjegjësisë së prejardhur që parashikohet në dispozitat e Kodit Civil.

Ky moment evidentohet në nenin 61 të KPrP i cili shpreh, se [...] mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil [...], dhe si rrjedhojë subjekte kundër të cilëve ngrihet kërkimi civil dhe zhvillohet gjykimi janë persona fizikë (pavarësisht se vepra penale pretendohet të jetë kryer nga një person juridikë privat ose publik)¹⁹.

¹⁸ *Procedura Civile*, Alban Brati, Botimet DUDAJ 2008, fq. 104.

¹⁹ Kjo vjen në bazë të parimit "që përgjegjësia penale është përgjegjësi direkte, d.m.th. nga personat që ushtrojnë funksionet përkatëse.

Problemi i përcaktimit të kuptimit të palëve në shqyrtimit të padisë civile në procesin penal lind si pasojë e situatave juridike procedurale të dhëna ku fabrikimi i kërkimeve, prapësimeve dhe kundërshtimeve është i kufizuar nga mënyra e ndërtimit të fakteve dhe qëndrimit statik të tyre në proces vihet në lëvizje për aq sa procesi penal nuk pengohet.

Natyrisht subjekteve ndërgjyqës, në emër dhe kundër të cilëve zhvillohet gjykimi civil që ka parakusht logjik një proces penal, u intereson pjesërisht dënimi penal i të pandehurit, por vetëm për aq sa, në raport me pjesën civile merret në konsideratë dhe ndikon mbi të.

Interesi i paditësit civil për të ngritur padi është i dukshëm dhe i brendapërfshirë në dëmin material të shkaktuar, pasi është evidente shkelja e të drejtës dhe interesit të ligjshëm. Si rrjedhojë e interesit për të ngritur padi, vjen në një moment të dytë legjitimimi për të vepruar, që konsiston në përcaktimin e personit të cilit i përket interesi për të ngritur padi dhe kundër të cilit ngrihet padia.

Në raste të veçanta i legjitimuar (aktiv-pasiv) mund të jetë edhe Avokati i Shtetit, pa mohuar këtu edhe rolin e prokurorit, që ka disa kompetenca dhe detyra në lidhje me palët në proces. Këto situata juridike vlejné për të përcaktuar pozicionin e palëve ndërgjyqës në proces.

Pozicioni i palës private si ndërgjyqës fitohet:

- a. si pasojë e paraqitjes së padisë civile në procesin penal, (neni 58 dhe 61 i KPrP);
- b. si pasojë e ndërhyrjes ose thirrjes së personit të tretë nga palët gjatë zhvillimit të një procesi civil në procedimin penal (neni 65 dhe 66 i KPrP);
- c. si pasojë e zëvendësimit të palës gjatë gjykimit penal (neni 184 i KPrC);
- d. si pasojë e kalimit procedural gjatë gjykimit penal (neni 199 i KPrC).

Mënyrat e fillimit të pozicionit të palëve si ndërgjyqës duhet të konceptohen dhe trajtohen në kontekstin e shqyrtimit të padisë civile në procesin penal, si dhe të përshtaten me strukturën dhe normat juridike penale, ku rëndësia e parashikimit të ndikimit në veprime procedurale të tilla, të ndryshme nga pikëpamja e proceseve, të mos sjellin vështirësimin dhe zvarritjen e procesit penal.

Konkluzione

Prezantimi i padisë civile në procesin penal lidhet në mënyrë ekzistenciale të drejtëpërdrejtë me katër kushtet e procedimit, ku formimi funksional i tyre paraprin vlefshmërinë e procesit. Mungesa e njërit prej tyre e bën procesin të kontestueshëm në çdo gjëndje dhe shkallë të tij. Pretendimi civil në procesin penal vjen si pasojë logjike e katër kushteve të procedimit: Juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal; Kompetenca e gjykatës penale për shqyrtimin e padisë civile;

Palët private në procesin penal; Paragjykueshmëria (parimi i gjësë së gjykuar). Në paraqitjen e padisë civile në procesin penal të dy procedimet ruajnë karakteristikat e tyre të veçanta sipas dispozitave respektive që i rregullojnë, por për shkak të elementëve të përbashkët si palët, provat e nevojshme etj, bashkohen në një procedim të përbashkët, kështu që evidentojmë karakteristikat e padisë civile në procesin penal.

Me ndërthurjen pjesore të të dyja disiplinave gjatë procesit ekzistojnë garanci procedurale për zhvillimin sa më të drejtë të gjykimit të çështjes dhe si rrjedhojë të dy procedimet nuk mund të ruajnë individualitetet që i karakterizojnë gjatë gjithë ekzistencës së procesit. Tipare të ndryshme të procesit krijojnë simbolikisht raportin midis procedimeve respektive. Në themel të detyrimit të gjykimit penal në raport me atë civil, paraqiten dy momente thelbësore që karakterizojnë në mënyrë të veçantë disiplinat përkatëse, që më konkretisht janë: parimi i prezumimit të pafajësisë barra e provës.

Juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal është sfera e çështjeve civile, ku është parakusht një raport procedural penal, që në bazë të ligjit kanë të drejtë të shqyrtojnë gjykatat penale. Juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal nuk është juridiksion i përgjithshëm, ku, siç mund të pretendohet, të përfshihen të gjitha marrëdhëniet juridike civile që përbejnë objekt të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën civile. Juridiksioni gjyqësor civil në procesin penal ka për objekt marrëdhënien juridike civile nga e cila lindin të drejta subjektive dhe interesa të ligjshëm në favor të mbajtësit të saj, kur dëmi ekziston dhe lidhet në mënyrë ekzistenciale pjesore me veprën penale, për të cilën është parakusht logjik një proces penal.

Palë private në procesin penal janë ato të cilat gjatë shqyrtimit të padisë civile, së bashku me aktet penale, kanë të drejta dhe detyrime mbi objektin e padisë, si rrjedhojë do të konsiderohen subjekte të procesit civil që ka parakusht logjik një procedim penal. Subjektet, të cilët, në emër dhe kundër të cilëve do të zhvillohet gjykimi civil, do të pozicionohen në procesin penal në zbatim të normave juridike që parashikon ligji substancial dhe procedural civil për aq sa lejohen dhe nuk kundërshtohen me normat Procedurale Penale.

Literatura

- Abdiu Fehmi, 2001, *Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, Shtëpia Botuese Redona.
- Abdiu Fehmi, 2003, *Padia Civile në Procesin Penal Shqiptar*, Tiranë, Shtëpia Botuese Pex.
- Brati Alban, 2008, *Procedura Civile*, Tiranë, Shtëpia Botuese DUDAJ
- Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, 2003, *Procedura Penale; Komentar*, Tiranë, Shtëpia Botuese Morava.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2012, Tiranë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë 2012, Tiranë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
- Vendim Unifikues nr. 284, datë 06. 10. 2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

E drejta penale në mbrojtje të mjedisit

Doktorante Jonka Ceka

DOKTORANTE PRANË UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS, SI DHE ËSHTË NËPUNËSE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE.

Abstrakt

Artikulli trajton të drejtën penale mjedisore, që është një fushë e re brenda së drejtës penale. Rritja e kriminalitetit ndaj mjedisit dhe nevoja për bashkëpunim për t'iu përgjigjur atij, nisur edhe nga natyra ndërkuftare e dëmit mjedisor, ka sjellë evoluimin e legjislacionit penal mjedisor në Europë e më gjerë. Legjislacioni penal mjedisor në Shqipëri e ka bazën në Kodin Penal, i cili nuk i mbulon të gjitha kundërvajtjet penale në dëm të mjedisit. Edhe shkalla e zbatimit të legjislacionit penal mjedisor është e dobët, madje është fakt që shumë krime ndaj mjedisit përfundojnë në çështje civile apo administrative. Statistikat zyrtare të kundërvajtjeve penale dhe krimeve mjedisore të treguara, si shprehje e zbatimit të ligjit penal mjedisor në vendin tonë, tregojnë se ai është i dobët dhe i paaftë që t'i përgjigjet gjerësisë dhe amplitudës së dëmit që i shkaktohet mjedisit sot në vend. Përafrimi me legjislacionin europian të fushës dhe aderimi në konventën e Këshillit të Europës për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, rekomandohen si zgjidhje të mundshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rritjen e mundësive për zbatimin e ligjit në vendin tonë.

Fjalë kyç: Mbrojtje mjedisi, e drejtë mjedisi, krim mjedisor, ligj penal

Hyrje

Njeriu gjatë jetës së tij ndërvepron pareshur me mjedisin natyror. Me zhvillimin e shoqërisë dhe posaçërisht industrializimin e saj, dëmi që njeriu i shkaktonte natyrës, sa vjen dhe merr përmasa më të frikshme. Nisur nga rëndësia e këtij dëmi mjedisor, një pjesë e veprimtarisë që ushtrohet në kundërshtim me normat bazë të mbrojtjes së mjedisit është cilësuar me termin “krim mjedisor”. Ky term, pa pasur ende një përkufizim të pranuar universalisht, është përdorur gjerësisht qysh në

vitet '90 në terminologjinë sociologjike dhe kriminalistike, duke u “zyrtarizuar” dhe në një sërë aktesh ligjore ndërkombëtare¹.

Dëmet mjedisore sot, lëndojnë më shumë njerëz sesa krimi i rrugës në bazë ditore dhe vjetore, ndërsa humbjet financiare të shkaktuara nga këto dëme janë të jashtëzakonshme². Natyra kriminale e disa prej këtyre dëmeve të rënda mjedisore shkaktoi një shqetësim të madh publik, i cili solli kriminalizimin e shkeljeve të rënda ndaj mjedisit, duke krijuar një fushë të specializuar brenda sistemit të së drejtës penale, pra të drejtën penale mjedisore.

E drejta penale mjedisore synon të luftojë krimin mjedisor që lidhet me veprime që dëmtojnë jetën e njeriut, apo cilësinë e ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve, etj. Gjithashtu, ajo synon të dënojë veprimet që kryhen në shkelje të legjislacionit përkatës, të vendosur nga një autoritet kompetent në mbrojtje të mjedisit. Specialistët e fushës vënë në dukje se ekziston një dallim thelbësor midis të drejtës penale tradicionale dhe fushës së re të së drejtës penale mjedisore; ndërsa kriminaliteti tradicional përbën kërcënim për stabilitetin shoqëror, krimi mjedisor përbën kërcënim për vetë ekzistencën e qenieve njerëzore³.

Krime mjedisore konsiderohen veprime të cilat shkelin ligjin mjedisor dhe shkaktojnë dëm të konsiderueshëm ndaj mjedisit dhe njeriut, ose i vënë në rrezik ata. Format më të njohura të krimi mjedisor janë emetimet ilegale ose shkarkimi i substancave në ajër, ujë ose tokë; tregtia e paligjshme e specieve të mbrojtura; transporti dhe hedhja e jashtëligjshme e mbeturinave; dhe tregtia e paligjshme e substancave ozon-holluese⁴.

Krimi mjedisor është ndër fushat me zhvillime shumë dinamike, si në llojshmërinë e veprave, ashtu dhe në kompleksitetin e tyre. Krimi mjedisor është dhe duhet trajtuar si çdo krim tjetër, ai është pasojë e zhvillimit ekonomik, social dhe industrial⁵.

Në vendet me juridiksionet e ligjit civil, ligji administrativ ende luan një rol thelbësor në përcaktimin e veprave penale mjedisore. Ndaj një sjellje e konsideruar me rrezik ndaj mjedisit, mund të jetë subjekt i rregullave ligjore administrative, por edhe i ligjeve penale. Përdorimi i këtyre dy grupeve të normave ligjore që shpesh mbivendosen, ndodh pasi në të shkuarën shkeljet mjedisore trajtoheshin vetëm si shkelje administrative⁶.

1. E drejta penale europiane për mbrojtjen e mjedisit

Komuniteti europian nëpërmjet legjislacionit të tij primar dhe sekondar siguron mbrojtje të mjedisit, sipas fushave të ndryshme, në mënyrë direkte apo indirekte.

¹ White, R. (Ed.). (2009). “Environmental Crime: A Reader”. Devon: Willan Publishing.

² *Ibid.*

³ REC (Ed.). (2012). “Mjedisi sot”. Nr. 134, pp.7-16

⁴ CIEL. (n.d.). Marrë nga <http://www.ciel.org/Publications/pubhre.html>.

⁵ White, R. (Ed.). (2009). “Environmental Crime: A Reader”. Devon: Willan Publishing.

⁶ REC (Ed.). (2012). “Mjedisi sot”. Nr. 134, pp.7-16

Përveç kësaj mbrojtjeje tematike, në KE është zhvilluar edhe legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit përmes së drejtës penale, e cila është zhvilluar më vonë sesa ajo sipas fushave të veçanta mjedisore⁷

Çështja e krimit mjedisor është diskutuar në shumë forume ndërkombëtare dhe europiane për një kohë të gjatë. Idetë e para të mbrojtjes së mjedisit me ligj penal janë hedhur në Europë në Konferencën e 7^{te} të Ministrave Europeanë të Drejtësisë, në Bazel, më 1972. Më vonë (1977), Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës miratoi rezolutën (77) 28 “Mbi kontributin e ligjit penal në mbrojtjen e mjedisit”. Kjo rezolutë, u rekomandon qeverive të shteteve anëtare të marrin masa për “shqyrtimin e shkeljeve kriminale për dëmtimin e mjedisit”, shqyrtimin e përvojës së veprimeve dhe mosveprimeve kriminale që qëllimisht ose me neglizhencë të theksuar u shkaktojnë dëm jetës, shëndetit të njerëzve ose pasurisë, rishqyrtimin e principeve të përgjegjësisë penale me qëllim futjen e përgjegjësisë publike, private dhe të korporatave. Kjo rezolutë parashikon marrjen e masave të tilla për subjektet përgjegjëse si gjobat në para, rikthim i mjedisit në gjendjen e mëparshme, punë në dobi të komunitetit, etj, pra materializon principin e njohur mjedisor “*ndotësi paguan*”. Një rekomandim i rezolutës është edhe rishikimi i procedurës penale për çështjet e mbrojtjes së mjedisit, sikurse është krijimi i sektorëve të specializuar në gjykata dhe prokurori për t’u marrë me çështjet e mjedisit. Edhe përfaqësimi i komunitetit dhe mbrojtja e interesave të tij gjatë procedimit penal, gjen vend në këtë rezolutë. Po kështu, rezoluta thekson avantazhet që mund të kenë vendet anëtare nga konsolidimi në nivel kombëtar, si p.sh, nëpërmjet kodifikimit të të gjithë legjislacionit të mjedisit dhe një harmonizimi të ardhshëm të legjislacionit të shteteve anëtare të Këshillit të Europës në këtë fushë⁸.

Më 1998, u nënshkrua në Strasburg Konventa e Këshillit të Europës për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, e cila pati për qëllim përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel europian, duke përdorur si zgjidhje të fundit ligjin penal, me qëllim pengimin dhe parandalimin e sjelljeve më të dëmshme ndaj tij⁹. Qëllimi i kësaj konvente ishte gjithashtu harmonizimi i legjislacionit kombëtar në këtë fushë i vendeve pjesëmarrëse në konventë. Ky instrument ligjor i detyron Shtetet Kontraktuese të parashikojnë dispozita të veçanta në ligjin e tyre penal apo të modifikojnë dispozitat ekzistuese në këtë fushë. Ai përcakton si vepra penale një numër veprimesh të kryera me dashje ose nga pakujdesia e theksuar, që shkaktojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë të njeriut, apo ka të ngjarë të shkaktojnë dëme mbetëse në cilësinë e ajrit, të tokës, ujit, kafshëve ose bimëve.

Kjo konventë përcakton konceptin e përgjegjësisë penale të personave fizikë dhe juridikë, masat që duhet të miratohen nga shtetet për të mundësuar konfiskimin e pasurisë dhe përcaktimin e kompetencave të autoriteteve, si dhe shtron rrugën për bashkëpunim ndërkombëtar. Edhe në këtë konventë, masat përfshijnë burgim dhe sanksione mbi pasurinë, dhe mund të përfshijnë rikthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme. Një dispozitë e rëndësishme parashikon mundësinë e shoqatave të mbrojtjes së mjedisit për të marrë pjesë në procedurën penale lidhur me shkeljet e parashikuara në Konventë.

Vendi ynë, ndonëse anëtar i Këshillit të Europës qysh në vitin 1995, ende nuk ka ndërmarrë ndonjë hap për t’u bërë palë e kësaj konvente.

Krimet mjedisore shkaktojnë sot në Europë dhe në Botë një dëm të konsiderueshëm. E drejta europiane mjedisore ekziston tashmë prej mëse 30 vjetësh dhe janë në fuqi më shumë se 200 direktiva në fushën mjedisore, pa përmendur këtu aktet normative dytësore europiane. Zhvillimet në këtë fushë, apo më saktë rritja e ndërgjegjësimit për një mbrojtje më të efektshme dhe të integruar në nivel europian, çoi në hartimin dhe miratimin e një direktive për ndëshkimin penal të shkeljeve në fushën mjedisore. Gjithashtu, shpesh krimi mjedisor ka efekt ndërkuftar, pra, nuk mbetet i kufizuar në një shtet të vetëm. Kjo ishte një arsye më shumë që krimi mjedisor të trajtohej nga e drejta europiane me anë të një direktive të posaçme.

Qysh në vitin 2001, u hodh propozimi për një direktivë të Parlamentit European dhe Këshillit të Bashkimit European, për një mbrojtje më të garantuar të mjedisit përmes legjislacionit penal¹⁰. Rastet që sugjeroheshin për t’u dënuar me sanksione penale ishin: derdhja e naftës në ujëra, shpërndarja e substancave të rrezikshme në ajër apo tokë, transportimi e ruajtja e mbeturinave të rrezikshme, hedhja e mbeturinave në vende jo të përshtatshme për trajtimin e tyre, tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër, dhe dëmtimi i habitateve të mbrojtura. Direktiva në fjalë (2008/99/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit, të 19 nëntorit 2008, mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal) u miratua në fund të vitit 2008 nga Komisioni European dhe hyri në fuqi në vitin 2009. Një ndikim pozitiv për hartimin dhe miratimin e kësaj direktive ka pasur edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë, e cila gjatë gjykimeve dhe vendimeve të saj me fokus mjedisin, e ka shtrirë kompetencën e Bashkimit European edhe në fushën e së drejtës penale. Ky qëndrim i Gjykatës Europiane të Drejtësisë është mbështetur më pas nga Këshilli dhe Parlamenti European që hartuan tekstin e direktivës së sipërpërmendur. Kjo direktivë parashikon përfshirjen e saj në legjislacionin e shteteve anëtare deri në fund të vitit 2010. Direktiva 2008/99/EC, erdhi si rezultat i shqetësimit komunitar lidhur me shtimin e shkeljeve mjedisore, si dhe pasojave negative që ato sjellin, jo vetëm brenda

¹⁰ EU environmental law (E Drejta e Mjedisit e BE-së). (n.d.). Marrë nga http://ec.europa.eu/environment/index_en.htm.

⁷ EU environmental law (E Drejta e Mjedisit e BE-së). (n.d.). Marrë nga http://ec.europa.eu/environment/index_en.htm.

⁸ Resolution (77) 28 of the Council of Europe. “On the contribution of criminal law to the protection of the environment”. (1977). Marrë nga <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=594976&SecMode=1&DocId=659224&Usage=2>

⁹ Konventa e Këshillit të Europës “Mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet së drejtës penale”, (1998). Marrë nga <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/172.htm>.

kufijve të shtetit ku konsumohet një shkelje konkrete¹¹. Çdo krim ndaj mjedisit duhet të marrë përgjigjen e duhur, dënimin penal, dhe kjo direktivë synon të japë përgjigjen dhe bazën e duhur për këtë gjë. Dënimet që jepen në vendet anëtare për shkeljet mjedisore europiane janë shumë të ndryshme. Direktiva u kërkon shteteve anëtare që të marrin masa shtrënguese e mbrojtëse edhe me të mëdha sesa ato që parashikon direktiva, dhe ndëshkimi në çdo rast të jetë proporcional, efektiv dhe bindës. Pra, dënimet duhet të shërbejnë për parandalimin në të ardhmen të të njëjtave shkelje dhe dënimi penal përkatës të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar. Këto dënime zbatohen jo vetëm për personat e dënuar për shkelje të legjislacionit komunitar, por edhe për ata që janë nxitës, ndihmues apo bashkëpunues të këtyre veprimeve të dënueshme. Për dëmtime të rënda të mjedisit, masa e dënimit mund të jetë edhe burgim. Efektiviteti i kësaj direktive varet tërësisht nga shkalla e zbatimit të saj në nivel kombëtar. Kështu, çdo shtet ka mundësinë të gjejë mënyrën më të përshtatshme për të realizuar ndëshkimin penal për raste shkeljesh mjedisore që kategorizohen si vepra penale. Shtetet anëtare, në zbatim të kësaj direktive, priten të përfshijnë në legjislacion dhe dënimet përkatëse si për personat fizikë, ashtu dhe ata juridikë, ku dënimet të jenë jo vetëm gjopa, por edhe mos kualifikim për përfitime publike, pezullim i përkohshëm ose ndalim i përhershëm për të ushtruar veprimtari biznesi. Shtetet anëtare duhet të raportojnë çdo tre vjet lidhur me zbatimin e Direktivës para Komisionit. Ndërsa ky i fundit duhet të raportojë para Këshillit dhe Parlamentit European¹².

2. E drejta penale shqiptare për mbrojtjen e mjedisit

Në legjislacionin shqiptar në fushën e mjedisit ekzistojnë dy lloje shkeljesh penale: kundërvajtje dhe krim. E njëjta figurë e veprës penale mjedisore klasifikohet si krim, kur pasojat që shkaktohen për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin në tërësi janë të rënda dhe që zgjasin në kohë. Këto pasoja mbeten për t'u provuar dhe vlerësuar gjatë gjykimit, me qëllim që i akuzuari për veprën penale përkatëse të marrë një dënim më të rëndë sesa për kundërvajtjen administrative. Diapazoni i ndëshkimit sipas legjislacionit shqiptar për shkeljet penale mund të jetë gjobë ose burgim nga 3 muaj deri në prej 15 vjet¹³. Për shkelje të lehta mjedisore, sikurse janë kundërvajtjet administrative, dënimet e parashikuara janë administrative dhe rregullohen nga legjislacioni përkatës mjedisor.

¹¹ Directive 2008/99/EC of the European Parliament and of the Council, "On the protection of the environment through criminal law". (2008). Marrë nga <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:328:0028:0037:EN:PDF>

¹² *Ibid.*

¹³ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë: QPZ.

Kodi Penal shqiptar u kushton një kapitull të veçantë (Kreun IV) akteve të dënueshme ndaj mjedisit. Veprat e ndryshme penale kundër mjedisit parashikohen në nenet 201-207¹⁴.

Këto vepra penale mjedisore të parashikuara nga Kodi Penal, duket se mbulojnë një spektër të gjerë problemesh mjedisore. Por, nëse krahasojmë përmbajtjen e neneve të Kodit Penal shqiptar me parashikimet e Direktivës 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit me anë të së drejtës penale, shohim se veprimet apo mosveprimet me pasojë dëmtimin e mjedisit të parashikuara në direktivë, janë më të shumta dhe më të plota se figurat e veprave penale të parashikuara në legjislacionin tonë.

Bie në sy fakti se në Kodin Penal shqiptar nuk parashikohet ndotja e tokës¹⁵. Dispozita që e trajton tokën, por që lidhet kryesisht me shpërdorimin e saj, është Neni 199. Si shpërdorim cilësohet p.sh. rasti i ndërrimit të destinacionit të tokës bujqësore në industriale, pa ndjekur më parë procedurat e studimeve dhe lejeve përkatëse, ose ndërtimet e paligjshme në zonat bregdetare. Këto shpërdorime ndikojnë indirekt edhe në ndotjen e tokës, por nuk përbëjnë formën klasike të ndikimit të aktivitetit njerëzor mbi cilësinë e saj.

Po kështu në Kodin Penal shqiptar mungojnë parashikime për shkelje të kryera në kuadër të: menaxhimit dhe transportit të mjetëve, funksionimit të një impianti industrial në të cilin kryhet aktivitet i rrezikshëm, ose shkelje si: abuzim me speciet e mbrojtura të florës dhe faunës, përkeqësim habitati, përdorim, prodhim, tregtim, etj., i substancave ozon-holluese dhe shkaktimi i zhurmës në shkelje të ligjit.

Këto mangësi mund të justifikohen pjesërisht për shkak të kohës së hartimit të Kodit Penal shqiptar në vitin 1995, ndërkohë që Direktiva i përket vitit 2008, dhe për shkak të faktit se shkelje të tjera të legjislacionit mjedisor shqiptar janë të natyrës administrative, duke u parashikuar në ligje sektoriale dhe duke u dënuar me sanksione administrative, që janë më të lehta sesa ato penale.

3. Zbatimi i legjislacionit mjedisor penal shqiptar

Por le të shohim në ç'masë zbatohet legjislacioni penal shqiptar për shkeljet ndaj mjedisit. Në bazë të të dhënave nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, numri i kundërvajtjeve penale të kallëzuara gjatë pesë vjetëve (2005 deri më 2009) është 1714, me një mesatare prej 342 çështjesh në vit¹⁶. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë jep shifra gati dy herë më të ulëta. Shkak i kësaj mospërputhjeje midis burimeve të së njëjtës administratë mund të jetë fakti se një pjesë e çështjeve të kallëzuara nuk kanë arritur të gjykohen për shkak të mos-sigurimit të provave, ose mungesës së përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit në tërësi.

¹⁴ *Ibid.*

¹⁵ REC (Ed.). (2012). "Mjedisi sot". Nr. 134, pp.7-16.

¹⁶ Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave – informacione nga dokumentet strategjike dhe buletinet mjedisore. (n.d.). Marrë nga <http://www.moe.gov.al>

Numri i procedimeve për kundërvajtje penale për dëm ndaj mjedisit mbetet shumë i vogël krahasuar me vepra të tjera. Ky numër i ulët i shkeljeve e i kundërvajtjeve penale ndaj mjedisit vjen ndër të tjera si rezultat i një mos ndarjeje të saktë në ligjin material të kundërvajtjeve administrative dhe atyre penale¹⁷. Nga ana tjetër, nuk ka sanksione në Kodin Penal për kundërvajtjet penale, ndaj lind nevoja e vendosjes dhe forcimit të tyre. Ndërkohë që kanë kaluar 18 vjet nga hyrja në fuqi e Kodit të Ri Penal, me përjashtim të prerjes së paligjshme të pyjeve, nuk është konstatuar llojshmëri domethënëse rastesh të cilësuar si krime mjedisore.

Sidoqoftë, qysh nga viti 2008 është vënë re një tendencë në rritje e procedimeve për kundërvajtje penale në dëm ndaj mjedisit. Në këto vite janë vënë re edhe procedime për kryerje të kundërvajtjeve penale si: për ndotjen e ajrit nga aktivitetet prodhuese, për shfrytëzimin ilegal të inertëve lumorë, apo zjarrvënien e qëllimshme në pyje¹⁸. Ndërsa ka një numër në rritje të shkeljeve të tipit kundërvajtje penale ndaj mjedisit të gjykuara në vitet e fundit, ky numër është shumë i ulët për të gjithë vitet së bashku për krimet ndaj mjedisit, pra shumë pak vepra penale janë konsideruar të shkaktojnë pasoja të rënda për jetën, shëndetin e njerëzve dhe mjedisin në tërësi.

Gjithashtu, nuk mund të ketë krim mjedisor të pashoqëruar me krime të tjera, të cilat përbëjnë vepra penale paralele. Këto mund të jenë: shpërdorim i detyrës, ushtrim i ndikimit të paligjshëm, korrupsion aktiv ose pasiv, etj¹⁹. Një pjesë e veprave mund të jenë mbuluar nga dispozita të tjera të Kodit Penal, ndaj nuk figurojnë të jenë shqyrtuar si krime mjedisore.

Niveli aktual i krimit mjedisor në vendin tonë nuk është i ulët. Le të përmendim ndotjen që shkaktohet nga impiantet e mëdha industriale, si ato metalurgjike apo të çimentos, që nuk mund ta justifikojnë ndotjen që shkaktojnë, ndonëse operojnë të lejuar nga shteti. Problemi këtu fillon që me lejimin e këtyre aktiviteteve industriale pranë zonave me popullsi të dendur dhe vijon me lejimin e emetimeve që nuk përmbushin standardet.

Përgjegjësia bie mbi organet shtetërore që janë të ngarkuar me ligj të mbrojnë mjedisin duke zbatuar tërësinë e legjislacionit mjedisor, duke filluar që nga Kushtetuta e Shqipërisë, e cila parashikon mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarit. Çdo shkelje e qëllimshme e ligjit, çdo abuzim në detyrë, jo vetëm që shkakton një dëm ndaj mjedisit dhe qytetarëve, por përbën një vepër të mundshme penale që duhet të ndiqet nga Prokuroria. Këtu paraqitet nevoja e njohjes më të mirë të ligjit mjedisor nga oficerët e policisë gjyqësore, gjyqtarët dhe prokurorët.

¹⁷ Ministria e Drejtësisë – informacione nga dokumentet statistikore. (n.d.). Marrë nga <http://www.justice.gov.al>.

¹⁸ REC (Ed.). (2012). "Mjedisi sot". Nr. 134, pp.7-16.

¹⁹ *Ibid.*

4. Nevojat për përmirësime në legjislacionin penal shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Në legjislacionin shqiptar lipset të bëhet një përmirësim në drejtim të garantimit të mbrojtjes civile, administrative dhe penale të mjedisit, si dhe mbulimit tërësor dhe harmonik të spektrit të së drejtës mjedisore nga ky legjislacion. Dënimet e parashikuara për disa vepra, si prerja e paligjshme e pyjeve, ndotja e ujit dhe ajrit, peshkimi i ndaluar, janë shumë të ulëta, duke u cilësuar si kundërvajtje penale (përsa kohë nuk janë shkaktuar dëme në njerëz), ndërkohë që dëmet që shkaktojnë mund të jenë të mëdha dhe me pasoja në kohë. Përgjegjësia penale, sikurse edhe në legjislacionin evropian, nuk duhet të lidhet vetëm me pasojat aktuale në jetën dhe shëndetin e njerëzve, por edhe me dëmtimin e shtrirë në kohë mbi jetën e njerëzve apo ekosistemet natyrore.

Futja e ligjit të ri të mbetjeve në vendin tonë, që parashikon edhe importimin e tyre (Nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"), sjell nevojën e parashikimit të veprave penale konkrete në Kodin Penal, që lidhen me shkeljen e rregullave të transportimit dhe menaxhimit në tërësi të mbetjeve²⁰.

Në lidhje me fushën e ndërtimit, apo shfrytëzimit të pyjeve, Kodi Penal nuk parashikon vepra specifike që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe respektimin e legjislacionit mjedisor në fuqi, në këto fusha nga ana e punonjësve. Ky kod parashikon vetëm veprën penale "shpërdorim i detyrës", (neni 248). Kjo vepër është e përgjithshme dhe shpesh është e vështirë që me provat që ofrohen subjekti të bëhet përgjegjës penalisht. Çështje të tilla shpesh pushohen, me arsyetimin që të zgjidhen si çështje civile ose administrative.

Si "shpërdorim i detyrës" duhet të kategorizohet edhe dhënia e lejeve të shfrytëzimit të burimeve tona natyrore nga punonjës publikë, në kundërshtim me ligjin. Këto veprime i sjellin një dëm të pallogaritshëm mjedisit tonë sot. Shpesh përgjegjësia në raste të tilla është e vështirë të dalë në kuadër të shpërdorimit të detyrës, veçanërisht kur kemi të bëjmë me organe kolegjiale, ku përgjegjësia duke u ndarë shmanget. Për të mos e lejuar këtë, në Kodin Penal duhen futur vepra të posaçme, ose të shtohen paragrafë që cilësojnë rrethanën, duke parashikuar përgjegjësinë e punonjësve publikë për moszbatimin apo shkeljen e ligjit në veprimtarinë e tyre. Kjo përgjegjësi penale duhet të parashikohet si paragraf më vete në secilën nga veprat kundër mjedisit të parashikuar në Kodin Penal, të tilla si mbrojtja e tokës, ujit, pyjeve, monumenteve, etj.

Në mënyrë që legjislacioni aktual në vend, lidhur me çështjet e krimit mjedisor të zbatohet më mirë, ka nevojë për forcim të bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse si Gjyqësori, Prokuroria, Ministria e Mjedisit. Ky bashkëpunim do të sillte përmirësim të procedurave gjyqësore, pasi do të rriste nivelin e ekspertizës mjedisore në procedime, duke ndikuar njëherazi në përmirësimin e imazhit të sistemit gjyqësor.

²⁰ *Ibid.*

Ndërsa, mangësitë në legjislacionin penal shqiptar për mbrojtjen e mjedisit mund të eliminohen nëpërmjet transpozimit të Direktivën Europiane 2008/99/EC, dhe/ose duke u bërë palë e Konventës “Mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet së drejtës penale”, të vitit 1998.

Përfundime

Rritja e dëmit mjedisor sot në botë dhe natyra kriminale e disa prej shkeljeve mjedisore, solli nevojën e kriminalizimit të tyre, duke sjellë krijimin e së drejtës penale mjedisore. E drejta penale mjedisore synon të luftojë krimin mjedisor që lidhet me veprime që dëmtojnë jetën e njeriut, apo cilësinë e ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve.

Në Komunitetin Europian, përveç mbrojtjes tematike mjedisore që realizohet nëpërmjet legjislacionit sektorial, është zhvilluar edhe legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit përmes së drejtës penale. Direktiva 2008/99/EC mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, është shprehje e shqetësimit komunitar lidhur me shtimin e shkeljeve mjedisore, si dhe pasojat negative të tyre, që shpesh i kalojnë kufijtë e shtetit ku konsumohet shkelja.

Në Shqipëri, ligji penal mjedisor nuk është zhvilluar me të njëjtin ritëm si legjislacioni mjedisor në tërësi, nuk i përgjigjet realitetit të kriminalitetit ndaj mjedisit dhe ka nevojë të përafrohet me direktivën e lartpërmendur. Shkeljet e rënda ndaj mjedisit mbulohen nga Kodi Penal, i cili në Kreun e IV-t të tij, parashikon vepra të ndryshme penale mjedisore. Një krahasim i tyre me parashikimet e Direktivës 2008/99/EC, tregon që spektri i mbuluar nuk është i plotë.

Ligji penal mjedisor në Shqipëri ka dy nevoja imperative:

Së pari, të zbatohet më mirë. Kjo do të kërkonte një sensibilizim më të madh ndaj çështjes së mjedisit në tërësi. Nga ana teknike, nevojitet një njohje e mirë e ligjit specifik mjedisor nga Gjyqësori dhe Prokuroria. Për këtë, bashkëpunimi midis strukturave shtetërore që merren me mjedisin dhe gjyqësorit merr rëndësi të veçantë.

Së dyti, të përafrohet me legjislacionin europian. Kjo do të bënte të mundur adoptimin e parimit “*ndotësi paguan*”, që qëndron në thelb të legjislacionit europian sot. Një legjislacion i përafuar do të krijonte bazën për ngritjen e strukturave të specializuara për parandalimin dhe denoncimin e veprave penale mjedisore, por edhe (sikurse rekomandohet në rezolutën (77) 28) sektorëve të specializuar në gjykata dhe prokurori për t’u marrë me çështjet e mjedisit, apo strukturave të posaçme pranë organeve të zbatimit të ligjit për ndjekjen e krimit mjedisor. Përfaqësimi i komunitetit, me qëllim mbrojtjen e interesave të tij gjatë procedimit penal mjedisor është një tjetër kusht që do të përmbushte një legjislacion i përafuar.

Një legjislacion penal mjedisor i përafuar dhe që do të zbatohet më mirë, do të rriste numrin e procedimeve të kundërvajtjeve penale në dëm të mjedisit, si dhe, **çështë më e rëndësishmja**, e krimeve ndaj tij. Përgjegjësia penale nuk do të degradonte në civile apo administrative dhe do të lidhej vetëm me pasojat e momentin, por me dëmin e shtrirë në kohë ndaj mjedisit dhe shoqërisë.

Bibliografia

- Center for International Environmental Law – publications. (n.d.). Marrë nga <http://www.ciel.org/Publications/pubhre.html>.
- Directive 2008/99/EC of the European Parliament and of the Council, “On the protection of the environment through criminal law”. (2008). Marrë nga <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:328:0028:0037:EN:PDF>
- EU environmental law (E Drejta e Mjedisit e BE-së). (n.d.). Marrë nga http://ec.europa.eu/environment/index_en.htm.
- Guri, S., Guri, M. & Koçi K. (2010). “E drejta mjedisore: Bazat e legjislacionit krahasimor mjedisor shqiptar dhe evropian”, Tiranë: Marin Barleti.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligj Nr. 7895, datë 27.01.1995. Tiranë: QPZ (2004).
- Konventa e Këshillit të Europës “Mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet së drejtës penale”, (1998). Marrë nga <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/172.htm>.
- Ligj Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Tiranë: QPZ. (2011). Fletorja zyrtare Nr. 148.
- Ligj Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Marrë nga <http://www.moe.gov.al/upload/legjislacioni/akte%20ligjore/Ligj%20Nr%2010463,%20per%20Menaxhimin%20e%20integruar%20te%20mbetjeve.pdf>
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave – informacione nga dokumentet strategjike dhe buletinet mjedisore. (n.d.). Marrë nga <http://www.moe.gov.al>.
- Ministria e Drejtësisë – informacione nga dokumentet statistikore. Marrë nga <http://www.justice.gov.al>.
- REC (Ed.). (2012). “Mjedisi sot”. Nr. 134, pp.7-16.
- Resolution (77) 28 of the Council of Europe. “On the contribution of criminal law to the protection of the environment”. (1977). Marrë nga <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=594976&SecMode=1&DocId=659224&Usage=2>
- White, R. (Ed.). (2009). “Environmental Crime: A Reader”. Devon: Willan Publishing.

Gjykata Ndërkombëtare Penale; Raporti i saj me sovranitetin shtetëror

Kejsi Rizo

Abstrakti

Krijimi i një juridiksioni penal ndërkombëtar që do të vinte përpara përgjegjësisë personat që kryenin krime të rënda në emër të shtetit të cilin drejtonin u kthye në një domosdoshmëri veçanërisht në fundin e LIIB pasojat e të cilës ishin të tmerrshme për njerëzimin. Krijimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale në këto kushte solli një revolucion jo vetëm nga pikëpamja historike por edhe nga ajo e së drejtës ndërkombëtare duke konfirmuar përfundimisht si subjekt individin. Megjithatë, edhe pse një domosdoshmëri e kohës, krijimi i juridiksionit ndërkombëtar penal solli lindjen e një pyetje shumë të madhe: mos ndoshta kjo do të cënonte të drejtën e shteteve për të ushtruar ata vetë ndjekjen penale, duke rënë në këtë mënyrë ndesh me sovranitetin e tyre? A do të duhet shtetet të sakrifikojnë nga sovraniteti i tyre në emër të sigurisë së përbashkët?

Fjalë kyçe: Gjykata Ndërkombëtare Penale; sovraniteti shtetëror; subjektet e së drejtës ndërkombëtare.

Gjykata Ndërkombëtare Penale (GJNP) u themelua nga Konferenca Diplomatike e organizuar nga OKB në Romë, në verën e vitit 1998. Në përfundim të punimeve të saj, më 17 Korrik 1998, u miratua Statuti i GJNP, i cili njihet me emrin *Statuti i Romës*. Ai ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2002. Themelimi i saj kurorëzon përpjekjet e vazhdueshme për krijimin e një mekanizmi me juridiksion penal ndërkombëtar të përhershëm. Qëllimi i krijimit është hetimi, gjykimi dhe dënimi i personave që kryejnë *vepra penale ndërkombëtare* të tilla si

genocid¹, krime kundër njerëzimit², krime të luftës³ dhe krime të agresionit⁴. Ky mekanizëm ndërkombëtar origjinal ka në qendër të veprimtarisë një subjekt që është i tillë si në të drejtën e brendshme ashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare: individin. Ai, si rregull, gjykohet nga gjykatat e shtetit shtetësinë e të cilit mban. Në funksion të këtij parimi ka lindur dhe instituti i ekstradimit. Në rastin e GJNP kemi një përjashtim nga rregulli: një juridiksion ndërkombëtar që gjykon dhe jo një gjykatë e zakonshme e një shteti apo një tjetër. Rrjedhimisht, ka lindur dilema nëse ka përplasje mes juridiksionit të GJNP dhe atij të gjykatave në rang ndërkombëtar, nëse kemi të bëjmë me shkelje të sovranitetit të shtetit, apo është një gjykim që përbën interes kombëtar dhe del jashtë kufijve të sovranitetit, e thënë ndryshe, jashtë kufijve të interesit të ngushtë të shtetit? Përgjigja për çështje të tilla delikate nuk është e lehtë, sepse kjo do të kërkonte vendosjen dhe respektimin e një kufiri mes sovranitetit të shteteve dhe juridiksionit të GJNP-së.

Siç u theksua, GJNP e ka filluar veprimtarinë e vet në vitin 2002. Ajo ka një ekzistencë relativisht të shkurtër, por erdhi në jetë pas përpjekjeve të shumta të bashkësisë ndërkombëtare për krijimin e mekanizmave ndërkombëtarë për gjykimin e veprave penale dhe vënien përpara përgjegjësisë ndërkombëtare penale të individëve janë të hershme. Gjatë të dy luftërave botërore njerëzimi kaloi shumë vuajtje dhe pësoi humbje të panumërta materiale dhe në njerëz. Duhet vënë në dukje se sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore, u vu re tentativa e drejtuesve të shteteve nazifashiste, autorë të krimeve masive kundër njerëzimit, për t'u "fshehur" pas sovranitetit të shtetit të tyre. Kjo ndodhte për arsye se në atë kohë jo vetëm që nuk ekzistonte një mekanizëm juridiko-ndërkombëtar penal i mirëfilltë, por sepse edhe kur shtrohej çështja që të viheshin përpara përgjegjësisë, ishte shteti ai që "gjykohet" dhe që "dënohet" duke qënë se me konceptin e atëhershëm të shtetit supozohej se ato krime ishin kryer në "emër të shtetit" dhe një nga parimet kryesore të së drejtës ndërkombëtare ishte "mosndërhyrja në punët e brendshme të shtetit". Në këto rrethana, shpesh komuniteti ndërkombëtar e ka pasur të vështirë të vepronte. Për pasojë, njerëzimi ishte i paafte të parandalonte dhunimin e të drejtave të njeriut prej individëve të ndodhur në krye të shteteve. Kjo ishte një rrugë e cila nuk mund të vazhdonte gjatë duke qënë se, siç u përmend, filloi të abuzohej dhe të mos ekzistonte "frika" e ndëshkimit. Në këto kushte, i tmerruar nga brutaliteti gjithnjë në rritje si dhe "i zënë në kurtë" nga kolapsi për shkak të barrierave ideologjike⁵

¹ Genocid: krim ndërkombëtar që përmban veprime të tilla të cilat shkaktojnë dëmtime serioze fizike dhe mendore me qëllim për të shkatërruar plotësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, racor ose fetar

² Krime kundër njerëzimit: krime brutale që përbëhen nga veprime të gjera dhe sistematike të kryera nga autoritetet shtetërore që krijojnë shok në mbarë ndërgjegjen njerëzore.

³ Krimet e luftës: dhunime të ligjeve të së drejtës ndërkombëtare lidhur me sjelljet në rastet e konflikteve ndërkombëtare të armatosura

⁴ Krime të agresionit: invazionepushtime ose sulme të armatosura, bombardime, bllokada, dhunime të armatosura të territoreve, etj.

⁵ Barriera ideologjike ishte krijuar në lidhje me faktin se, siç u përmend, sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare një nga elementët e sovranitetit është mosndërhyrja në punët e brendshme të shtetit.

komuniteti ndërkombëtar nisi interesimin për të identifikuar dhe për të dënuar kriminelët që fshiheshin pas petkut të sovranitetit shtetëror.⁶ Në kuadër të këtyre përpjekjeve, u morën masa për transferimin e përgjegjësive nga shteti tek individit.⁷ Kështu individit, përveçse u vu në shënjestër të së drejtës ndërkombëtare, u vesh për të parën herë me petkun e subjektit të së drejtës ndërkombëtare, çka deri në atë kohë kishte qënë ekskluzivitet vetëm i shtetit dhe i organizatave ndërkombëtare. Deri në atë kohë ai kishte qënë vetëm objekt e si i tillë nuk kishte as të drejta e as përgjegjësi nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare.

Hapi i parë serioz për të realizuar vënien përpara përgjegjësive penale ndërkombëtare të individit, që çoi në krijimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, u ndërmorr pas LIB. Ai ka të bëjë me një përpjekje që u bë për të nxjerrë përpara përgjegjësive penale Kajzerin, kryetarin e shtetit gjerman, i cili u shmang asaj duke u strehuar në Hollandë. Gjykata e mirëfilltë ndërkombëtare penale do të fillonte veprimtarinë e saj praktikisht pas LIIB, me krijimin e gjykatave *Ad-Hoc* të Nurembergut dhe të Tokios⁸. Ato u krijuan me marrëveshje mes shteteve fituese në luftë, si reagim ndaj krimeve mizore të kryera prej Gjermanisë hitleriane dhe aleatëve të saj, duke pranuar parimin e “*përgjegjësive individuale*”. Në vijim, në hartimin e Statutit të Romës u mbajt parasysh eksperiencia dhe veprimtaria e dy gjykatave të sipërpërmendura.⁹ Gjyqet e Nurembergut u zhvilluan në një hark kohor prej katër vjetësh (1945 – 1949). Gjatë kësaj periudhe u zhvilluan 12 gjyqe, më i famshmi prej të cilëve ishte gjyqi i parë ku u gjykuan 23 ndër figurat kryesore të regjimit nazist¹⁰.

Në 1947 Henri Donnedieli De Vabres, gjykatësi Francez në Gjykatën Kriminale të Nurembergut bëri propozimin për krijimin e një gjykate të përhershme¹¹. Puna për krijimin e kësaj gjykate nisi menjëherë. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ngarkoi Komisionin e së Drejtës Ndërkombëtare për të hartuar statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale sipas nenit VI të Konventës Kundër Genocidit, së bashku me “*Parimet e Nurembergut*” dhe “*Kodin për Krimet Kundër*

Paqes dhe Sigurisë Ndërkombëtare”¹². Në vitin 1952 Asambleja e Përgjithshme themeloi një komitet me 17 përfaqësues të shteteve që do të vinin në ndihmë për hartimin e statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Në vitin 1954 Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare doli me projektin e parë duke bërë propozimin përkatës pranë Asamblesë. Për fat të keq puna për themelimin e *GJNP-së* u pezullua për shkak të ashpërsimit të Luftës së Ftohtë.¹³

Do të kalonin shumë vite, kur në vitin 1993 Asambleja e Përgjithshme iu rikthye sërish projektit të krijimit të një Gjykate Ndërkombëtare Penale. Ajo kërkoi zyrtarisht nga Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare hartimin e një statuti për *GJNP*. Në vitin 1994 u ngrit një Komitet *ad-hoc* për të rishikuar statutin e propozuar nga Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare. Ky Komitet asistojë dhe nga një komitet parapërgatitor që u mbledh tre herë në vitet 1996 – 1998, për të sqaruar çështje që kishin të bënin me statutin në fjalë.¹⁴ Produkti final i punës së komitetit parapërgatitor i dalë në korrik të vitit 1998 përmbante rreth 1400 pika që parashtröheshin për diskutim lidhur me çështje që trajtoheshin në tekstin e statutit.¹⁵ Teksa njoftoi hyrjen në fuqi të statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan, u shpreh se:

*“është një fitore e madhe për drejtësinë dhe për rendin botëror–një kthesë kundër sundimit të forcës dhe një rrugë e nisur drejt shtetit të së drejtës. Procesi nëpër të cilin po kalojmë shënon ndarjen përfundimtare me pamjen cinike të botës deri më sot, bazuar dhe në fjalët e Stalinit, sipas të cilit, një vdekje është një tragjedi ndërsa miliona vdekje janë statistikë”*¹⁶

Në fjalimin e tij, në dhjetor 1997 Louise Arbour, Prokuror në Gjykatën Ndërkombëtare Penale në Jugosllavi është shprehur se¹⁷

Rekuret pranë një organizmi ndërkombëtar për çështjet penale do të bëhen për krime të “tmerrshme” të cilat nuk mund të gjykohen nga juridiksioni i autoriteteve kombëtare”.

Lidhur me përgjegjësinë shtetërore në raport me atë individuale, shkak për të cilin u themelua *GJNP*, në doktrinën e së drejtës penale ekzistojnë tre teori: teoria që mbështet vetëm përgjegjësinë shtetërore; teoria që pranon ekzistencën

Këtë parim themelor që lidhet drejtpërdrejt me statusin juridiko-ndërkombëtar të shtetit, drejtuesit përgjegjës të shteteve e shfrytëzonin në favor të tyre për t’ju shmangur përgjegjësive për krime të pafundme kundër njerëzimit.

⁶ Bharadwaj, 2003:2

⁷ Krimet kundër rendit të së drejtës ndërkombëtare kryhen nga njeriu dhe jo nga entitete abstrakte, dhe vetëm me anë të ndëshkimit të individëve që i kryejnë këto krime mund të përforcohet veprimi i së drejtës ndërkombëtare.

⁸ Rancilio P., 2001:300

⁹ Tomuschat Ch., 1994:237-247

¹⁰ Gjykatat ndërkombëtare, 2005:119

¹¹ Gjykatat e Nurembergut dhe të Tokios ishin *Ad-Hoc* të ngritura për të gjykuar krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera nga individët për një periudhë të caktuar kohe, pas LIIB dhe si të tilla me të përfunduar gjykimet përkatëse nuk ekzistonin më, ndaj u bë dhe propozimi për të pasur një juridiksion të përhershëm.

¹² Këto dy akte së bashku edhe me një varg dokumentesh të tjerë që trajtonin aspekte me karakter procedural dhe material të përgjegjësive penale ndërkombëtare, konsiderohen si zanafilla e të drejtës ndërkombëtare penale.

¹³ Sachabas W., 2001:8-10.

¹⁴ Arsanjani M., 1999 : 22-43

¹⁵ Kirsch P., & Holmes J., 1999:3

¹⁶ Bharadwaj, 2003:1

¹⁷ Kirsch P., & Holmes J., 1999:10

e përgjegjësish së përbashkët të shtetit dhe të individit dhe teoria që pranon se ekziston vetëm përgjegjësia penale individuale. Sipas teorive që mbështesin përgjegjësinë e shtetit dhe atë të përbashkët mes shtetit dhe individit, shteti nuk mund të lihet jashtë kuadrës të përgjegjësish për arsye se ai është subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe si i tillë mban përgjegjësi për çdo akt të kryer në emër të tij në shkëlqje të rregullave dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

Mbështetësit e teorisë se përgjegjësia penale ndërkombëtare i takon vetëm individëve argumentojnë se: (1) shteti është një organizëm sovran dhe i pavarur i cili nuk mund të gjykohet nga asnjë organizëm tjetër, (2) në veprën penale të kryer “nga shteti” mungon faktori psikologjik si element i anës subjektive të veprës penale¹⁸, (3) mungon baza ligjore për marrjen e shtetit në përgjegjësi penale dhe për aplikimin e sanksioneve ndaj tij, (4) *GJNP* në statutin e saj e përjashton shprehimisht mundësinë që në kategorinë e personave juridikë (*që merren në përgjegjësi penale*) të përfshihet dhe shteti.

Me krijimin e gjykatave të sipërpërmendura për gjykimin e veprave penale përkatëse, është e qartë se praktika e së drejtës ndërkombëtare penale ka tendencën e sjelljes përherë e më shumë drejt teorisë së tretë, për gjykimin e individëve në vend të shteteve. Kjo është diçka që theksohet në mënyrë të shprehur edhe në nenet 25¹⁹ e 27²⁰ të Statutit të Romës, të cilët përcaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë qëllimin thelbësor për të cilin është krijuar *GJNP*, duke parashikuar personin fizik si subjekt të procedimit penal ndërkombëtar si dhe duke sanksionuar mungesën e tolerimeve në përjashtime apo imunitet nga përgjegjësia penale ndërkombëtare për persona që gëzojnë një status të veçantë në jetën publike.

Sovraniteti shtetëror

Sovraniteti është element esencial që një formacion i caktuar i organizuar politikisht të ketë të drejtë të pretendojë për posedimin e personalitetit juridiko – ndërkombëtar dhe si i tillë të shfaqet si subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Ai

¹⁸ Vepra penale përbëhet nga elementët e anës objektive (tiparet dhe elementët e jashtëm që karakterizojnë të gjitha veprat penale) dhe elementët e anës subjektive (qëndrimi psikik i personit ndaj veprimit ose mosveprimit dhe pasojës që vjen apo mund të vijë). Elementët e anës objektive janë: Veprimi ose mosveprimi, rrezikshmëria, kundërligjshmëria, lidhja shkakësore, pasoja, vendi, koha, mjeti, mënyra, etj; Elementët e anës subjektive janë fajti, qëllimi, motivi.

¹⁹ *Gjykata do të ketë juridiksion mbi personat fizikë, në pajtim me këtë Statut. Personi që kryen një krim brenda juridiksionit të Gjykatës, do të jetë përgjegjës personalisht dhe i nënshtrohet dënimit, në pajtim me këtë Statut.*

²⁰ 1. *Ky Statut do të zbatohet nësej ndaj të gjithë personave, pa asnjë dallim të bazuar në pozitën zyrtare. Në veçanti, pozita zyrtare si Kryetar i shtetit apo qeverisë, anëtar i qeverisë apo parlamentit, përfaqësues i zgjedhur i qeverisë apo zyrtar i qeverisë, në asnjë rast nuk do të përjashtojë një person nga përgjegjësia penale sipas këtij Statuti, as që pozita e tillë, vetvetiu, nuk do të krijojë bazë për reduktimin e dënimit.* 2. *Imunitetet apo rregullat speciale procedurale, që mund t'i jenë bashkëngjitur pozitës zyrtare të personit, sipas të drejtës kombëtare apo asaj ndërkombëtare, nuk duhet të pengojnë Gjykatën nga ushtrimi i juridiksionit të saj mbi një person të tillë.*

është gjithashtu një koncept themelor i së drejtës. Në të drejtën publike dhe në atë ndërkombëtare publike, sovraniteti përkufizohet si “*dominium supremum, autoritet dhe rregull*”. Ai është pushteti suprem i shtetit, si një autoritet i cili është i pavarur nga cilido autoritet tjetër botëror²¹. Në terma të tjerë, ai është karakteristikë e pushtetit shtetëror dhe lidhet me pavarësinë e pushtetit shtetëror të një shteti nga pushteti i çfarëdo shteti tjetër. Kjo nënkupton se, shteti ka të drejtë të zgjidhë lirisht çështjet e tij të brendshme dhe të jashtme²². Sovraniteti nuk kufizohet vetëm në pushtetin, kontrollin ose forcën *de facto*, por përbën një mënyrë të organizimit të pushtetit politik dhe të drejtës publike (juridiksioni dhe autoriteti). Ky koncept lidhet me aftësinë e autoritetit shtetëror për të dhënë urdhra legjitimë (ligjet), dhe është gjithnjë çështje marrëdhënieje mes ligjit dhe pushtetit²³, pushtet i cili manifestohet me ushtrimin e autoritetit publik (administrativ, legjislativ, gjyqësor) dhe ndryshon nga pavarësia e cila lidhet me jetën ndërkombëtare të shtetit, pra me daljen e këtij të fundit në arenën ndërkombëtare në rolin e subjektit. Në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare sovraniteti shfaqet për herë të parë në shek XVI dhe i pari që e përmend është *Jean Bodin* në vitin 1576 në veprën “*6 libra mbi republikën*”, duke e përkufizuar sovranitetin si pushtet absolut dhe i përjetshëm i republikës. Sipas tij: “*sovraniteti është ai pushtet i pakufizuar dhe i përjetshëm i një shteti*”²⁴. Bashkë me *Jean Bodin* kemi edhe një tjetër autor të madh i cili flet gjerësisht për problemet e sovranitetit. Ai është *Thomas Hobs. Bodin* dhe *Hobs* e kanë injektuar sovranitetin si kusht të domosdoshëm për shtetin që të dalë me cilësinë e subjektit të së drejtës ndërkombëtare.

E drejta e një shteti për të konsideruar si vepra penale veprime ose mosveprime të caktuara dhe rrjedhimisht e drejta për të marrë masat përkatëse është pjesë e sovranitetit. Në këtë kuadër shteti ka të drejtë që jo vetëm të dënojë krimet që kryhen brenda territorit të tij, por edhe ato që kryhen jashtë territorit, kur plotësohen disa kushte. Kjo lidhet kryesisht me parimet mbi të cilat bazohet ushtrimi i sovranitetit shtetëror në fushën penale, të tilla si parimi i territorialitetit, i juridiksionit universal, i personalitetit aktiv e pasiv, etj. Sipas parimit të territorialitetit, shteti ka të drejtë të ndëshkojë çdo person që kryen një krim në territorin e tij, përfshi edhe shtetasit e huaj. Juridiksioni universal ka të bëjë me të drejtën e shtetit për ndërmarrjen e procedurave për ndjekjen penale ndaj një personi pavarësisht nga shtetësia e tij dhe territori ku është kryer krimi. Ky është një lloj juridiksioni i cili ushtrohet në rastet e veprave penale që çenojnë interesat e të gjithë bashkësisë ndërkombëtare siç janë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidi, etj. Të drejtën për të ushtruar juridiksion universal një shtet gëzon dhe e ushtron në rastet kur shteti në territorin e të cilit është kryer krimi refuzon ushtrimin e juridiksionit. Në këto raste shtetet

²¹ Gruda, 2007:70

²² Omari, 2006:50

²³ Cohen J.L, 2009.

²⁴ Bodin, 2000:23

ushtrojnë atë që quhet *personalitet aktiv* dhe komponentin tjetër, *personalitetin pasiv*. Parimi i personalitetit aktiv ka të bëjë me të drejtën e shtetit për të dënuar shtetas të tij që kanë kryer një veprë penale jashtë territorit, me kusht që kjo veprë penale të jetë e dënueshme edhe nga legjislacioni i shtetit në territorin e të cilit është kryer, edhe nga ai i shtetit, shtetësinë e të cilit mban autori i veprës penale si dhe të mos ekzistojë një vendim penal i formës së prerë. Parimi i personalitetit pasiv lidhet me të drejtën e shtetit për të ushtruar juridiksion edhe për vepra penale të kryera jashtë territorit ndaj shtetasve të tij.

A po sakrifikohet sovraniteti për sigurinë?

Debati rreth çështjes së respektimit të sovranitetit të shteteve dhe rrezikut të cënimit të tij nga një drejtësi ndërkombëtare penale e pavarur ka dominuar doktrinën juridike prej themelimit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, dhe vazhdon ende sot. Parimet e përmendura më parë në lidhje me sovranitetin shtetëror në fushën penale, si dhe të tjerë të mishëruar në legjislacion dhe në doktrinën e së drejtës penale janë dëshmi se sovraniteti shtetëror është i gjerë dhe i gjithanshëm përta i takon ushtrimit të ndjekjes penale. Në këtë pikë, formulohen pikëpyetje të tilla si: a ekziston përplasje ndërmjet të drejtës së shteteve anëtarë të *GJNP-së* për të ushtruar ndjekje penale dhe kompetencës së vetë *GJNP-së*? Ekziston mbivendosje, apo bashkëpunim? A dëshmon fakti se shtetet anëtarë të *GJNP* i kanë dhënë kësaj të fundit juridiksion ndërkombëtar, që këta kanë sakrifikuar sovranitetin e tyre në emër të sigurisë?

Çdo shtet anëtar i GJNP-së është i detyruar ta pranojë juridiksionin e saj, pasi në ndryshim nga modeli tradicional i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë²⁵, GJNP nuk i lejon shtetet të vendosin për të pranuar ose jo juridiksionin e saj rast pas rasti. Gjykata ka juridiksion mbi të gjithë rastet e krimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit krimeve të luftës dhe krimeve të agresionit që ndodhin në territorin e një shteti që ka ratifikuar traktatin, ose që janë kryer nga shtetasi i një shteti që ka ratifikuar traktatin, nëse vëren se shtetet nuk kanë vullnet ose nuk janë në gjendje ta ushtrorjnë ndjekjen penale²⁶. Gjithashtu Gjykata ka Juridiksion mbi çdo rast që i referohet nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, mbi bazën e Kreut VII të Kartës, pavarësisht faktit nëse shteti ku ka ndodhur krimi e ka ratifikuar ose jo traktatin²⁷.

Rast përjashtimor i veçantë kur *GJNP* nuk ka juridiksion është ai kur ekziston një marrëveshje mes shteteve për të përjashtuar shtetasit e një shteti nga ndjekja penale që ushtrorhet nga Gjykata, duke i dorëzuar ata tek shteti shtetësinë e të cilit

²⁵ Për të qënë palë në një gjykim pranë GJND duhet që të dy shtetet të bien dakord me njeri – tjetrin pasi juridiksioni i saj është fakultativ.

²⁶ Gjykatat ndërkombëtare, 2005:140

²⁷ Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Kreu VII

mbajnë. Një marrëveshje e tillë është nënshkruar mes Republikës së Shqipërisë²⁸ dhe ShBA në vitin 2003, dhe është ratifikuar me ligjin Nr.9081, datë 19.06.2003. Sipas tekstit të kësaj marrëveshje:

“2. Personat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mungesë të miratimit të shprehur prej Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës: a) nuk do të dorëzohen apo nuk do të transferohen në asnjë mënyrë në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për çfarëdo qëllimi ose b) nuk do të dorëzohen apo nuk do të transferohen në asnjë mënyrë në një entitet tjetër ose vend të tretë apo të dëbohen në një vend të tretë, me qëllim dorëzimin apo transferimin në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.
3. Kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë ekstradon, dorëzon ose ndryshe transferon një person të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në një vend të tretë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të pranojë dorëzimin apo transferimin e këtij personi në Gjykatën Ndërkombëtare Penale nga një vend i tretë, pa miratimin e shprehur të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.”

Kjo marrëveshje bazohet në nenin 98 të Statutit të Romës për GJNP sipas së cilit Gjykata nuk mund të ndërhyjë me kërkesë për dorëzimin e një individi nëse kjo vjen në kundërshtim me një marrëveshje ekzistuese mes shtetit të cilit i kërkohet dhe një shteti të tretë. Juridiksioni i detyrueshëm që ushtron Gjykata Ndërkombëtare Penale për shtetet anëtare nuk e bën atë një organizëm mbikombëtar. Ajo nuk bën asgjë më shumë nga sa mund të bëjë çdo shtet nën rregullat e së drejtës ndërkombëtare. Nisur nga kjo pikëpamje, GJNP mund të konsiderohet si një zgjerim i juridiksionit penal kombëtar, e për pasojë ekzistenca e saj nuk e kërcënon sovranitetin kombëtar, përkundrazi e ndihmon atë. Kjo theksohet që në preambulën e Statutit të GJNP, ku ndër të tjera nënvizohet se: *“Gjykata Ndërkombëtare Penale, e themeluar sipas këtij Statuti, do të jetë plotësim i juridiksioneve penale kombëtare”*. Kjo karakteristikë e gjykatës si plotësim i juridiksioneve penale kombëtare është një element që bën dallimin mes GJNP dhe juridiksioneve penale të mëparshme, siç ishte për shembull gjykata Ndërkombëtare për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkelje Serioze të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë, në nenin 8/2 të statutit të së cilës përcaktohej se: *“Tribunali Ndërkombëtar do të ketë primat ndaj gjykatave kombëtare. Në cilëndo fazë të procedurës, Tribunali Ndërkombëtar mundet formalisht të kërkojë nga gjykata kombëtare t'i nënshtrohet*

²⁸ Republika e Shqipërisë e ka nënshkruar traktatin e Romës në vitin 1998 dhe e ka ratifikuar atë me ligjin Nr. 8984, datë 23.12.2002, pasi Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e vën në lëvizje nga Kryeministri u shpreh me anë të vendimit nr. 186, datë 23.09.2002 se dispozitat e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

kompetencës së Tribunalit, në pajtim me këtë Statut dhe Rregullat e Procedurës dhe Dëshmimit të Tribunalit Ndërkombëtar”.

Marrëdhënia mes të drejtës ndërkombëtare penale dhe mekanizmit që e zbaton atë, me sovranitetin e shteteve është komplekse dhe ndonjëherë edhe e keqinterpretuar. Duhet të pranohet se juridiksioni ndërkombëtar penal e prek sovranitetin e shteteve duke ndaluar sjellje të caktuara të cilat nuk parashikoheshin më parë nga ligji ndërkombëtar. Nga ana tjetër edhe detyrimi që kanë marrë përsipër shtetet nënshkruese të traktatit të Romës për të bashkëpunuar me Gjykatën ndikon në sovranitetin shtetëror. Megjithatë, kriminaliteti ndërkombëtar nuk do të mund të parandalohet nëse nuk do të ekzistonte sovraniteti. Si shembull për të ilustruar këtë mund të merret rasti i Somalisë dhe Sierra Leones ku krimi e pati të lehtë të lulëzonte për sa kohë që shteti nuk ekzistonte apo ishte i dobët. Shteti dhe organet përkatëse të tij kanë rol mbrojtës të padiskutueshëm, të paktën për aq kohë sa OKB ose ndonjë organizëm tjetër ndërkombëtar nuk do të marrin përsipër detyrat e tyre. GjNP është krijuar si pasojë e ushtrimit të sovranitetit nga ana e shteteve. Me fjalë të tjera, ajo është një organ i përhershëm i krijuar me anë të një traktati ndërkombëtar prej shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Asnjë entitet tjetër veç shteteve nuk e ka të drejtën dhe as kompetencën dhe autoritetin për të krijuar një Gjykatë Ndërkombëtare Penale. Kështu pra, ky institucion, ia detyron ekzistencën e tij sovranitetit shtetëror. Themelimi i tij me marrëveshjen e të gjithë shteteve nënkupton se këta të fundit, me vullnetin e tyre sovran, i kanë dhënë atij të drejtën të ushtrojë disa nga fuqitë që burojnë prej sovranitetit të tyre, e konkretisht të drejtën për të ushtruar juridiksion ndërkombëtar penal.²⁹ Në rastin e Shqipërisë, kjo e drejtë e shtetit për të kaluar një ose disa kompetenca ekskluzive në mekanizma të tjerë ndërkombëtarë është ngritur në nivel kushtetues në nenin 123/1 të Kushtetutës së saj, sipas së cilit “*Republika e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara*” si dhe në nenin 2 paragrafi 3, i cili parashikon se “*Për ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtare, Republika e Shqipërisë mund të marrë pjesë në një sistem sigurimi kolektiv, në bazë të një ligji të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit*”. Nga analiza e këtyre dispozitave në frymën e përgjithshme dhe të dispozitave të tjera kushtetuese, të Statutit të Romës, të jurisprudencës dhe të doktrinës në përgjithësi duket qartë se, juridiksioni ndërkombëtar penal nuk përbën “*rrezik*” për sovranitetin kombëtar. Ajo së cilës i duhet kushtuar vëmendje është masa e kompetencave që i kalohen mekanizmit ndërkombëtar, e cila duhet të jetë e tillë që të mos çënojë identitetin kushtetues të shtetit dhe kushtet themelore për ushtrimin e sovranitetit kombëtar³⁰.

²⁹ Cryer R., 2006 : 7

³⁰ Vendim nr. 186, datë 23.09.2002 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Konkluzione

Gjykata Ndërkombëtare Penale është i pari institucion ndërkombëtar me juridiksion penal të përhershëm. I gjendur në rrethana kur krimi lulëzonte hapur, njerëzimi e gjeti krijimin e saj si zgjidhjen më optimale për t’i bërë ballë atij për të vënë përpara drejtësisë personat përgjegjës dhe për të mundësuar kështu transferimin e përgjegjësisë nga shteti tek individit, i cili parashikohet shprehimisht nga Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale si subjekt i procedimit penal. Përsa i takon raportit të GjNP-së me sovranitetin shtetëror, nuk mund të veçohet ndonjë prej tyre si prevalent ndaj tjetrit. Kjo për faktin se GjNP është krijuar si pasojë e ushtrimit të sovranitetit nga ana e shteteve, dhe për t’ju ardhur atyre në ndihmë. Ushtrimi i sovranitetit shtetëror jo vetëm që nuk duhet të konsiderohet i cënuar e i rrezikuar, por përkundrazi duhet të jetë bashkëpunues me juridiksionin ndërkombëtar që i gjendet përballë e të cilin ai vetë e ka legjitimuar. Themelimi i GjNP ka dëshmuar se jo vetëm që nuk ka sakrifikim të sovranitetit, por përkundrazi ai është përdorur nga shtetet në mënyrën më të mirë të mundshme në emër të sigurisë, paqes e rendit në botë.

Veç rolit të tyre administrativ e legjislativ, shtetet janë aktorë kryesorë në procedurat që ndiqen përpara GjNP, si dhe në vendimet e dala prej saj. Duke vepruar në një botë të përbërë nga shtete sovraane, GjNP ka nevojë për bashkëpunimin e këtyre të fundit në të gjitha fazat e procedurat me qëllim që të përmbushë misionin që i është besuar.

Bibliografia

1. Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, i miratuar nga Konferenca Diplomatike e të Plotëfuqishmëve në Kombet e Bashkuara për themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale më 17 korrik 1998, hyrë në fuqi më 1 korrik 2002
2. Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nënshkruar në datën 26 qershor 1945 në San Francisko; hyrë në fuqi në datën 24 tetor 1945, Tiranë 1978.
3. Ligj Nr. 8984, datë 23.12.2002 “Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale”
4. Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkelje Serioze të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të kryera në Territorin e ish - Jugosllavisë që nga viti 1991, miratuar me rezolutën e Këshillit të Sigurimit 827 (1993) të 25 majit 1993, i ndryshuar me rezolutat e Këshillit të Sigurimit 1166 (1998) të 13 majit 1998, 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000, 1411 (2002) të 17 majit 2002 dhe 1431 (2002) të gushtit 2002.
5. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
6. Vendim nr. 186, datë 23.09.2002 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
7. Ligj Nr.9081, date 19.6.2003 për ratifikimin e “marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në gjykatën ndërkombëtare penale”

8. Amnesty International., *Cour Pénale Internationale: Mise en oeuvre du statut de Rome.*, Campagne pour la justice internationale., 2010
9. Arsanjani, M. H., *The Rome Statute of the International Criminal Court.* 1999. American Journal of International Law.
10. Barnett L., *La Cour pénale internationale : histoire, rôle et situation actuelle*, Division des affaires juridiques et législatives, 2008: <http://www.parl.gc.ca/content/lop/researchpublications/prb0211-f.pdf>
11. Bennouna M., & El Amine H., *La Cour pénale internationale et les Etats*, Editions Pedone, Paris, 2012
12. Bharadwaj A., *International Criminal Court and the Question of Sovereignty.*, Strategic Analysis, Vol. 27, No. 1, Jan-Mar 2003
13. Boden J., *Sovraniteti*, Isp & Dita, Tiranë 2000
14. Cohen J.L., *Les transformations contemporaines de la souveraineté*, 2009: <http://www.raison-publique.fr/article135.html>
15. Cryer R., *International Criminal Law vs State Sovereignty: Another Round?* 2006. The European Journal of International Law.
16. Dixon M., *E drejta Ndërkombëtare*, AIIS, Tiranë
17. Gruda Z., *E drejta Ndërkombëtare Publike*, Furkan ISM, Shkup 2007
18. Henzelin M., *La cour pénale internationale: organe supernational ou outage des etats?* Genève, 2001
19. Kirsch P., T. Holmes J., *Developments in International Criminal Law.* The American Journal of International Law. 1999, 93 (2) 1-12
20. Lombois C., *Droit Pénal International*, Dalloz, 1979
21. Omari L., *Parime dhe institucione të së drejtës publike*, Elena Gjika, Tiranë 2006
22. Rancilio P. E., *From Nuremberg to Rome: Establishing Criminal Court and the Need for US Participation.* 2001, University of Detroit Mercy Law Review nr.78.
23. Sachabas W. A., *An Introduction to the International Criminal Court.* 2001. Cambridge University Press.
24. Tomuschat Ch., *International Criminal Prosecution: The Precedent of Nuremberg Confirmed.* 1994. Criminal Law Forum nr.5.
25. *Gjykatat Ndërkombëtare*, botim i "Qendra Shqiptare e së Drejtës Ndërkombëtare", Tiranë 2005

E drejta për t'u mbrojtur me avokat në procesin penal

_____ **Dr. Mirgen Preçe** _____

PEDAGOG NË FAKULTETIN JURIDIK, UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

Abstrakt

Artikulli analizon të drejtën për t'u mbrojtur me avokat në procesin penal sipas legjislacionit shqiptar. Në punim trajtohen mënyrat se si realizohet kjo e drejtë nga legjislacioni shqiptar, dhe konkretisht rasti kur i pandehuri ose të afërmit e tij zgjedhin avokat, kur avokati caktohet nga prokurori ose gjykata kur i pandehuri ka mbetur pa avokat ose kur avokati ka lënë mbrojtjen dhe rasti kur avokati caktohet nga Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike. Janë evidentuar problematikat që janë shfaqur në praktikën gjyqësore shqiptare në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtësin në procesin penal.

Fjalë kyç: Avokat, proces penal, Komisioni Shtetëror për Ndhimën Ligjore

1. Zhvillimi historik i profesionit të avokatit

Ushtrimi i profesionit të avokatit fillesat e tij i ka që nga lashtësia, fillimisht ky profesion ka lindur në Athinë. Personat e parë që mund të përshkruhen si avokatë, në Athinë quheshin oratorë. Në fillim ka pasur një rregull që individët duhet të merrnin pjesë vetëm në çështjet e tyre, por ky rregull u anashkalua nga tendenca, në rritje, e individëve që kërkonin këshillën e një miku¹.

Ndërsa në Romën e Lashtë, avokatë quheshin personat të cilët kishin njohuri në retorikë dhe quheshin oratorë. Me kalimin e kohës, prej tyre lindën të ashtuquajturit "këshilltarë ligjorë", të cilët e ushtronin profesionin e tyre si një hobi².

¹ Robert J. Bonner, *Lawyers and Litigants in Ancient Athens, The Genesis of legal profession*, Benjamin Blom, Nju Jork, 1927, 202.

² Artan Hajdari, Mariana Semini-Tutulani, Envi Hicka, Julian Haxhiu, Florian Ballhysa, Ardian Dvorani, Julian Hodaj, Besmir Beja, Holger Hembach, *Vademekum per avokatet. Këshilla dhe*

2. E drejta për t'u mbrojtur nga një avokat i zgjedhur nga i pandehuri

Avokati është personi që gjatë gjithë procesit penal përfaqëson interesat e personit që mbron dhe ofron këshillime juridike me të gjitha mjetet dhe metodat që nuk janë të ndaluara nga ligji³.

Në nenin 3, shkronja ç) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar që gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme.

Në lidhje me të drejtën për t'u mbrojtur me avokat Gjykata Kushtetuese është shprehur në disa vendime ku thekson faktin se "Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale, efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve"⁴.

Përmbajtja e dispozites së nenit 3, shkronja ç) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është e sanksionuar në nenin 6 të Kodit të Procedurës Penale.

Në nenin 53 të paragrafit të parë të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se personi i arrestuar në flagrancë ose i ndaluar ka të drejtë të flasë me mbrojtësin menjëherë pas arrestimit ose ndalimit.

Shprehja "menjëherë" e përdorur nga ligjvënësi në nenin 53 të Kodit të Procedurës Penale, ka kuptimin sa më shpejtë të jetë e mundur.

Ligjvënësi në këtë rast ka dashur të garantojë personin e ndaluar se sa më shpejt të jetë e mundur organi procedues do t'i mundësojë të pandehurit të mbajë kontakte me mbrojtësin e tij.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut duke u shprehur se prania e avokatit është e detyrueshme që në fazën fillestare të procesit kur personi i dyshuar se ka kryer një vepër penale merret në pyetje nga policia⁵.

Në praktikë jo rrallë herë ka ndodhur që i pandehuri ka pasur një avokat të zgjedhur prej tij ose nga një i afërm i tij, dhe avokati pasi ka marrë pjesë në disa séanca gjyqësore nuk është paraqitur më, pa dhënë ndonjë shkak të ligjshëm për mungesën e tij. Duke vënë re mungesën e mbrojtësit, gjykata në bazë të nenit 49

pika 5 e Kodit të Procedurës Penale ka caktuar si zëvendësues një mbrojtës tjetër nga lista e avokatëve kryesisht. Me këtë mbrojtës të caktuar nga gjykata i pandehuri nuk ka qenë dakord dhe ka insistuar që të mbrohet nga avokati i zgjedhur prej tij.

Gjykata ka dy mundësi për të vepruar në këtë rast (bëhet fjalë për ato raste kur e drejta për t'u mbrojtur me avokat nuk është e detyrueshme), të vazhdojë gjykimin me avokatin e caktuar prej saj ose të marrë në konsideratë vullnetin e shprehur nga i pandehuri dhe të vazhdojë gjykimin pa praninë e avokatit të caktuar prej saj.

Në këtë rast shtrohet pyetja, a do të përbënte shkelje të së drejtës për t'u mbrojtur me avokat, në rast se gjykata do të vazhdonte gjykimin pa praninë e avokatit të zgjedhur nga i pandehuri kur ky i fundit mungon pa shkaqe të arsyeshme dhe kur i pandehuri nuk është dakord të mbrohet nga avokati i caktuar nga gjykata?

Gjykata në këtë rast nuk ka alternativë tjetër përveç vazhdimin të gjykimin, sepse në rast se do të shtyjë seancat gjyqësore derisa të paraqitet avokati i zgjedhur nga i pandehuri do të shkelte një tjetër të drejtë që ligji procedural penal ia njehtë të pandehurit, siç është e drejta për zhvillimin e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm.

Pyetjes së formuluar më lartë i ka dhënë përgjigje Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në çështjen e gjykuar nga GJEDNJ-ja, ankuesi nuk dëshironte të mbrohej vetë dhe avokati i zgjedhur prej tij nuk e përmbushi detyrën tij duke munguar gjatë gjykimin të çështjes në mënyrë të paarsyeshme. Për më tepër, ankuesi nuk pranoi të mbrohej nga një avokat i caktuar nga gjykata. Kështu, gjykata e shkalles së parë zgjodhi një mundësi të tretë, atë të shtyrjes së seancave dhe vazhdimin të gjykimin në mungesë të avokatit, por në prani të ankuesit.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vëren se autoritetet e përmbushën në nivel të mjaftueshëm detyrimin e tyre për të siguruar ndihmë ligjore, si duke shtyrë seancat, për t'i dhënë avokatit të ankuesit mundësi për të përmbushur detyrën e tij, ashtu dhe duke caktuar një avokat sipas skemës së ndihmës ligjore. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk konstatoi se ishte shkelur e drejta për t'u mbrojtur me avokat në rastin konkret.⁶

Duhet theksuar fakti se e drejta për t'u mbrojtur me avokat duhet ushtruar me mirëbesim, sipas qëllimit për të cilin është parashikuar në ligj⁷.

Në praktiken shqiptare ka ndodhur edhe rasti tjetër, kur i pandehuri ka zgjedhur avokat mbrojtës gjatë gjykimin, por ai e ka braktisur mbrojtjen dhe e gjendur në këto rrethana gjykata për të siguruar respektimin e të drejtave të të pandehurit ka caktuar disa avokatë kryesisht, ku edhe këta nuk e kanë marrë përsipër mbrojtjen e të pandehurit ose e kanë lënë mbrojtjen dhe gjykata është gjendur përpara një situatë të pamundur për të caktuar avokatë të tjerë. I pandehuri ka insistuar në

akte për procesin civil, botuar nga OSCE, 2014, fq. 13. Shkarkuar nga: <http://www.osce.org/sq/albania/121121?download=true>, parë më 10.02.2015.

³ Igor Dolea, Victor Zaharia, Vasile Rotaru, Elena Croitor, Ion Jigau, Veronica Mihailov, Alexandru Cebanas, *Justitia penala si drepturile omului*, IRP, 2010, fq. 159. Shkarkuar nga: http://irp.md/uploads/files/2014-04/1397217598_justitia-si-drepturile-omului.pdf, parë më 13.02.2015.

⁴ Vendim I Gjykatës Kushtetuese nr. 30, date 26, 11.2009; Vendim I Gjykatës Kushtetuese nr. 33, date 24.11.2003.

⁵ Vendim i Gjykatës Evropiane I të Drejtave të Njeriut, Salduz kunder Turqisë, 28 nentor 2008, paragrafi 55. Vendim i Gjykatës Evropiane i të Drejtave të Njeriut Pishchalnikov kunder Rusisë, 24 shtator 2009, paragrafi 36.

⁶ Vendim i Gjykatës Evropiane i të Drejtave të Njeriut, Balliu kundër Shqipërisë, 16 qershor 2005, paragrafët 35-37.

⁷ Tudor Amza, *Drept procesual penal*. f. 18. Shkarkuar nga: http://id-hyperion.ro/cursuri/cursuri%20drept/Drept_procesual_penal%20-%20an%203,%20sem1.pdf, parë më 17.03.2015.

kërkesën e tij për t'u mbrojtur nga një avokat i caktuar nga gjykata. Në rastin e avokatëve që janë caktuar nga gjykata dhe kanë lënë mbrojtjen, gjykata ka njoftuar Dhomën Kombëtare të Avokatisë për fillimin e procedimit disiplinor.

Në Kodin e Procedurës Penale në nenin 48 të tij është përcaktuar se i pandehuri ka të drejtë, të zgjedhë, jo më shumë se dy mbrojtës.

Në praktikë ka ndodhur edhe ndryshe kur një të pandehur gjatë gjykimit të çështjes e kanë mbrojtur 3 avokatë, dy të zgjedhur nga i pandehuri, kurse njëri i caktuar nga Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike në bazë të kërkesës që i pandehuri kishte depozituar pranë këtij organi.⁸

Gjykata nuk duhej të lejonte legjitimitimin e më tepër së dy avokatëve sepse shkelë nenin 48 të Kodit të Procedurës Penale. Ligjvënësi jo pa qëllim ka vendosur maksimumin e numrit të lejuar të mbrojtësve, sepse duke mos qenë një kufi, ka të pandehur që mund të punësojnë një numër më të madh se dy mbrojtës dhe në këtë rast procesi gjyqësor do të vonohej dhe do të shkelej e drejta e të pandehurit për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

3. E drejta për t'u mbrojtur nga një avokat i caktuar kryesisht

Mbrojta me avokat kryesisht nuk ka funksionin e ndihmës sociale. Qëllimi i saj i vetëm është që të uli në minimum “*barazinë e amëve*” në rastet kur i pandehuri humbet interesin për të zgjedhur një avokat, ngel pa një avokat ose kur asnjë avokat nuk do të realizojë mbrojtjen nga ata që nuk janë te lista e avokatëve kryesisht⁹.

Sipas nenit 49 i pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ka të drejtë të ndihmohet nga mbrojtës që caktohet nga gjykata ose prokuroria, në qoftë se e kërkon atë. Ky nen përcakton dhe ndihmën ligjore të detyruar kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike dhe psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes.

Avokatët që merren me të miturit nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim dhe për këtë arsye në doktrinë¹⁰ është pohuar se avokatët duhet të ndjekin një trajnim profesional për çështjet që kanë të bëjnë për drejtësinë me të mitur për të mbrojtur sa më shumë fëmijët. Kur interesat e drejtësisë e kërkojnë që një të pandehuri duhet t'i caktohet një mbrojtës, gjykata duhet të marrë parasysh se sa e rëndë është vepra penale dhe ashpërsia e dënimit¹¹.

⁸ Vendimi 893 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, datë 20.07.2015. http://www.gjykata.gov.al/portal_DCFR/Penal_Cases.aspx

⁹ Paolo Tonini, *Lineamenti di diritto processuale penale*, Giuffrè, Milano, 2012, f. 70.

¹⁰ Arta Mandro, Alma Tafani, Afërdita Deda, Alma Maksutaj, Blerina Metaj, Drejtësia për të mitur në Shqipëri, f. 36. Shkarkuar nga: <http://www.crca.al/sites/default/files/publications/Drejtësia%20per%20te%20mitur.pdf>, pare me 10.02.2015.

¹¹ Vendim i Gjykatës Evropiane i të Drejtave të Njeriut, Quarantata kundër Zvicrës, paragrafi 33; Vendim i Gjykatës Evropiane i të Drejtave të Njeriut, Zdravko kundër Bullgarisë, paragrafi 38.

4. E drejta për ndihmë ligjore falas

Ligji nr. 10039 datë 22.12.2008 për ndihmën juridike përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të individit. Rolin kryesor në ndihmën juridike e luan Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike, i cili është organ shtetëror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike ndër të tjera miraton rregullat e caktimit të avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike.

Ndihma juridike jepet më anë të këshillimit, plotësimit të akteve të ndryshme, përfaqësimit para organeve administrative, përfaqësimit të të dyshuarit, akuzuarit dhe të dëmtuarit në procesin penal, përfaqësimit të interesave të personave në çështjet civile ose administrative.

Në çështjet penale përfitojnë personat që nuk kanë avokat ose kanë mbetur pa avokat, kurse në çështjet e tjera përfitojnë personat që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pakta.

Nga një krahasim që bëjmë ndërmjet avokatëve të caktuar nga prokurori ose gjykata dhe avokatëve që janë pjesë e Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike, vemë re se tarifat e shërbimit janë të ndryshme. Avokatët që bëjnë pjesë në Komisionin Shtetëror të Ndhimës Juridike paguhën më shumë se sa avokatët e caktuar nga prokurori ose gjykata.

Ndërsa në lidhje me funksionimin e këtyre shërbimeve dhe caktimin e avokatëve që të merren me çështjet gjyqësore, mund të themi se funksionon më mirë dhe më shpejt caktimi i avokatëve nga prokurori ose gjykata se sa nga Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike. Edhe pse duhet të mblidhet disa herë në vit, Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike mezi organizon një mbledhje në vit për shpërndarjen e çështjeve gjyqësore tek avokatët e tij.

5. Raporti avokat- i pandehur

Midis avokatit edhe të pandehurit duhet të ekzistojë një raport besimi, në rast se i pandehuri nuk ka besim tek avokati i tij, kjo gjë mund të dëmtojë interesat e tij, kur i pandehuri nuk i tregon rrethana të caktuara që kanë të bëjnë me çështjen gjyqësore.

Midis të pandehurit dhe avokatit të tij ekziston një raport përfaqësimi teknik që realizohet me ndihmën ligjore, në kuptimin që i pandehuri mund t'i realizojë vetë veprimet që nuk i janë rezervuar mbrojtësit¹².

Këshillimi nga avokati është një lloj përfaqësimi që nuk e pengon të pandehurin të jetë i pranishëm në realizimin e akteve më të rëndësishme të procesit penal¹³.

¹² Paolo Tonini, *Manuale di procedura penale*, Giuffrè, Milano, 2012, f. 136.

¹³ Paolo Tonini, *Manuale di procedura penale*, Giuffrè, Milano, 2012, f. 136.

E drejta për t'u mbrojtur vetë e të pandehurit prevalon nga e drejta e mbrojtjes teknike për shkak se bëhet fjalë për një liri të të pandehurit për të vendosur¹⁴.

Suksesi i një raporti të rregullt midis avokatit dhe të pandehurit ka në themel të tij moralin e lartë dhe përgatitjen e vazhdueshme profesionale, që duhet të shoqërojë avokatin¹⁵.

Konkluzione

Po të kthehemi mbrapa në kohë dhe të shikojmë se si garantoheshin të drejtat e të pandehurit përpara vitit 1990 dhe sot, konstatojmë se është bërë shumë progres. Pavarësisht progresit që është bërë në këtë drejtim, janë të domosdoshme ndryshime të mëtejshme për të përmirësuar situatën.

Në rastin e personave të mitur që janë në konflikt me ligjin do të ishte mirë që avokatët që mbrojnë të miturit të bënin trajnime vazhduese për të mbrojtur sa më mirë interesin më të lartë të fëmijës.

Do të ishte mirë që avokatët e caktuar nga prokurori ose gjykata dhe avokatët që punojnë me Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, të funksiononin brenda një strukture të vetme. Duke parë mënyrën e funksionimit, avokatët e caktuar nga gjykata ose prokurori marrin kontakt më shpejtë me të pandehurin se sa avokatët që janë pjesë e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike. Shpërndarja e çështjeve në Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike është e ngadaltë dhe, në vend që të bëjë që çështjet të zgjidhen brenda një afati të arsyeshëm, bën të kundërtën.

Bibliografi

Arta Mandro, Alma Tafani, Aferdita Deda, Alma Maksutaj, Blerina Metaj, *Drejtesia për të mitur në Shqipëri*. Shkarkuar nga: <http://www.crca.al/sites/default/files/publications/Drejtesia%20per%20te%20mitur.pdf>, pare me 10.02.2015.

Artan Hajdari, Mariana Semini-Tutulani, Envi Hicka, Julian Haxhiu, Florian Ballhysa, Ardian Dvorani, Julian Hodaj, Besmir Beja, Holger Hembach, *Vademekum për avokatët. Kështilla dhe akte për procesin civil*, botuar nga OSCE, 2014. Shkarkuar nga: <http://www.osce.org/sq/albania/121121?download=true>, parë më 10. 02. 2015.

Fatmir Braka, *Raporti avokat-klient, kriter për realizimin e se drejtes*, Avokatia, nr. 3/2014.

Igor Dolea, Victor Zaharia, Vasile Rotaru, Elena Croitor, Ion Jigau, Veronica Mihailov, Alexandru Cebanas, *Justitia penala si drepturile omului*, IRP, 2010. Shkarkuar nga: http://irp.md/uploads/files/2014-04/1397217598_justitia-si-drepturile-omului.pdf, parë më 13.02.2015.

Paolo Tonini, *Lineamenti di diritto processuale penale*, Giuffrè, Milano, 2012.

Paolo Tonini, *Manuale di procedura penale*, Giuffrè, Milano, 2012.

¹⁴ Paolo Tonini, *Manuale di procedura penale*, Giuffrè, Milano, 2012, f. 136.

¹⁵ Fatmir Braka, *Raporti avokat-klient, kriter për realizimin e se drejtes*, Avokatia, nr. 3/2014, f. 3.

Robert J. Bonner, *Lawyers and Litigants in Ancient Athens, The Genesis of legal profession*, Benjamin Blom, Nju Jork, 1927.

Tudor Amza, Drept procesual penal. Shkarkuar nga: http://id-hyperion.ro/cursuri/cursuri%20drept/Drept_procesual_penal%20-%20an%203,%20sem1.pdf, pare me 17.03. 2015.

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, date 26, 11.2009;

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 33, date 24.11.2003.

Vendim i Gjykatës Evropiane i të Drejtave të Njeriut, Salduz kundër Turqisë, 28 nentor 2008.

Vendim i Gjykatës Evropiane i të Drejtave të Njeriut Pishchalnikov kundër Ruisë, 24 shtator 2009.

Vendim i Gjykatës Evropiane i te Drejtave të Njeriut, Balliu kundër Shqipërisë, 16 qershor 2005.

Vendim i Gjykatës Evropiane i të Drejtave të Njeriut, Quarantata kundër Zvicrës, 24 maj 1991.

Vendim i Gjykatës Evropiane i të Drejtave të Njeriut, Zdravko kundër Bullgarisë, 23 shtator 2011.

Vendimi 893i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, datë 20.07.2015. http://www.gjykata.gov.al/portal_DCFR/Penal_Cases.aspx

RECENSË

Imuniteti, aspekte krahasimore – libër me vlera të shumta

Autorë: Arsim Bajrami, Migena Leskoviku,
Zemri Elezi dhe Florent Muçaj

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Pak më shumë se një vit më parë doli në qarkullim libri *Imuniteti, aspekte krahasimore*. Autorë të tij janë Arsim Bajrami, Migena Leskoviku, Zemri Elezi dhe Florent Muçaj.

Çdo botim që i shtohet bibliotekës juridike shqiptare është i mirëpritur, sepse kontribuon në plotësimin e vakumeve të ndjeshme në shkencat juridike, vakume që për fat të mirë kanë filluar të mbushen çdo ditë e më shumë. Profesorë me përvojë, por edhe jo pak të rinj të apasionuar, secili në fushën e vet të studimeve, nëpërmjet botimit të punimeve të tyre, si monografi, tekste mësimore apo artikuj kanë sjellë dalëngadalë vlera të çmuara në shkencën juridike shqiptare.

Libri *“Imuniteti, aspekte krahasimore”*, i autorëve të nderuar Bajrami, Leskoviku, Elezi dhe Muçaj vjen në një fushë me interes të veçantë, në këto kohë problematike për ndërtimin e shtetit në përgjithësi dhe shtetit të së drejtës në veçanti, në hapësirat shqiptare, në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë. Dihet se gjithçka e mirë në progresin ekonomik e shoqëror të një vendi nis nga *“kontrata sociale”* e ndërtimit të një shteti të fortë dhe të civilizuar, ngritur mbi themele të shëndosha kushtetuese. Shtetasit, banorët e çdo shteti, ua kanë besuar këtë mision të madh e të rëndësishëm, sikurse edhe misionin tjetër gjithashtu shumë të rëndësishëm të përgatitjes së legjislacionit, akteve të së drejtës në përgjithësi, të zgjedhurve të tyre në parlamentet kombëtare ose mbi kombëtarë si dhe zyrtarëve të tjerë të rëndësishëm. Të vetëdijshëm për delikatesën e këtij misioni zgjedhësit janë kujdesur gjithmonë që t’iu krijojnë atyre kushtet maksimale për ushtrimin e një veprimtarie sa më normale dhe frytdhënëse, për të punuar të qetë e të patrazuar, pa ankthin ose kërcënimin e ndonjë pasoje për veprimtarinë që ushtrojnë, çka përfshihet dhe trajtohet nga statusi i imunitetit të tyre.

Pikërisht këtë temë me interes të veçantë kanë marrë përsipër dhe kanë trajtuar në librin e tyre autorët e lartpërmendur, duke sjellë që me zgjedhjen e saj si objekt studimi një kontribut të pamohueshëm. Vlerat dhe meritat e kësaj pune shtohen edhe më tej, nëse mbahet parasysh fakti që studimi është trajtuar sipas një metodologjie mjaft racionale.

Autoret, sikurse shprehen edhe vetë në parathënien e librit të tyre, janë *“ngacmuar”* nga zhvillimet e kohëve të fundit në Kosovë, Shqipëri dhe më gjerë, nga rastet e zbatimit në praktikë të imunitetit dhe veçanërisht nga zhvillimet që ai ka pasur në dekadën e fundit. Në përgatitjen e tij ata kanë përdorur metodën krahasuese, të kombinuar me metodën pozitive-juridike, duke u përpjekur që nëpërmjet këtij vështrimi të kryqëzuar dhe krahasues, të hiqen paralele përsa i përket rregullimeve kushtetuese dhe ligjore të çështjeve të imunitetit, duke i parë ato edhe në zbatimin e tyre në praktikën kushtetuese të tre vendeve, në të cilat është shtrirë studimi i autorëve.

Pasi kanë qëndruar jo pak mbi konsideratat e përgjithshme teorike juridike mbi temën e përzgjedhur, si dhe pasi kanë bërë një vështrim specifik mbi legjislacionin e disa prej vendeve me veçanti, me avantazhe ose me mundësi ndikimi mbi legjislacionin kushtetues të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, autorët kanë bërë objekt trajtimi legjislacionin dhe raste interesante nga praktika e të tre shteteve të lartpërmendur.

Vijnë të trajtuara me kursim por, sidoqoftë në masën e duhur, legjislacionet kushtetuese ose aktet përkatëse të SHBA, Mbretërisë së Bashkuar, Kanadasë, Francës, Gjermanisë, Italisë, Spanjës, Austrisë, Danimarkës, Belgjikës, Finlandës, Kroacisë, Ruisë, Meksikës, Brazilit dhe Australisë, ku çështjet e imunitetit shfaqen me ndonjë veçanti që meriton të njihet e të mbahet parasysh. Libri pasqyron gjithashtu edhe përvojën përkatëse të BE, duke u fokusuar te parlamenti evropian, te Këshilli i Ministrave si dhe te zyrtarët dhe punonjësit e tjerë të tij etj. Risi interesante është edhe trajtimi i përvojës së Komisionit të Venecias dhe standardeve të vendosura, prej tij në çështjet e imunitetit. Pas këtij trajtimi në një kuadër të gjerë e të përgjithshëm nis shtjellimi i legjislacioneve dhe praktikave kushtetuese në të tre vendet, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Mjaft e gjerë dhe me interes është pjesa që i kushtohet çështjeve të imunitetit në Republikën e Kosovës, ku për shkak edhe të zhvillimeve të veçanta që u vërtetuan aty prej kohës kur ajo ishte nën administrimin ndërkombëtar e deri aktualisht, janë vërejtur edhe disa risi që, në njëfarë kuptimi, përbëjnë përvoja origjinale.

Në vijim me interes janë gjithashtu edhe *“Imuniteti dhe evoluimi i tij në qasje me zhvillimet kushtetuese dhe ligjore në Shqipëri”*, ku spikat ndër të tjera edhe pasqyrimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese shqiptare.

Një pjesë që plotëson vështrimin krahasimor në hapësirat ballkanike është ajo që ka të bëjë me imunitetin në legjislacionin kushtetues maqedonas. Edhe pse tepër e kursyer në përmasë ajo sjell gjithsesi të dhëna me interes nga legjislacioni

si dhe disa raste praktike që lidhen me imunitetin parlamentar dhe të zyrtarëve të tjerë shtetërorë në Maqedoni.

Vështruar në tërësinë e vet, libri “*Imuniteti, aspekte krabasimore*”, i shkruar me kujdes dhe profesionalizëm vjen jo vetëm si një lajm i mirë, por edhe si një kontribut i vyer në literaturën juridike shqiptare. Ai do të jetë i dobishëm jo vetëm për studentët dhe pedagogët e fakulteteve juridike në të gjitha trevat shqiptare, por edhe për anëtarët e parlamenteve dhe zyrtarë të lartë me imunitet organet shtetërore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, për punonjësit e praktikës gjyqësore, veçanërisht për gjyqtarët e gjykatave kushtetuese, si dhe për studiues ose qytetarë të tjerë të interesuar për këto çështje.

Është rasti për t’iu paraqitur autorëve përgëzime për punën e kryer.

ABSTRACTS

Gender equality as a necessity for gender integrity

———— *Brikena (Buda) Dhuli* ————

The integrity as a new concept appeared firstly in the international articles in the Third World Conference of UN for women (Nairobi 1985) where on the focus was the dispute of the commission of UN on the women status and role of women in development. There is so much dispute related with gender integrity and there is little consensus on definition of gender integrity.

Gender integrity is the organization, improvement, development and evaluation of politics processes in order to incorporate all politics and actors participated in political making.

Gender integrity means the political process must reorganized in way actors should know how to incorporate a perspective and a gender expertise as a normal requirement for politicians. The integrity figures the problems of gender equality out the integration of political instruments. It involves many young actors in the building of a balanced society. The process of transformation of gender relationship leading to gender equality can accelerate and reinforce this overall process.

Key Words: Gender integrity, perspective, gender equality, instruments

For this reason, the approximation of Albanian legislation with the European one necessarily requires a review of the notion of cohabitation as well as a clear definition of the consequences deriving from it.

Key words: marriage, cohabitation, family, heterosexual couples, homosexual couples.

Meaning of the institute of cohabitation according to the Albanian legislation. The principle of heterosexuality as a restriction contrary to the European legislation and jurisprudence

_____ *Dr. Juelda Lamçe* _____

_____ *Yllka Lamçe, Phd. candidate* _____

The right to have a family and the special protection that is guaranteed by the state are enshrined in Article 53 of the Albanian Constitution. The use of conjunction “and” in paragraphs 1 and 2 of Article 53 clearly shows the existence of two well-defined rights in the Constitution, namely the right to marry and the right to have a family. In this sense, it is clear that the concept of family is not equivalent with the institute of marriage, but it may also include in its meaning the institute of cohabitation.

As defined in Article 163 of the Family Code (FC), cohabitation is limited to factual relation “between a man and a woman”, leaving out the legal framework homosexual couples. That exclusion raises the problem of determining the compatibility of this law with the Albanian constitutional formula provided for in Article 53, provided for by Article 8 of the European Convention on Human Rights (ECHR). - “The Right to respect for private and family life” - as well as the jurisprudence of the European Court of Human Rights. In contrast to its previous positions, recently ECHR has considered the relationship between couples of the same sex no longer under private law, but as part of family life.

Ensuring protection of human rights and fundamental freedoms has also been the subject of recent resolutions of the European Parliament, according to which, Member States should not give a narrow definition of the concept of “family”.

Freedom of association under the jurisprudence of the ECHR

_____ *Msc. Ina Xhepa* _____

Recognition and enforcement of human rights and fundamental freedoms is one of the main challenges of any democratic legal system. Europe is widely known as heading towards a unification of the legal systems and judicial practice, in the context of respect for human rights and fundamental freedoms. This paper aims to address succinctly a more relevant issue, such as the right of workers to be organized in trade unions.

Freedom of association represents the entirety of legal norms that regulate the legal position of professional organizations, collective contracts, the right to strike, as well as potential conflicts in the legal labor relationship. This right is recognized and guaranteed by Article 11 of the European Convention on Human Rights, as well as all domestic legal system in hierarchical order. Despite the normative regulations in our domestic legislation still we face problems. For this reason it is worth analyzing the standards established by the European Court of Human Rights concerning the right of association, which must be implemented in our system, as a “*conditio sine qua non*” for the functioning of the rule of law.

Keywords: *ECHR, the right trade union, freedom of expression, the jurisprudence of the ECHR*

Aspects of the legislation on joint stock companies listed on stock exchanges in various European countries

_____ *Prof.Asoc.Dr. Edi Spaho* _____

Listed joint stock companies in different European countries have their characteristics in common, as a consequence of harmonization of the national legislation with the European Union Directives, but they have their specific characteristics, based on historical, economic and social factors. Italian legislation does not distinguish between joint stock and listed joint stock companies, but it does between the capital companies and partnerships. Joint stock companies are widely spread in France. The requirements for the functioning of listed joint stock companies are more complex than joint stock companies. They are the subject of the control from COB, (Commission des Operations de Bourse). German legislation, as the Italian one, does not distinguish between joint stock and listed joint stock companies. Although, Aktiengesellschaft (AG) is used more than Gesellschaft mit beschränkter Haftung (GmbH). The requirements for the foundation of AG are also very complex. Shares of the joint stock companies in Greece can be paid partially. Two or more physical or juridical person, Greek or foreigner can create an AE. The company can be created with a public notarial act, which is compound by the statute and is approved by the Prefecture where the company is registered. For the foundation of a company in United Kingdom, a minimum capital of 50 thousand sterling and a minimum of two shareholders are required. If the capital of the company falls beyond 50%, the general assembly has to decide for the possibility of the wind up procedures.

Key Words: *Commercial Company, shares, stock exchange, board of directors, administration.*

The bank secrecy over client information and the agreements and international norms that are marking the end of this security element

PhD Hemion Braho

This article briefly examines the situation regarding banking secrecy, ranging from normative situation in our country and giving basic concepts of norms within the world. The parliaments and governments all over the world are soon called to ratify the agreement on the *FATCA* legislation, with which Washington calls all the data bank of persons subject to US tax authorities. In front of this arsenal of great power, the future of banking secrecy is now marked to the end. The deployment of forces, put in place in recent times to drop banking secrecy, is impressive. The G20 wants quickly the automatic exchange of tax information worldwide. *The Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD)* intends to develop international standards in the coming months. The EU wants to open negotiations to impose fiscal transparency to all its members and Switzerland from 2015.

Concepts of the future on human security

Ilir ISLAMI, PhD Candidate

Sevdie KADRIU, PhD Candidate

Advancing the concept of human security and placing the individual in the center of attention when it comes to security in general, has resulted in major changes in modern studies on this topic. Taking into consideration that the concept of human safety is not yet clearly defined, various authors make continuous efforts to define this concept as clear as possible and operationalize it as much as possible in order to increase its value both theoretically and practically. The first step in this direction, of course, is the Report of 2001 compiled by the International Commission on Intervention and State Sovereignty (ICISS) “*responsibility to protect*”, which report was re-noted by the Secretary General of the United Nations Ban Ki-Moon through the year 2009 through the report “Implementing the Responsibility to Protect”.

In this paper, it will be noted that the contribution of the doctrine “*responsibility to protect*” is that, in the many discussions which take place regarding security, it takes into consideration the interests of the human and his human rights, and also, for the very cause of the characteristics of this doctrine, it initiates controversy according to which it may probably be seen as a kind of a hegemonic doctrine which is not based on humanitarian principles, but as an effort to limit the sovereignty and political independence of weak states.

Security as a condition of survival and activity of the individual, society, states and the international community; it is one of the fundamental social functions. That this statement is true is proven by the fact that special attention is paid to general security from the times when people lived in primitive communities, until today when we have already entered the XXI century. However, the multidimensional term security, has not always had the same meaning throughout this time, but it is labeled with different terms by various theorists. The definition of security and its content is different in traditional concepts compared to modern concepts.

Security represents one of the basic phenomena of human society in all stages of human development. Regardless of whether it deals with the security of individuals, states or the international community, it constantly works to ensure the values and conditions that are considered of special importance. Precisely for this reason, it is important to be familiar with this concept, especially when it comes to human security.

Key words: *the concept of security, human security, human rights, "responsibility to protect".*

The perspective of a civil claim in the criminal proceedings

Dr. Çlirim Duro

Civil claim in the criminal proceedings as a right for research and trial, is a procedural device which sets in motion the proceeding and judicial power to review at its foundation, based on the same facts and features, along with criminal acts, that under the applicable law are assessed and judged in a single process, with the award of a joint decision as to criminal prosecution as well as civil claim.

This institute of the Criminal Procedural Law of the Republic of Albania, has theoretical and practical importance, since protects the legitimate private, state and public interests as reflected below:

1. The application and implementation of this institute in the current judicial practice, as generally for any offense under the law, we have a violation of the legitimate interests of natural or legal persons (private or public).

2. At the practical side, conceptual difficulties arise that impede and hamper the civilian research in the criminal proceeding according to legal requirements. Fair treatment and conception of respective legal norms logically brings their instrumentalization, which serves to protect the rights and legitimate interests of various material entities, which is realized through the issuance of the verdict.

This article has as objective the treatment in theory, that includes: analytical conception of civil claim in the criminal proceedings, the analysis of relevant legal norms and situations and adapting legislative applied in practical application, based on doctrinal and normative basis.

Key words: *civil claim, criminal proceedings, judicial jurisdiction, procedural guarantees.*

Criminal law in respect to protection of environment

Jonka Ceka, Phd. candidate _____

The article deals with the environmental criminal law, which is a new field within criminal law. Increased environmental crime and the need for cooperation to respond to it, especially as a consequence of the trans-boundary nature of environmental damage, has led to the evolution of the environmental criminal legislation in Europe and beyond.

Environmental criminal law in Albania is based on Penal Code that does not cover all criminal offenses to the detriment of the environment. The rate of environmental criminal law enforcement is weak; it is even a fact that many environmental crimes conclude in civil or administrative matters. Official statistics of criminal offenses and environmental crimes reported, as an expression of the environmental criminal law enforcement in Albania, demonstrate that it is weak and unable to respond to the width and amplitude of the harm caused to the environment in the country today.

Alignment with EU legislation in the field and accession to the Convention of the Council of Europe for the protection of environment through criminal law, are recommended as possible solutions to improve the legal framework and increase opportunities for the rule of law in Albania.

Keywords: *Environmental protection, environmental law, environmental crime, criminal law*

International Criminal Court and the state sovereignty

Msc. Kejsi Rizo _____

Creating an international criminal jurisdiction for those who committed serious crimes because of the positions they held as state officials became a necessity especially at the end of WWII whose consequences were terrible for humanity. The creation of the International Criminal Court in these conditions brought about a revolution not only from a historical perspective but also from that of international law, thus finally confirming an individual to be held responsible for crimes committed. However, although a necessity of the time, the creation of an international criminal jurisdiction raised a serious question: would that violate the right of states to exert themselves prosecution, interfering with the state sovereignty? Does a state have to sacrifice its sovereignty in the name of common security?

Keywords: *International Criminal Court; State sovereignty; subjects of international law*

The right to a lawyer in criminal proceedings

PhD. Mirgen Preņçe

This article analyses the right to a lawyer in criminal proceedings according to Albanian Legislation. Further, this study covers some approaches on accomplishing this right in Albanian Legislation, and precisely the case when the defendant or his relatives get a lawyer, when the lawyer is appointed from the prosecutor or the court in case that the defendant has remained without a lawyer or moreover when lawyer has left the defense case and latterly when the lawyer is appointed by the State Commission for Legal Assistance. Concerns related to Albanian Judicial practices on issues related to defense in criminal proceedings, are further highlighted in this study.

Key Words: *Lawyer, Criminal Proceeding, State Commission for Legal Assistance*

